

Empowered lives.  
Resilient nations.

## **PLAN LOKAL PËR PËRFSHIRJEN, MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË BASHKINË E LEZHËS**

## **PLAN LOKAL PËR PËRFSHIRJEN, MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË BASHKINË E LEZHËS**

Ky dokument u krye me porosi nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) në Shqipëri në kuadër të programit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për përfshirjen sociale në Shqipëri” i financuar nga Agjensia Zvicerane për Zhvillim e Bashkëpunim.

Idetë e shprehura nga autorët e këtij dokumenti nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) apo Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Tiranë, Prill 2015

Përgatitur nga:

Ing. Arkitekte Juli Shllaku - Përshtatshmëria

Florida Kalemi - Arsimi, Punësimi dhe Formimi Profesional

Dr. Blerta Cani - Shërbimet Shoqërore dhe Shëndetësore e Informim dhe Pjesëmarrje

### **FALENDERIME**

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dëshiron të shprehë falenderime dhe mirënjohje për personat e angazhuar, që bënë të mundur realizimin e këtij plani lokal.

Znj. Bardhylka Kospiri, Zëvendës Ministër, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë

Z.Viktor Tusha, Kryetar i Bashkisë së Lezhës

Znj.Dile Nikolla, Drejtorja e Programim Zhvillimit dhe Qeverisjes Elektronike

## Pasqyra e lëndës

fq.

Lista e figurave.....

Lista e shkurtimeve .....

### I. HYRJE

i. Të dhëna të përgjithshme për rrethin e Lezhës.....

II. METODOLOGJIA.....

III. PËRMBLEDHJE LIGJORE.....

### IV. VLERËSIM I GJËNDJES & DREJTIMIT E NDËRHJRJES

IV.1. Përshtatshmëria.....

IV.2. Shërbimet sociale dhe shëndetësore.....

IV.3. Arsimi.....

IV.4. Punësimi .....

IV.5. Informimi dhe përfshirja.....

### V. ANEKSE

Aneksi 1 Matricat e ndërhyrjeve.....

Aneksi 2 Përmbledhje e bazës ligjore.....

Aneksi 3 Portofoli i projekt- ideve.....

Projekti 1: Trajnime: Përshtatshmëria & aksesimi në mjedisin e ndërtuar për personat me aftësi të kufizuara

Projekti 2: Vlerësim/Studim me tematikë Përshtatshmëria & aksesimi në mjedisin e ndërtuar për personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Lezhe

Projekti 3: Qendër Multifunkionale informimi, orientimi, këshillimi për personat me aftësi të kufizuara

Projekti 4: Ndërhyrje në fëmijërinë e hershme

Projekti 5: Pilotim i shërbimeve të pjesmarrjes në komunitet

Projekti 6: Shërbimi i ndihmës personal për personat me aftësi të kufizuara

- Projekti 7: Shërbimi i transportit të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara
- Projekti 8: Pilotimi i qendrave për jetesë të pavarur
- Projekti 9: Pilotimi i shërbimit “Respite care”
- Projekti 10: Krijimi i një shkolle gjithpërfshirëse
- Projekti 11: Ngritja e njësisë për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuar, pranë DRSHKP Lezhë

Aneksi 4 Lista e Institucioneve të përfshira në hartimin e Planit Lokal

## Lista e figurave

- Figura 1 Pasqyrë e produkteve të dala nga procesi i hartimit të planeve lokale
- Figura 2 Fazat e procesit të hartimit dhe zbatimit të Plnit Lokal në Qytetin e Lezhës
- Figura 3 Persona me aftësi të kufizuara sipas kategorisë së përfitimit
- Figura 4 Persona me aftësi të kufizuara sipas moshës
- Figura 5 Persona me aftësi të kufizuara në qendër ditore sipas moshës
- Figura 6 Persona me aftësi të kufizuara në qendër ditore sipas vendbanimit
- Figura 7 Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara, të paraqitur pranë KMCAP, të përfshirë në kopshte dhe shkolla të zakonshme
- Figura 8 Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara me vërtetim KMCAP kundrejt atyre që nuk janë paraqitur pranë KMCAP të përfshirë në sistemin arsimor
- Figura 9 Niveli arsimor i punë kërkuesve të papunë me aftësi të kufizuara
- Figura 10 Numri i personave me aftësi të kufizuara të punësuar krahasuar me numrin total të të punësuarve në sektorin publik dhe privat

Lista e shkurtimeve

AK	Aftësia e kufizuar
BB	Banka Botërore
BKT	Banka Kombëtare Tregëtare
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
DRISHP	Drejtoria Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror të Punës
DRSHS	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social
DRSH	Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë
DRSHKP	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit
DRSHP	Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik
EKT	Enti Kombëtar i Banesave
FSHDKAK	Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
KDKAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KB	Kombet e Bashkuara
KFV	Banka Shtetërore Gjermane për Rindërtim
KM	Këshilli i Ministrave
KMKAP	Komision Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë
KNF	Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit të aftësisë së kufizuar dhe shëndetit
KTP	Kushtet Teknike të Projektimit
ISHP	Inspektoriat Shtetëror i Punës

INUV	Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Vendor
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MMSR	Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
PUPA	Punëkërkues të Papunë
QKSHM	Qëndrat Komunitare të Shëndetit Mendor
SHKP	Shërbimi Kombëtar i Punësimit
SHPS	Shërbimi Psiko Social
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
RVP&Zh	Rregullore Vendore e Kontrollit të Planifikimit e Zhvillimit
ICF	International Classification on Functioning
ISSH	Instituti i Sigurimeve shoqërore
PAK	Person me Aftësi të Kufizuara
PEI	Plane të Edukimit Individual
PDV	Plan i Detajuar Vendor
PLPAK	Plan lokal për personat me aftësi të kufizuara
QRFP	Qendra Rajonale e Formimit Profesional
QFP	Qendra e Formimit Profesional
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
UNDP	United Nations Development Program
UNICEF	United Nations Children's Fund

USAID

Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim  
Ndërkombëtar

ISHA

Inspektoriati Shtetëror i Arsimit

IZHA

Instituti i Zhvillimit të Arsimit

ZA

Zyra Arsimore



## I. HYRJE

Sipas statistikave të fundit zyrtare, numri i personave që janë njohur zyrtarisht të kenë një aftësi të kufizuar në Shqipëri është 145,051 vetë, nga të cilët 74,043 persona janë përfitues në sistemin e sigurimeve shoqërore dhe 71,008 persona në sistemin e ndihmës sociale. Ky numër, që përfshin si femijë edhe të rritur, përbën 5% të popullsisë së Shqipërisë<sup>1</sup>. Prej tyre, 19,348 persona me aftësi të kufizuara, përfitojnë edhe pagesë kujdestarie. Numri i personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë e Lezhës, përfitues nga të dyja skemat ekzistuese të përfitimeve në vend, është 989 dhe ato përbëjnë 3,3% e popullsisë së kësaj bashkie.

Gjatë viteve të fundit, në vend janë hartuar një sërë ligjesh dhe politikash, lidhur me promovimin dhe mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara si Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara (2005), si dhe plani shoqëruar i veprimit, Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale (2007-2013), e cila aktualisht është në procesin e hartimit për periudhën (2015-2020). Të dyja këto strategji, të cilat janë ende në proces hartimi, kanë në themel të tyre vënien në jetë të orientimeve të dhëna në Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara, të ratifikuar në Dhjetor 2012, nga Qeveria Shqiptare.

Pavarësisht përpjekjeve dhe masave të marra për ndryshim, komuniteti i personave me aftësi të kufizuara ende vazhdon të hasë vështirësi, të cilat i pengojnë ata të jenë qytetarë me të drejta e mundësi të barabarta me të gjithë pjesën tjetër të shoqërisë. Qytetarët e Bashkisë së Lezhës, me aftësi të kufizuara, përballen me shumë pengesa në përpjekjet e tyre për t'u përsfhirë në jetën social - ekonomike, politike e kulturore. Vështirësitë, ndër të tjera, kanë të bëjnë me: (a) mungesën e aksesueshmërisë e për pasojë, përfshirjes e pjesëmarrjes së tyre në nivele të ulëta në të gjitha sferat e jetës; (b) nivel të ulët të ardhurash; (c) mungesë të shërbimeve të lidhura me rehabilitimin e integrimin; (d) mungesë të shërbimeve në komunitetet ku ata jetojnë; (e) nivel tejet të ulët të punësimit të tyre në tregun e hapur të punës; (f) mungesë të përfshirjes së tyre në sistemin arsimor të të gjithë niveleve; (g) diskriminimin, stigmatizimin e paragjykimet e pranishme për personat me aftësi të kufizuara.

Ratifikimi nga ana e shtetit shqiptar, në Dhjetor 2012, i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, krijon detyrime të reja për Qeverinë Shqiptare në

---

<sup>1</sup>Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

drejtim të ndryshimeve ligjore, praktikave administrative, qasjes ndaj aftësisë së kufizuar, standarteve të një niveli më të lartë të mbrojtjes së të drejtave e një cilësie më të mirë jetese të personave me aftësi të kufizuara. Pavarësisht se kuadri legjislativ ka njohur disa përmirësime ndër vite, është e rëndësishme të kihet në konsideratë që detyrimet ligjore u përkasin të gjitha niveleve të qeverisjes, duke përfshirë këtu edhe qeverisjen në nivel lokal. Qasja e re dhe konceptet e KDPAK, shpeshherë mbeten të panjohura deri në nivel lokal. Në mënyrë që këto qasje dhe koncepte të gjejnë zbatim edhe në nivel lokal, kërkohet një konkretizim dhe zëbrthim i tyre në plane dhe masa konkrete, të cilat janë të prekshme në njësi të veçanta të pushtetit lokal. Vënia në jetë e këtyre masave, varet tërësisht nga vullneti, dëshira dhe miratimi i tyre nga drejtuesit dhe vendimarrësit në nivel qeverisjeje vendore.

Qëllimi i këtij dokumenti strategjik, është t'i vijë në ndihmë Bashkisë së Lezhës të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga KDPAK dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore të aprovuara nga Qeveria Shqiptare. Hartimi i këtij plani, bazohet mbi parimet që përshkohen në KDPAK: (a) respektin për dinjitetin, autonominë individuale, përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësinë e personit; (b) mosdiskriminimin; (c) pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri; (d) respektin për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuar si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit; (e) mundësi të barabarta; (f) akses.

Ky dokument, synon të ofrojë: (a) dhënien e një kuadri të plotë të situatës aktuale të personave me aftësi të kufizuar në Bashkinë e Lezhës; (b) identifikim dhe fokusim në disa drejtime kyçe, për të adresuar në rrugën e duhur, zgjidhjet potenciale për problemet dhe sfidat ekzistuese; (c) objektiva dhe masa me rezultate të arritshëm në Bashkinë e Lezhës; (d) informim dhe ndërgjegjësim të administratës lokale dhe komunitetit.

Hartimi i planit lokal u realizua në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë dhe institucione të qeverisjes në nivel lokal, përfshirë: Drejtorinë Arsimore Rajonale, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Drejtorinë Rajonale të Inspektoriatit Shtetëror të Punës, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Drejtorinë Rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Në hartimin e këtij plani, u përfshinë dhe grupet e interesit, përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara, organizata të tjera të shoqërisë civile si edhe ofrues publik e privatë të shërbimeve. Gjatë fazës së mbledhjes së informacionit dhe diskutimeve me autoritetet lokale, u identifikuan pesë fusha kryesore të ndërhyrjes, ku bashkia e Lezhës dhe disa nga institucionet rajonale do të fokusohen gjatë zbatimit të këtij dokumenti strategjik:

- Arsim
- Shërbime Sociale dhe Shëndetësorë
- Punësim

- Përshatshmëria e ambjentit të ndërtuar
- Informimi dhe pjesëmarrja

### **i. Të dhëna të përgjithshme për Bashkinë e Lezhës<sup>2</sup>**

Qyteti i Lezhës ndodhet në pjesën veriore të Ultësirës Perëndimore të Shqipërisë, i vendosur në një reliev në përgjithësi të ulët, në lartësi 5 metra mbi nivelin e detit dhe gjendet mjaft pranë një diversiteti të larmishëm të relievit, klimave e mikroklimave dhe për pasojë të florës, faunës dhe biodiversitetit në përgjithësi. I rrethuar nga laguanat Kunë e Vain, plazhi i Shëngjinit dhe bukuritë malore të Velës, qyteti është i shtrirë në të dy anët e lumit Drin. Kufijtë administrativë të kësaj Bashkie janë në veri komuna Balldren, në lindje Komuna Kallmet, në jug Komuna Kolsh, në perëndim Komuna Shëngjin. Qyteti i Lezhës është njëkohësisht dhe qendra administrative e Qarkut Lezhë dhe ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 5.05 km katror. Popullsia në Bashkinë Lezhë është 29,214 banorë dhe përbënte 13% të popullsisë totale të Qarkut Lezhë në vitin 2013. Lezha është një nga Bashkitë që gjendet në rajonin perëndimor të Shqipërisë, i cili ka qënë dhe mbetet rajoni më i zhvilluar në Shqipëri. Aktualisht ekonomia në qytet është e diversifikuar, por mbështetet në tregti dhe shërbime, sektorë që punësojnë numrin më të madh të banorëve. Ndërtimi i Parkut të Biznesit në pjesën veriore të qytetit do të nxisë përqëndrimin e bizneseve vendore e rajonale të huaja. Në park, planifikohen të përqendrohen kryesisht aktivitetet e biznesit të mesëm dhe të madh si: prodhime konfeksionesh, prodhime këpucësh, ndërtim, prodhime agro-ushqimore, përpunim alumini, përpunim druri, transport, tregti e shërbime të ndryshme. Ndërtimi i Parkut të Biznesit parashikon të krijojë rreth 3,000 vende pune. Qarku i Lezhës ka një potencial shumë të madh të zhvillimit të turizmit bregdetar, kulturor, fetar, rural dhe natyror.

---

<sup>2</sup>Plani Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2013-2030, Bashkia Lezhë, 2013

## II. METODOLOGJIA

Produktet kryesore që rezultuan nga puna disa mujore, janë planet strategjike të hartuara në pesë fusha, të cilat u vlerësuan si prioritare për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara. Për secilën nga fushat, u përgatit një plan i veçantë lokal me ndërhyrje konkrete për tu ndjekur në të ardhmen.




Figura 1. Pasqyrë e produkteve të dala nga procesi i hartimit të planeve lokale.




Figura 2. Fazat e procesit të hartimit dhe zbatimit të Planit Lokal në qytetin e Lezhës

### Mbledhja e informacionit

Mbledhja e të dhënave u realizua si fryt i diskutimeve, konsultimeve dhe bashkëpunimit në një grup të gjerë profesionistësh të fushave, por edhe të grupeve të interesit. Metodologjia e përdorur në hartimin e këtij dokumenti, është bazuar në metoda të vlerësimit me pjesëmarrje, përmes kombinimit të intervistave me aktorët përgjegjës dhe grupeve të interesit në fusha të shërbimeve sociale e shëndetësore, arsimit, përshtatshmërisë e punësimit, formimit profesional.

Për të mbledhur informacionin e nevojshëm për raportin e vlerësimit të gjendjes e më pas për hartimin e PLPAK në Lezhë, u përdorën instrumentat si në vijim;

- A) *Intervista të pastrukturuara me përfaqësues të institucioneve të cilat zhvillojnë aktivitetin në nivel lokal dhe lidhen me problematikat e Shërbimeve, Arsimit, Punësimit, Përshtatshmërisë të Mjedisve si dhe Informimin dhe Përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në diskutimin dhe hartimin e politikave në nivel lokal.*

Intervista të pastrukturuara u zhvilluan me çdo departament që kishte përgjegjësi për çështjet objekt të PLPAK. Për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, krahas intervistave me përfaqësues të institucioneve të pushtetit lokal u zhvilluan intervista me drejtues të shoqatave të aftësisë së kufizuar, por edhe me përfaqësues dhe drejtues të OJF të tjera që kanë në fokus problematikën e grupeve në nevojë. Një pyetësor i pastrukturuar u dorëzua për t'u plotësuar e më pas në bazë të përgjigjeve dhe të dhënave të mbledhura, u zhvilluan intervista të thelluara me drejtues të departamenteve përkatëse në Bashki dhe në institucionet e tjera në nivel lokal. Pyetësorët ishin specifikë për çdo institucion, në varësi të përgjegjësive dhe pritshmërive.

*B) Intervista me përfaqësues të shoqatave të Aftësisë së Kufizuar*

Intervistat u realizuan përmes pyetësorëve të pastrukturuar, përmes të cilëve synohej të merrej informacion mbi nivelin e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të fushës së aftësisë së kufizuar në diskutimin, hartimin e politikave në nivel lokal për aftësinë e kufizuar.

*C) Fokus Grup me përfaqësues të OJF të aftësisë së kufizuar dhe OJF që kanë në fokus grupet në nevojë.*

Për të realizuar takimin e fokus grupit u përdor një skedë me pyetje të hapura të cilat shërbyen për të marrë informacion për të gjitha çështjet objekt i PLPAK.

**Parimet, Procesi dhe Organizimi i Punës për hartimin e PLPAK**

Procesi ishte gjithëpërfshirës e me pjesëmarrje të gjerë të grupeve të interesit. Hartimi i PLPAK u parapri nga zhvillimi i një cikli trajnimesh i cili shërbeu për të ndërgjegjësuar përfaqësuesit e strukturave në nivel lokal, për çështje të aftësisë së kufizuar, kuadrin ligjor vendas dhe ndërkombëtar, në mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Për secilën nga fushat u punua në grupe pune. Takimet u zhvilluan me pjesëmarrjen aktive të përfaqësuesve të institucioneve lokale përgjegjëse për fushat në fokus të PLPAK. Në këto takime, u përgatitën analizat SWOT, ku pjesëmarrësit nga secila fushë, identifikuan pikat e forta, të dobëta, mundësitë dhe risqet për realizimin e shërbimeve, punësimit, arsimit, përshtatshmërisë ndërtimore për personat me aftësi të kufizuara si dhe për informimin dhe përfshirjen e tyre në procesin e diskutimit dhe hartimit të politikave në nivel lokal. Analiza e situatës për çdo fushë shërbeu si bazë për hartimin e PLPAK.

### III. PËRMBLEDHJE E BAZËS LIGJORE

Në këtë pjesë, do të gjeni një listim të ligjeve, politikave dhe vendimeve të ndryshme, mbi të cilat, mbështeten ndërhyrjet dhe masat e parashikuara në këtë plan.

Duke pasur parasysh numrin e konsiderueshëm të ligjeve e vendimeve të miratuara gjatë viteve të fundit, gjykojmë si të nevojshëm përfshirjen e një seksioni të veçantë, në mënyrë që ky dokument të shërbejë edhe si referencë për të gjithë drejtuesit, specialistët, punonjësit e institucioneve lokale në Lezhë, por t'i shërbejë edhe vetë komunitetit. Në aneksin numër 2 gjendet një listë e zgjeruar dhe e detajuar e përmbledhjes së bazës ligjore.

- Konventa për të Drejtat e Personave të Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK).
- Ligji Nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Ligji Nr. 93/2014 datë 24.07.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
- Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.
- Ligj Nr. 69/2012 ‘Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.
- Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (i ndryshuar).
- Ligji “Për nxitjen e punësimit” Nr. 7995, datë 20.09.1995 (i ndryshuar).
- Ligji nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore”.
- Ligji Nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar).
- Ligji Nr. 107/2014 « Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit ».
- Vendimin Nr.1503, datë 19.11.2008 rregulloren “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.

#### **IV. VLERËSIMI I GJENDJES SË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË QYTETIN E LEZHËS DHE DREJTIMET KRYESORE TË NDËRHYRJES**

##### **IV.1. Përshtatshmëria e mjedisit të ndërtuar**

###### **i. Vlerësimi i gjendjes në fushën e përshtatshmërisë së mjedisit të ndërtuar.**

Kërkesa për mjedis të përshtatur e pa barriera, përdorim të mjeteve të përshtatura të transportit dhe komunikimit, është cilësuar tashmë nga “Konventa e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara” si një premisë dhe e drejtë që secili shtet duhet të garantojë për çdo person me aftësi të kufizuar, në përputhje me nevojat dhe veçoritë që ai paraqet. Kjo kërkesë shprehet qartë në KDPAK OKB, 13 Dhjetor 2006, Neni 9 “Përshtatshmeria”, ku theksohet: 1. Me qëllim që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar, ashtu si gjithë të tjerë të kenë akses në ambjentet fizike, ndaj transportit, informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në facilitete apo shërbime të tjera të disponueshme apo të ofruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat do të përfshijnë evidentimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave ndaj aksesit do të zbatohen ndër të tjera: (a) Në ndërtesa, rrugë, transport dhe facilitete të tjera në ambjente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, qendrat shëndetësore apo ambjentet e punës; (b) Informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe ato të urgjencës. 2. Gjithashtu, shtetet Palë duhet të marrin masat e duhura për: (a) Të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar zbatimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale në lidhje me aksesin ndaj objekteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruara për publikun; (b) T’u siguruar që subjektet private të cilat ofrojnë objekte dhe shërbime, të cilat janë të hapura apo të siguruara për publikun të marrin parasysh të gjitha aspektet e aksesit për personat me aftësi të kufizuar; (c) Të ofruar trainim për aktorët e interesit lidhur me problemet që kanë të bëjnë më aksesin për personat me aftësi të kufizuar; (d) T’u siguruar që ndërtesat dhe objektet e tjera publike të përmbajnë shenja në gjuhën Braille dhe në forma lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme; (e) Të siguruar forma asistence direkte dhe të ndërmjetme, duke përfshirë guida, lexues dhe interpretë profesionistë të gjuhës së shenjave, për të mundësuar aksesin në ndërtesa dhe objekte të tjera publike; (f) Të inkurajuar forma të tjera të përshtatshme të asistencës dhe mbështetjes për personat me aftësi të kufizuar për tu siguruar që ata të kenë akses në informacion; (g) Të nxitur aksesin e personave me aftësi të kufizuara ndaj e informacioneve të reja dhe sistemeve të teknologjive e reja të komunikimit, duke përfshirë dhe internetin; (h) Të promovuar projektimin, zhvillimin, prodhimin dhe



shpërndarjen e teknologjive dhe sistemeve të aksesueshme të informacionit dhe komunikimit në një fazë të hershme, në mënyrë që këto teknologji dhe sisteme të bëhen të aksesueshme me një kosto minimale.

Garantimi i kësaj të drejte është parashikuar edhe në kuadrin ligjor shqiptar në plotësimin e një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore<sup>3</sup>, të cilët kanë rregulluar normimin në praktikë të standardeve për një mjedis pa barriera.

Ndonëse ky kuadër ligjor ekziston prej disa vitesh dhe plotësohet vazhdimisht me akte ligjore e nënligjore, situatë aktuale le shumë për të dëshëruar. Vetëm parashikimi me masa konkrete dhe masa buxhetore përkatëse do të ndihmonte në realizimin në praktikë të një mjedisi pa barriera, mjete komunikimi dhe transport të pershtatur, për të gjithë, përfshi Personat me Aftësi të Kufizuara

Në zbatim të ligjit “Për Planifikimin e Territorit” i ndryshuar me ligjin "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", zhvillimi urban dhe kontrolli i territorit, administrohen nëpërmjet instrumentave të ngritur për këtë qëllim pranë: (i) Këshillit Bashkiak ku funksionon Komisioni i zhvillimit urban dhe përdorimit të tokës, si dhe Komisioni mbi Pronat publike, transportin dhe trafikun dhe (ii) Bashkisë Lezhë ku funksionon “Këshilli Teknik i Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit” si një organizëm që shqyrton dhe jep mendim mbi dokumentacionin teknik e ligjor për secilin projekt propozim për lejet e zhvillimit, të ndërtimit dhe të shfrytëzimit të objekteve në territorin e bashkisë.

Në nivel administrativ funksionon Drejtoria e Urbanistikës dhe Hartimit të Projekteve në Infrastrukturë me një staf prej tre specialistë të planifikimit dhe studimeve urbanistike, projekteve arkitektonike, kontrollit teknik, projektimit të infrastrukturës, si edhe një topograf e një jurist të cilët janë të angazhuar me pronat dhe asetet e bashkisë.

Pranë Bashkisë Lezhë funksionon edhe Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Vendor (INUV). Ky inspektoriat ka si përgjegjësi kryesore kontrollin dhe zbatimin e ligjshmërisë të standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës brenda territorit administrativ të Bashkisë. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i Bashkisë drejtohet nga kryeinspektori (i cili emërohet nga Kryetari i bashkisë) dhe për përmbushjen e përgjegjësisë të parashikuara me ligj, ai mbështetet nga Policia Bashkiake. INUV funksionon si një strukturë me drejtor dhe 2 arkitektë dhe kontrollon zbatimin e projekteve dhe cilësinë e materialeve të ndërtimit. Lezha nuk ka asnjë laborator të provave të materialeve, por këto kontrole kryhen në qytete të tjera dhe shpesh në Tiranë. INUV ka evidenca (proçes verbal konstatimi, lajmërim dhe vendim për prishje) për të

---

<sup>3</sup>Ligji Nr. 10 119, datë 23.4.2009 “ Për planifikimin e Territorit” i ndryshuar me ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Rregulloren Model të Planifikimit të Territorit si edhe Rregulloren Model të Zhvillimit të Territorit;

Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”

VKM Nr. 1503 datë 19.11.2008 “Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga ana personave me aftësi të kufizuar”; “Ligji nr.10 112, datë 9.4.2009 për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit” neni 40 etj.

gjithë objektet e ndërtuara pa leje në 2 vitet e fundit, ndërkohë që nuk ka informacion të saktë mbi gjendjen e evidencave për periudhat e mëparshme.

Drejtoria e Shërbimeve është struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifen e transportit publik.

Të dhënat për realizimin e këtij vlerësimi në fushën e përshtatshmërisë, u siguruan nga: (i) diskutimet dhe ushtrimet e zhvilluara në trajnimin me temë “Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Gjithëpërfshirja e tyre në Politikat dhe Programet e Qeverisjes Vendore”, (ii) intervistat me drejtues e specialistë pranë Drejtorisë së Urbanistikës dhe Infrastrukturës, Inspektoriatit Urbanistik e Ndërtimor Vendor pranë Bashkisë Lezhë, Drejtorisë Rajonale të Arsimit si edhe Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë.

Në një vështrim të përgjithshëm konstatohet që në fushën e përshtatshmërisë mjedisore ka mungesë të theksuar të vëmendjes nga strukturat përgjegjëse të planifikimit e të kontrollit mbi territorin. Është për të ardhur keq që edhe në kërkesën për financimin e rikonstruksionit të objekteve publike për vitin 2015, nuk është planifikuar asnjë element i përshtatshmërisë së tyre.

Trajnimi ka evidentuar këto gjetje: (i) Niveli i ndërgjegjësimit institucional dhe qytetar është relativisht i ulët; (ii) Kërkesat dhe standartet e përshtatshmërisë në projektet që dorëzohen për leje ndërtimi, pranë bashkisë aplikohen vetëm në masën 10% - 25%, (iii) Kërkesat dhe standartet e përshtatshmërisë, kur janë parashikuar në projektet e miratuara, zbatohen pothuaj në të gjitha rastet; (iv) Nga 114 objekte të identifikuar, objekte të përshtatur (me rampë, tualet dhe ashensor) janë vetëm godinat e spitalit, një pjesë e konsiderueshme e shkollave 9 vjeçare, si edhe disa rrugë; (v) Arësyet që pengojnë aplikimin e kërkesave dhe standarteve të përshtatshmërisë në mjedisin e ndërtuar janë mungesa e vullnetit dhe kontrollit nga strukturat përgjegjëse, instrumentat vendorë të padetajuar dhe pa sanksione (veçanërisht Rregullorja Uniforme e Kontrollit të Zhvillimit); (vi) Aplikimi i detyrueshëm i standarteve të përshtatshmërisë ka nevojë për forcimin e kontrollit, mundësisht nëpërmjet strukturave të veçanta e të specializuara, si edhe për një kod ndërtimi, i cili të ketë fuqi si Kodi Penal.

Rezultatet e diskutimeve dhe intervistave tregojnë që aktualisht niveli i ndërgjegjësimit të strukturave përgjegjëse është i kënaqshëm, pamvarësisht se në zbatim nuk ka konsistencë, dhe këtë e demostrojnë disa shembuj pozitivë për vendosjen e rampave në hyrje, jo vetëm në objektet e shkollave (të rejtat dhe ato që rikonstruktohen), në spitalin e qytetit, por edhe në disa objekte private. Shembull pozitiv është gjithashtu vendosja gjatë zbatimit të punimeve e rampave në të gjitha hyrjet në objektin 8 kat në qendër të qytetit edhe pse nuk ishin në projekt. Vlen të përmendet që ndonëse në projektin e rikonstruksionit të sheshit qendror të qytetit, i cili po zbatohet e pritet të përfundojë në fillim të vitit 2015, nuk janë parashikuar elementët e aksesueshmërisë, bashkia është angazhuar që të rishikojë projektin e të krijojë një shesh të aksesueshëm. Nga inspektimi i

mëvonshëm i punimeve rezulton që me projektin e rishikuar dhe pa kosto shtesë, është vendosur rampa në hyrje të godinës së bashkisë sipas rekomandimeve që u dhanë gjatë trajnimeve në ndihmë të procesit të hartimit të planit lokal nga FSHDPAK. Gjatë këtij inspektimi, konstatohet gjithashtu që rampa ka pjerrësinë sipas standartit, por i mungojnë parrmakët (do të vendosen në një fazë të dytë).

Bashkia Lezhë ka përgatitur një plan zhvillimi, i cili nuk është miratuar ende në të gjitha nivelet. Për të mos bllokuar zhvillimin, Bashkia ka përgatitur Rregulloren Vendore të Kontrollit të Zhvillimit, me të cilën ka operuar për miratimin e lejeve të ndërtimit.

Gjatë kontakteve me drejtues dhe specialistë të sektorit të urbanistikës në Bashkinë e Lezhës ata bënë prezente se e njohin detyrimin ligjor për të siguruar përshtatshmëri në ndërtim, transport e komunikim për personat me aftësi të kufizuara. Ata janë të informuar edhe për përmirësimet e fundit ligjore dhe specifikesht në lidhje me rregulloren e miratuar në vitin 2008 “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, por ndaj kësaj problematike nuk është e njëjta vëmendje nga specialistët përkatës, siç është ndaj problematikave të tjera në fushën e zhvillimeve urbanistike dhe arkitektonike në qytet.

Një tjetër gjetje nga intervistat është që në “Rregulloren Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit” nuk ka referenca të mjaftueshme për përfshirjen e detyrimit të përshtatshmërisë ndërtimore dhe lehtësimin e procedurave në marrjen e lejes së ndërtimit, për vendosjen e tyre në objektet ekzistuese. Si rrjedhojë, edhe në Rregulloren Vendore të Kontrollit të Zhvillimit, mungojnë specifikesht mbi aplikimin e kërkesave dhe standarteve të përshtatshmërisë në mjedisin e ndërtuar (ndërtesa dhe infrastrukturë) në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji Nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e Territorit”. Pavarësisht këtyre mungesave, bashkia ka përdorur procedurën e thjeshtuar (me vetëdeklarim) për vendosjen e rampave në objektet ekzistuese publike e private dhe nuk ka nxjerrë pengesa për kërkuessit. Bashkia ka treguar vullnet për të kapërcyer vështirësitë në administrimin e territorit, por ka nevojë të ketë një instrument të plotë e të detajuar ku të përfshihen të gjitha elementët, veçanërisht ato të përshtatshmërisë ndërtimore.

Megjithatë, ka ende shumë për të bërë, mbasi edhe pse ka përpjekje për të zbatuar legjislacionin për realizimin e përshtatshmërisë mjedisore të objekteve, infrastrukturës e transportit për personat me aftësi të kufizuara, ato janë jo sistematike dhe të pamjaftueshme. Barrierat ekzistuese vazhdojnë t’i mbajnë të izoluar në shtëpitë e tyre këta persona, duke i penguar të bëjnë një jetë normale, pa mundur të shkojnë në shkollë, të punësohen dhe të lëvizin e të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme. Vërehet që jo në të gjitha kërkesat për financimin e projekteve të rikonstruksionit të objekteve publike, janë planifikuar elementët bazë të përshtatshmërisë së tyre.

Këshilli Bashkiak prej disa vitesh nuk miraton fonde për studimet urbanistike, ndaj nuk mund të prokurohen studime të rëndësishme. Fondet e kufizuara të bashkisë,

parashikohet të sjellin vështirësi në rishikimin e Planit të Zhvillimit të qytetit dhe hartimin e Rregulloreve ("Rregullorja e Planifikimit të Territorit" dhe "Rregullorja e Zhvillimit të Territorit"), në zbatim të ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", si edhe të Reformës Territoriale, sipas së cilës kufiri administrativ i bashkisë zgjerohet duke përfshirë 9 komuna kufitare. Njësitë vendore kanë detyrimin të përgatisin instrumentat në zbatim të ligjit, ku duhet të përfshihen dhe rregullat e standartet e përshtatshmërisë ndërtimore.

Vërehet gjithashtu që bashkia nuk ka hartuar asnjë plan veprimi për të adresuar problematikën e përshtatshmërisë ndërtimore. Kërkesa obligative për aplikimin e kërkesave të përshtatshmërisë në ndërtimin e objekteve të reja, nuk gjen pasqyrim nga strukturat përgjegjëse në momentin e miratimit të lejes së ndërtimit e në të gjitha hallkat e procesit të zbatimit dhe kontrollit të objektit, deri në sigurimin e lejes së përdorimit. Konstatohet gjithashtu që asnjë projekt nuk është kthyer për t'u plotësuar me kërkesat e përshtatshmërisë, nga struktura përkatëse e kontrollit para marrjes së lejes së ndërtimit, si dhe nuk është zbatuar asnjë sanksion ndaj atyre që nuk kanë aplikuar këto standarte

Vlen të evidentohet fakti që nuk është përgatitur e dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak asnjë vendim, në lidhje me parandalimin e shfaqjes së barrierave në projektet e objekteve të reja si dhe për heqjen graduale të barrierave në objektet ekzistuese, duke filluar nga ato publike.

Bashkia e Lezhës aplikon vazhdimisht me projekte, për financim nga burime të ndryshme si Fondi i Zhvillimit të Rajoneve apo donatorë të ndryshëm. Aktualisht, **KFV** po investon për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit (në këtë kuadër ka përfunduar azhurnimi i gjendjes ekzistuese dhe projekti i ri), ndërkohë që është hartuar edhe projekti për përmirësimin e rrjetit të kanalizimit.

Lezha ka asete të vyera kulturore, të cilat do të ndikojnë në rritjen e atraksionit turistik të qytetit, por vlerat e tyre mund të dëmtohen për shkak të vështirësive financiare për mirëmbajtje e tyre dhe rikonstrukcion e objekteve. Pavarësisht fondeve të kufizuara, Bashkia ka vëmendjen e duhur ndaj kësaj pasurie dhe për vitin 2015 ka planifikuar rikonstrukcione të pjesëshme të disa prej objekteve: (i) rikonstrukcioni i çatisë së Memorialit të Skënderbeut; (ii) rinovimi i fasadës dhe vendosja e ndriçimit dekorativ në Pallatin e Kulturës. Në këtë projekt përfshihet ngrohja dhe rikonstrukcioni i tualeteve, njeri prej të cilëve dhe të jetë i përshtatur për PAK; (iii) vendosja e ndriçimit dekorativ në fasadën e godinës së bibliotekës.

Bashkia e Lezhës ka rreth 820 ekzemplarë etnografikë, të cilat ekspozoheshin në një shtëpi muze. Mbas vitit 1991, me kthimin tek pronarët të shtëpisë muze, këto objekte etnografike janë magazinuar në katin përdhe të godinës së bibliotekës. Hapësira e magazinimit është e mjaftueshme por duhet rikonstrukcion i saj, për ta përshtatur për ekspozim dinjitoz të objekteve etnografike.

Bashkia ka në administrim të gjitha shkollat e qytetit dhe miraton fonde për mirëmbajtjen e tyre si edhe rikonstrukcione në vlera shumë të kufizuara. Për vitin 2015 është

parashikuar rikonstrukcioni i palestrave (1 kat) në 2 shkolla të qytetit. Në kuadër të rikonstrukcionit, në këto shkolla do të vendosen edhe rampat e pjerrta para hyrjes në palestra.

Pranë Drejtorisë Arsimore, funksionon drejtorja e investimeve dhe buxhetit, e cila trajton programet e zhvillimit. Megjithatë nuk ka asnjë hapësirë që kjo drejtori të ndikojë për ndryshimet në projekte, mbasi projektet vijnë të gatëshme dhe kërkohet vetëm ndjekja e tyre me qëllim informimi pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Në këto kushte, një kontroll nga një strukturë/person i specializuar mbi aplikimin e kërkesave të përshtatshmërisë në projektet e objekteve të reja dhe ato të rikonstruara, para dërgimit për sigurimin e lejes së ndërtimit, do të ishte e domosdoshme.

Drejtorja Rrajonale e Shëndetit Publik është e angazhuara me mirëmbajtjen dhe investimet në spitalin e qytetit dhe qendrat shëndetësore në komuna, si edhe në ambulancat e qytetit. Në qytetin e Lezhës funksionon një spital, qendra shëndetësore (në katin e dytë të një ndërtese pranë DRSH), 5 ambulanca në lagje, si edhe një laborator bakteriologjik. DRSH nuk ka asnjë hapësirë të ndikojë për ndryshimet në projekte, mbasi projektet vijnë të gatëshme dhe kërkohet vetëm ndjekja e tyre me qëllim informimi pranë Ministrisë së Shëndetësisë. Në këto kushte, një kontroll nga një strukturë/person i specializuar mbi aplikimin e kërkesave të përshtatshmërisë në projektet e objekteve të reja dhe ato të rikonstruara, para dërgimit për sigurimin e lejes së ndërtimit, do të ishte e domosdoshme. Qendrat shëndetësore në komuna në përgjithësi janë godina 1 kat, por asnjë prej tyre nuk ka rampë, ndërkohë që një pjesë e tyre kanë shkallë. I vetmi ashensor në sektorin e shëndetësisë është në repartin e urgjencës në spital. Repartet e tjera të spitalit nuk kanë as rampa. Për shkak se investimet nuk planifikohen dhe miratohen nga kjo drejtori, e cila drejtohet nga Bordi i Drejtorëve, ka patur dhe ka shumë probleme me investimet për rikonstrukcionet e disa qendrave si psh: (i) Qendra Shëndetësore e Shënkollit ka kohë që pikon dhe është jashtë funksionit. Ajo funksionon në kishë (me vullnetin e priftit të komunës); (ii) Qendra Shëndetësore Trashan (1 kat), nuk funksionon mbasi nuk ka përfunduar izolimi.

Gjatë zhvillimit të procesit për hartimin e kësaj strategjie, është përgatitur dhe diskutuar me personat përgjegjës dhe grupet e interesit, analiza SWOT, drejtimet e ndërhyrjeve dhe planet e detajuara afatshkurtra e afatmesme për të garantuar një mjedis pa barriera për PAK.

Aktualisht në Lezhë nuk operon asnjë linjë urbane, përveç linjave interurbane që ndalojnë si tranzit ose terminal. Nga informacioni i siguruar, nuk ekziston asnjë mjet transporti i përshtatur në të gjitha linjat që tranzitojnë këtë qytet dhe nuk ka një vend parkimi të posaçëm për mjetet e PAK. Hapa progresive do të konsideroheshin nëse do të tërhiqej mendimi i grupeve të interesit, të cilët deri tani nuk janë përfshirë në diskutime mbi ofrimin e transportit të përshtatur. Trajtimi i këtij problemi në një plan lokal të veçantë, ose si pjesë e një plani të përgjithshëm për aftësinë e kufizuar, do të paraprinte ofrimin e

shërbimit të transportit të përshtatur me zbatimin e reformës territoriale, kur territori i bashkisë do të zgjerohet duke përfshirë edhe 9 komuna periferike. Në këtë kuadër nevoja për linjë autobusi/minibusi do të jetë prioritet.

Për të përmirësuar situatën propozohet: (i) të përgatiten instrumenta të plotësuar e të detajuar për të gjitha llojet e ndërtimeve (banesa, ndërtesa e rrugë), në formën e Eurokodeve, ku të përfshihen edhe kërkesat e standartet e përshtatshëmrisë ndërtimore (përfshi edhe rregulloren “Për shfrytëzimin e hapësirave nga PAK” si anekse të tyre); (ii) të përgatitet një Manual Projektimi (KTP nuk janë të plota), i cili të jetë praktik dhe i përdorshëm nga projektuesit, zbatuesit dhe strukturat e kontrollit; (iii) të forcohen kompetencat e strukturave përgjegjëse bashkiake ose të ngrihet një strukturë/person i veçantë që të kontrollojë aspektin e përshtatshëmrisë ndërtimore, para miratimit të lejes si edhe gjatë zbatimit të projektit; (iv) të informohet në vijimësi biznesi në lidhje me nismat dhe lehtësirat e nevojshme nga bashkia, mbi përshtatshëmriinë ndërtimore.

Ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve të të gjithë aktorëve përgjegjës, vlerësohet si shumë i domosdoshëm dhe mbetet një element i rëndësishëm që duhet mbajtur në konsideratë e duhet planifikuar në vijimësi.

Roli i aktorëve kryesorë në nivel qendror dhe vendor është shumë i rëndësishëm gjithashtu për zbatimin e hapave konkrete në realizimin e ndërhyrjeve të fushës së ndërtimeve/infrastrukturës. Pushteti qendror duhet të mbështesë me aktet të plota nënligjore sigurimin e instrumentave monitoruese e veçanërisht me Rregulloret e reja model, në zbatim të ligjit “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (Rregullorja Model e Planifikimit të Territorit dhe Rregullorja Model e Zhvillimit të Territorit). Siç është përmendur në këtë strategji, rol të veçantë në planifikimin dhe kontrollin mbi territorin kanë strukturat vendimarrëse dhe administrative në bashki e Këshill Bashkiak si edhe strukturat e sigurimit të teknologjisë së sinjalistikës horizontale dhe vertikale. Vlen të përmendet që Këshilli Bashkiak është mbështetës në aktivitetet mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Siç është theksuar më lart në këtë strategji, është e domosdoshme, e rekomanduar edhe nga drejtues e specialistë vendorë në Lezhë, aktivizimi i një aktori të ri – strukturë monitoruese për nivelin e përshtatshëmrisë në objektet e reja/dhe egzistuese dhe ndjekjen e zbatimit/përmirësimit të tyre. Për hapat e përcaktuara në planin e veprimit në vijim janë të domosdoshme gjithashtu parashikime e planifikime buxhetore. Fillimisht, propozohet që të parashikohet dhe përdoret një përqindje e caktuar e buxhetit të bashkisë Lezhë dhe më tej të kërkohen edhe fonde nga niveli qendror.

## ***ii. Drejtimit e ndërhyrjes në fushën e përshtatshëmrisë së mjedisit të ndërtuar***

Në këtë pjesë, analizohen drejtimit strategjike dhe ndërhyrjet konkrete, me qëllim realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për ata e familjet e tyre.

Objektivi strategjik, për të realizuar përshtatshmërinë e mjedisit të ndërtuar dhe transportit për përdorim nga personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës, do të jetë:

*“Personat me aftësi të kufizuara integrohen në jetën shoqërore në mënyrë të pavarur, përmes sigurimit të përshtatshmërisë së mjedisit dhe sigurimit e përdorimit të mjeteve të përshtatura të transportit dhe komunikimit”*. Për realizimin e këtij objektivi duhet punuar në dy drejtime: a) në shmangien e shfaqjes së barrierave në projektet e reja në ndërtime, transport e komunikim; b) heqjen graduale të barrierave në objektet egzistuese ndërtimore, transport e komunikim, duke filluar me plane të detajuara për eliminimin e barrierave në objektet publike.

### **Ndërhyrja 1. Ndalimi i menjëhershëmi krijimit të barrierave të reja dhe planifikimi për heqjen e barrierave egzistuese në mjedisn e ndërtuar, transport e komunikim, duke rishikuar instrumentet vendorë dhe siguruar përfaqje me planin e përgjithshëm të zhvillimit lokal**

Për arritjen e këtij objektivi nevojitet jo vetëm vullnet për zbatimin e ligjit, por edhe instrumente të saktë të kontrollit mbi territorin, ndaj propozohet:

- Hartimi i *“Rregullores Vendore të Planifikimit të Territorit”* dhe *“Rregullores Vendore të Zhvillimit të Territorit”*, në zbatim të ligjit *“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”*, dhe plotësimi i tyre me kërkesat dhe standartet e përshtatshmërisë ndërtimore.
- Të saktësohen në nene të veçanta të *“Rregullores Vendore të Planifikimit të Territorit”* dhe *“Rregullores Vendore të Zhvillimit të Territorit”*, kërkesat për detyrimin e vendosjes së elementëve të përshtatshmërisë për çdo leje të re ndërtimi, si edhe për vendosjen e tyre në objektet ekzistuese.
- Të saktësohet në *“Rregulloren Vendore të Zhvillimit të Territorit”* lista e dokumentacionit, përfshi projektin e veçantë mbi përshtatshmërinë, në formularët e aplikimit për çdo projekt të ri (infrastrukturë rrugore/ objekte/strukturë ndërtimore) që paraqitet për leje ndërtimi.
- Të detajohet në *“Rregulloren Vendore të Planifikimit të Territorit”* dhe *“Rregulloren Vendore të Zhvillimit të Territorit”*, dokumentacioni i reduktuar në formularët e aplikimit për leje për vendosjen e elementëve të përshtatshmërisë në infrastrukturë rrugore dhe objektet ekzistuese.
- Të miratohet *“Rregullorja Vendore e Planifikimit të Territorit”* dhe *“Rregullorja Vendore e Zhvillimit të Territorit”* në Bashki e Keshill Bashkiak.
- Të plotësohet informacioni (me të dhëna të detajuara dhe foto) për të gjitha objektet e ndërtuara pa leje, për të lehtësuar vendimmarrësit mbi qëndrimin ndaj tyre.

- Të plotësohet informacioni (me të dhëna të detajuara dhe foto) për të gjitha objektet e ndërtuara pa leje, për të lehtësuar vendimmarrësit mbi qëndrimin ndaj tyre.
- Vendim i veçantë i Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak mbi aplikimin e standarteve të përshtatshmërisë në të gjitha rikonstruksionet e aseteve të bashkisë.
- Rishikim i projekteve të rikonstruksionit për asetet e bashkisë në vitin 2015, në drejtim të aplikimit të standarteve të përshtatshmërisë.
- Hartimi i një plani bashkiak për heqjen graduale të barrierav ekzistuese në mjedisin e ndërtuar.
- Miratimi nga Këshilli Bashkiak i planit për heqjen e barrierave ekzistuese në mjedisin e ndërtuar dhe detajimit të tij për çdo vit pasardhës.
- Monitorimi i planit bashkiak për heqjen e barrierave në objektet ekzistuese dhe raportimi periodik pranë Këshillit Bashkiak

**Ndërhyrja 2. Rritja e kapaciteteve të strukturavepërgjegjëse, për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit për të respektuar të gjitha standartet në parandalimin e barrierave në projektet e reja dhe në eliminimin gradual të barrierave egzistuese.**

Për arritjen e këtij objektivi propozohen disa masa konkrete:

- Trajnimi në vijimësi për stafin e zyrës së urbanistikës në bashki, kontrollin e projekteve, këshillin teknik, komisionin e planifikimit të territorit pranë Këshillit Bashkiak, inspektoriatin ndërtimor e urbanistik vendor, etj, për të parandaluar shfaqjen e barrierave në objektet e reja dhe heqjen e barrierave në objektet egzistuese. Trajnimi do të kryhet edhe për stafin e departamentit të transportit në bashki, për të paraprirë mos lejimin e blerjes dhe qarkullimit të mjeteve të papërshtatura të transportit urban e ndërrurban, veçanërisht mbas zbatimit të reformës territoriale, kur territoret e bashkisë zgjerohen.
- Ndërgjegjësim dhe njohje e subjekteve projektuese dhe zbatuese mbi detyrimet ligjore për zbatimin e kërkesave dhe standarteve të përshtatshmërisë, në objektet e reja dhe ato në proces ndërtimi ose rikonstruksioni.
- Ndërgjegjësim dhe njohje e pronarëve/administratorëve të bizneseve private mbi detyrimet ligjore për zbatimin e kërkesave dhe standarteve të përshtatshmërisë në objektet e reja dhe ekzistuese.

**Ndërhyrja 3. Forcimi i rolit të Pushtetit Vendor në realizimin e mjediseve dhe transportit të përshtatur përmes përmirësimit dhe plotësimit të legjislacionit**

Në këtë kuadër propozohen të ndërmerren disa masa konkrete:



- Vendim i veçantë i Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak mbi aplikimin e standarteve të përshtatshmërisë në të gjitha projektet e rikonstruksionit të aseteve të bashkisë, duke filluar nga viti 2015.
- Bashkia dhe Këshilli Bashkiak të propozojnë e miratojnë kërkesa të forta mbi detyrimet ligjore për vendosjen e elementëve të përshtatshmërisë për çdo leje të re ndërtimi, si edhe për vendosjen e tyre në objektet ekzistuese gjatë rishikimit e miratimit të *“Rregullores Vendore të Planifikimit të Territorit”* dhe *“Rregullores Vendore të Zhvillimit të Territorit”*.
- Bashkia dhe Këshilli Bashkiak të forcojnë kërkesat e detyrimit për përshtatshmëri për të gjithë subjektet që hartojnë dhe zbatojnë projektet e sinjalistikës vertikale dhe horizontale, si edhe në caktimin e vend - parkimeve në qytet. Propozim për Vendim në Këshill Bashkiak.
- Këshilli Bashkiak të forcojë kërkesa e detyrimit për përshtatshmëri në mjetet e transportit publik, në sigurimin e licencës për linja urbane & interurbane. Propozim për ndërhyrje në legjislacion.
- Miratimi nga Këshilli Bashkiak i planit për heqjen e barrierave ekzistuese në mjedisin e ndërtuar dhe detajimit të tij për çdo vit pasardhës.
- Këshilli Bashkiak të detyrojë e të parashikojë aplikimin e një % të buxhetit të bashkisë për zbatimin e elementëve të përshtatshmërisë në të gjitha projektet e rikonstruksioneve të objekteve/aseteve publike ekzistuese.
- Monitorimi i planit bashkiak për heqjen e barrierave në objektet ekzistuese dhe raportimi periodik pranë Këshillit Bashkiak..

**Ndërhyrja 4. Në bashkëpunim me sektorët përgjegjës në Bashki, të krijohet baza e të dhënave për realizimin e ndërhyrjeve në objektet ekzistuese, për ti bërë ato të përshtatura.**

Në zbatim të këtij objektivi, është propozuar edhe një plan masash emergjente:

- Të vlerësohet dhe evidentohet niveli i përshtatshmërisë në objektet egzistuese, duke filluar nga objektet publike/asete të bashkisë (objekte, rrugë, sinjalistikë, vend-parkime, mjete të transportit publik), objektet arsimore dhe shëndetësore, objekte kulturore, si edhe ato private;
- Të përgatitet lista e objekteve (fillimisht publike), duke i renditur ato sipas prioriteteve dhe frekuentimit si dhe nevojave për rikonstruksionin e tyre;
- Të hartohet një plan me projekte konkrete (projekt ide) për ndërhyrje për përshtatjen e objekteve, duke filluar nga objektet publike me frekuentim më të

- lartë. (Përshtatja e qendrave shendetësore dhe qendrave sociale, kopshteve dhe shkollave, zyrave të institucioneve vendore, qendrave kulturore/sportive, infrastrukturës dhe sinjalistikës rrugore urbane, mjeteve të transportit urban e interurban);
- Të përfshihen në buxhetin e bashkisë fondet për përshtatjen e objekteve sipas prioriteteve, bazuar në vlerësimin e situatës, projektet e përgatitura dhe në konsultim me sektorët e tjerë në bashki.

**Ndërhyrja 5. Krijimi/forcimi i strukturave ekzistuese të kontrollit të ndërtimeve për aplikimin e standarteve të përshtatshëmrisë ndërtimore. Të krijohet strukturë /përshtatet struktura vendore përkatëse dhe të rishihen përgjegjësitë e tyre në drejtim të forcimit të kërkesave.**

Për realizimin e këtij objekti, kjo strategji propozon:

- Të caktohet një person brenda strukturës ekzistuese të kontrollit të projekteve (lejeve të ndërtimit) dhe zbatimit të tyre, për të kontrolluar dhe mbajtur përgjegjësi për aplikimin e kërkesave dhe standarteve të përshtatshëmrisë në objektet/infrastrukturën rrugore. Të propozohet për Vendim të Këshillit Bashkiak.
- Të krijohet një strukturë e veçantë ose të caktohet person përgjegjës (arkitekt ose inxhinier) pranë Zyrës Rajonale të SHSSH për të kontrolluar e konfirmuar aplikimin e kërkesave dhe standarteve të përshtatshëmrisë, në objektet që paraqiten për leje ndërtimi. Të mbështetet me një propozim ligjor nga MMSR.

**Ndërhyrja 6. Të parashikohen burime financiare për heqjen graduale të barrierave në objektet ekzistuese.**

Në zbatim të këtij objekti Bashkia dhe Këshilli Bashkiak, duhet të planifikojnë një % të buxhetit vjetor të bashkisë (nga fondi për rikonstrukcion dhe mirëmbajtje) për përshtatjen e objekteve shëndetësore, arsimore, social – kulturore dhe infrastrukturë rrugore. Në këtë kuadër janë propozuar disa masa dhe një buxhet paraprak për arritjen e nivelit bazë të përshtatshëmrisë në objektet si më poshtë:

1. Aplikimi i standarteve të përshtatshëmrisë në projektin e rehabilitimit të sheshit qëndror të qytetit. Në këtë kuadër, të aplikohen standartet e përshtatshëmrisë në hyrje të bashkisë me qëllim sigurimin e shërbimeve nga PAK, në sportelet e informacionit në katin përdhe dhe në hyrjen në Pallatin e Kulturës.

2. Aplikimi i standarteve të përshtatshmërisë në godinën e bashkisë me qëllim arritjen e nivelit bazë të përshtatshmërisë dhe aksesit nga PAK.
3. Aplikimi i standarteve të përshtatshmërisë në projektin e rikonstruksionit të Pallatit të Kulturës
4. Aplikimi i standarteve të përshtatshmërisë në projektin e rikonstruksionit të pjesës së ekspozimit të relikeve (në katin përdhe të godinës së bibliotekës)
5. Aplikimi i standarteve të përshtatshmërisë në shkollat 9 vjeçare ku janë duke u kryer punime rikonstruksioni dhe ato që janë planifikuar për rikonstruksion gjatë vitit 2015.
6. Aplikimi i standarteve të përshtatshmërisë në një shkollë model në qytet
7. Aplikimi i standarteve të përshtatshmërisë në poliklinikën dhe në qendrat shëndetësore të qytetit/komunave.
8. Përshtatja e trotuareve në kryqëzimet e rrugëve dhe rrugët e brendshme në blloqet e banimit.

### **Ndërhyrja 7. Të rritet atraksioni turistik i qytetit ë Lezhës, duke garantuar përshtatshmërinë e mjedisit për të gjithë.**

Lezha është një qytet me shumë resurse turistike, ndaj edhe rritja e atraksionit turistik të qytetit është një nga objektivat e rëndësishëm të strategjisë së zhvillimit të këtij qyteti. Gjykojmë që atraksioni turistik do të ishte i mangët në rast se planet e zhvillimit në zbatim të tij, do të jenë përjashtues për kategori të caktuara të komunitetit siç janë Personat me Aftësi të Kufizuara dhe mosha e tretë. Në këtë kuadër, ky objektiv merr një vlerë të veçantë dhe është i lidhur me realizimin e të gjithë objektivave të tjerë dhe projektet e propozuara në zbatim të strategjisë mbi përshtatshmërinë ndërtimore të mjedisit. Në këto kushte, Bashkia dhe Këshilli Bashkiak duhet të forcojnë masat për rritjen e nivelit të përshtatshmërisë së mjedisit, përfshi objektet me atraksion turistik, në këtë qytet e veçanërisht:

- Të vlerësohet sa më parë niveli i përshtatshmërisë në objektet muzeale, arkeologjike e të kulturës në pronësi dhe/ose në administrim të bashkisë.
- Të bashkëpunohet me institucionet përgjegjëse të kulturës, arkeologjisë dhe turizmit, për të propozuar projekte konkrete dhe siguruar financime, me qëllim garantimin e përshtatshmërisë së objekteve që promovojnë turizmin
- Të merren masa detyruese për operatorët privatë në sektorin e turizmit, që të zbatojnë kërkesat dhe standartet e përshtatshmërisë në objekte në shërbim të turizmit

## IV.2. Shërbimet sociale dhe shëndetësore

### i. Vlerësimi i gjendjes

Numri i personave me aftësi të kufizuara, të regjistruar dhe të cilët përfitojnë nga pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar në Bashkinë Lezhë është 422, prej të cilëve 63 janë të verbër, 47 para e tetraplegjikë dhe 312 persona me aftësi të kufizuara fizike e mendore (shih figurën 3.), me një minorancë tejet të vogël të përfitueseve femra (42.8%, n=181).




Figura 3. Persona me aftësi të kufizuara sipas kategorisë së përfitimit

Gati cereku i përfituesve (n=127) janë edhe përfitues të pagesës së kujdestarisë dhe një e dhjeta e tyre përfitojnë paketë higjieno sanitare (n=47).

Figura 4, tregon shpërndarje e personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Lezhë, sipas grupmoshave. Numri i regjistruar i invalidëve të punës është 567 persona.




Figura 4. Persona me aftësi të kufizuara sipas moshës

Nevoja për shërbime për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me nevojat, vazhdon të mbetet e madhe në bashkinë Lezhë. Drejtoria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, funksionon që prej vitit 1993, por është kryesisht e fokusuar kryesisht në administrimin e pagesave në para për shkak të aftësisë së kufizuar. Për më tepër, kjo drejtori, nuk trajton vetëm problematikat e pagesave të aftësisë së kufizuar, por ka në fokus të veprimtarisë së saj edhe individë, familje dhe grupe të tjerë të marxhinalizuar. Ajo përbëhet nga tre sektorë: (a) Sektori i ndihmës ekonomike, në përbërje të të cilit janë dy persona; (b) Sektori i paaftësisë, në përbërje të të cilit është vetëm një person; (c) Sektori i Barazisë Gjinore, i përbërë nga një staf. Në këtë drejtori, nuk ka një person të nominuar për të trajtuar vetëm problematikën e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me nevojat e tyre. Në morinë e problematikave që mbartin edhe grupet e tjera vulnerabël, problemet e nevojat e personave me aftësi të kufizura, janë parë si detyrim i organizatave jofitimprurëse dhe mendohet se janë të zgjidhura përmes trajtimit të një numri të kufizuar individësh në qendrën ditore shtetërore, e cila ushtron aktivitetin në qytet. Roli i bashkisë, kryesisht, konsiston në përgatitjen dhe miratimin e listave të përfituesve të ndihmës ekonomike dhe përpilimin e listave për personat me aftësi të kufizuara, të cilët komisionohen në Komisionet Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë. Edhe pse ekziston një person, që ka në përgjegjësinë e tij listat dhe pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar, shihet si një domosdoshmëri emërimi i një personi, i cili duhet të ketë një përshkrim pune, që tejkalon atë të shpërndarësit të pagesave në para të përfitimeve për shkak të aftësisë së kufizuar. Ky rekomandim vjen edhe në përputhje me caktimin e personave të posaçëm të personelit për çështje të aftësisë së kufizuar, si rrjedhojë e parashikimit në Ligjin nr.93/2014, datë 24.7.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. Një praktikë e mirënjohur, që mund të ndiqet në këtë rast, është ajo e njësive për mbrojtjen e fëmijëve brenda njësive të pushtetit lokal.

Paralelisht, në Bashkinë Lezhë funksionon edhe Drejtoria e Programeve të Zhvillimit dhe Qeverisjes Elektronike, e cila koordinon punën për hartimin e nxitjen e zbatimit të strategjive lokale për grupet në nevojë në bashki, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara.

Të dhënat që mblidhen aktualisht në Bashkinë Lezhë për personat me aftësi të kufizuara, janë të fragmentuara, sipas specialistëve, dhe nuk lejojnë marrjen dhe përpunimin e informacionit, në një mënyrë të tillë që të krijojë mundësi për të marrë vendime të përshtatshme apo për të orientuar në një rrugë të duhur politikat lokale.

Gjatë tre viteve të fundit, Bashkia Lezhë nuk ka ngritur asnjë shërbim të ri për personat me aftësi të kufizuara, ndërkohë që edhe roli i OJFve që ofrojnë shërbime nuk ndihet shumë në këtë bashki.

Në territorin e Bashkisë Lezhë, ushtron aktivitetin një qendër ditore zhvillimi, shtetërore, me karakter socialo-edukativ. Në të, trajtohen klientë nga mosha 6-35 vjec dhe

që i përkasin të gjithë spektrit të aftësive të kufizuara. Qendra ka karakter rajonal dhe mbulohet kryesisht nga fonde të buxhetit të shtetit. Megjithatë, Bashkia Lezhe kujdeset për mirëmbajtjen dhe lehtësimin e aktiviteteve të ndryshme të organizuara nga qendra. Numri i klientëve, të cilët marrin shërbime në qendër, është 35 persona, 8 prej të cilëve janë femra. Figura 5, tregon shpërndarjen e klientëve të qendrës sipas grupmoshave.




Figura 5. Persona me aftësi të kufizuara në qendër ditore sipas moshës

Vetëm një e treta e përfituesve (n=12) vijnë nga Bashkia Lezhë. Sic duket edhe në figurën 6, klientët e tjerë vijnë nga bashkitë dhe komunat përreth.




Figura 6. Persona me aftësi të kufizuara në qendër ditore sipas vendbanimit

Qendra mbështetet me fonde të buxhetit të shtetit (MMSR), por juridikisht është nën varësi të Bashkësi Lezhë, e cila ka ofruar ambientet, por ndihmon edhe në organizimin e aktiviteteve të ndryshme. Drejtuesit e qendrës ngrenë problemin e transportit, pasi gati tre

të katërtat e klientëve vijnë cdo ditë nga komuna jo fort të afërta. Problem mbetet gjithashtu edhe lidhja me institucionet e tjera si ato të arsimit, formimit profesional dhe edukimit, pasi vizioni i qendrës është shërbimi i integruar për klientët e saj. Drejtuesit e qendrës, pohojnë se kërkesat për të marrë shërbime në qendër janë më të mëdha se mundësitë reale të qendrës. Për më tepër, ambientet janë të vogla, jo të aksesueshme për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

Ekziston një qendër rehabilitimi për fëmijë me probleme dëgjimi, e cila ndodhet jashtë qytetit (Piraj) dhe mbështetet nga Caritas që prej vitit 2001. 19 fëmijë të grupmoshave 3-17 vjeç jetojnë në këtë qendër rezidenciale dhe marrin të gjithë trajtimin e shkollimin e duhur. Klientët në qendër vijnë nga të gjitha zonat e vendit. Në territorin e Bashkisë Lezhë vepron edhe një organizatë e re që ofron shërbime për fëmijët me autizëm (terapi të foluri e zhvillimi) (n=12), kundrejt kontributit të prindërve dhe familjarëve.

Po ashtu, nën administrimin e Bashkisë Lezhë është edhe një qendër ditore për individë të moshës së tretë, numri i të cilëve arrin 67 persona. Kjo qendër, frekuentohet edhe nga persona me aftësi të kufizuara fizike dhe menaxhohet nga Kryqi i Kuq.

Degët lokale të Shoqatave Kombëtare të të Verbërve dhe Invalidëve të Punës, ushtrojnë aktivitetin në Bashkinë Lezhë. Ato bëjnë avokati në nivel lokal në emër të anëtarëve të tyre. Megjithatë, organizatat e fushës së aftësisë së kufizuar nuk duket të jenë të përfshira në vendimmarrjen lokale e për më tepër, nevojat reale të tyre nuk duket të gjejnë pasqyrim në programet lokale afatshkurtra e afatmesme.

Nuk ka një shifër treguese mbi numrin e kërkesave për shërbime, të cilat marrin një zgjidhje pozitive. Nuk ka një vlerësim të saktë të nevojës për shërbimin e përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë e Lezhës. Mungon një databazë e saktë mbi gjendjen e personave, nevojat dhe llojin e shërbimit të përshtatshëm për to. Kjo vlen për të gjitha grupmoshat, fëmijë, të rritur, apo të moshuar me aftësi të kufizuara.

Mungesa e të dhënave të sakta për nevojën për shërbime, por edhe mungesa e planifikimit të buxheteve specifike për aftësinë e kufizuar, përveç pagesave në para, shihen si pengesa kryesore për mungesën e shërbimeve në Bashkinë e Lezhës. Zinxhiri i shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara nuk funksionon, pasi pjesa më e madhe e personave me aftësi të kufizuara në këtë qytet nuk përfitojnë asnjë shërbim. Bashkëpunimi me OJF që operojnë në fushën e aftësisë së kufizuar, duket se është i kënaqshëm. Bashkia e Lezhës, ka një databazë të OJFve që ofrojnë shërbime në fushë. Është punuar në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve në stafin e Bashkisë Lezhë, por kryesisht nga organizata të vendit apo të huaja. Trajnimet kanë pasur në fokus si të drejtat e legjislationin për personat me aftësi të kufizuara, njohjen e zbatimit të standarteve për personat me aftësi të kufizuara, fuqizimin institucional e organizativ.

Vetë organizatat e fushës së aftësisë së kufizuar shprehen të alarmuar për gjendjen e shërbimeve të ofruara në qytet. Vetëm një minimum prej anëtarëve të tyre marrin shërbime në shërbimet e kufizuara që funksionojnë në Lezhë. Personat me aftësi të

kufizuara janë totalisht të izoluar, pa shërbimet e duhura, pa kujdesin e duhur, pa asnjë akses në jetën normale. Është urgjente krijimi i një sistemi shërbimesh bazë për ta e familjet e tyre, por edhe krijimi i mundësive për të marrë informacion e për të kërkuar shërbime.

Situata e strehimit gjithashtu paraqitet e vështirë për personat me aftësi të kufizuara. Edhe pse ligji i trajton me përparësi, sërish numri i përfituesve nga programet e strehimit mbetet i ulët. Kanë aplikuar 57 individë nga kategoria e personave me aftësi të kufizuara, të cilët gëzojnë statusin e te verbrit te grupit te pare, te invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, te invalidit te punës dhe te invalidit te Luftës Nacionalçlirimtare, prej të cilëve është trajtuar vetëm 1. Ndërkohë, prej janarit të vitit 2005, kanë aplikuar pranë Bashkisë Lezhë, për të përfituar nga programi i kredisë me kosto të ulët gjithsej 797 qytetarë (kryefamiljarë) të pastrehë. Prej tyre, kanë lidhur kontratë me BKT për përfitimin e kredisë të subvencionuar nga shteti, përmes EKB-së, 117 të qytetarë të pastrehë dhe mbeten ende të pa trajtuar në kuadrin e këtij programi 680 qytetarë të pastrehë. Mbështetur në VKM me nr. 527, date 6.08.2014 “Për miratimin e procedurave, kriterëve dhe përparësive për përfitimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët”, pika, “5” e cila shprehet se “Njësitë e qeverisjes vendore, brenda datës 30 janar të çdo viti, paraqesin kërkesat për grante të menjëhershme për banesat me kosto të ulët, pranë ministrisë që mbulon çështjet e strehimit, të shoqëruar me kostot financiare për çdo familje” Bashkia e Lezhës i ka derguar Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, kërkesën për grante të menjëhershme për banesat me kosto të ulët për 11 aplikantë me statusin e paraplegjikut dhe të verber. Aktualisht, nuk ka ndonjë program strehimi aktiv nga Qeveria, e cila po vazhdon të akordojë kredi për ato individë që kanë përfituar më parë dhe për të cilët, procesi ka qenë i ndërprerë.

Në Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë Lezhë, ushtron funksionet e tij edhe Sektori i Shërbimit të Shëndetit Mendor, misioni i të cilit është (a) mbledhja e të dhënave periodike për individë me probleme të shëndetit mendor në rajon, (b) zhvillimi i aktiviteteve promovuese, (c) nxitja e parandalimit dhe identifikimit të hershëm, (d) monitorimi i shërbimeve që ushtrojnë veprimtarinë në territor.

Sipas të dhënave të këtij sektori, numri i personave me probleme të shëndetit mendor në Rajonin e Lezhës është 607 persona, prej të cilëve vetëm 127 persona janë nga Bashkia Lezhë. Raportohet që diagnoza më e shpeshtë të jetë skizofrenia. Grupmosha më e ndeshur e popullatës mbartëse të problemeve të shëndetit mendor është 35-55 vjec. Kryesisht, rastet identifikohen nga mjekët e familjes, të cilët i orientojnë rastet në vizita më të specializuara nga mjekët specialistë. Të dhënat e mbledhura, dërgohen nga DRSH në Fondin e Sigurimit Shëndetësor, me një periodicitet një vjekar. Pavarësisht përpjekjeve dhe nismave të ndërmarra nga kjo drejtori, specialistë të saj mendojnë se nuk punohet mjaftueshëm në drejtim të parandalimit dhe trajtimit të problemeve të shëndetit mendor në qytetin e Lezhës.



Specialistët theksojnë se duhet punuar më shumë në drejtim të identifikimit të hershëm dhe trajtimit më të specializuar të sëmundjeve të shëndetit mendor.

Ndër shërbimet shëndetësore, citohet ai i mbështetur nga Komuniteti San Egidio, një Kabinet Fizioterapie, ku trajtohen mesatarisht 47 fëmijë dhe 37 të rritur në muaj.

Megjithatë, gjendja e pajisjeve të tij, raportohet të jetë jo e mirë, për shkak të amortizimit.

Bashkëpunimi me bashkinë i institucionve rajonale shëndetësore në qytetin e Lezhës konsiston kryesisht në promovimin e shëndetit publik në aktivitete të kryera në shkolla si edhe me grupime vulnerabël. Megjithatë, mbetet shumë për të bërë në drejtim të institucionalimit dhe fuqizimit të marrëdhënieve mes këtij sektori dhe institucioneve të tjera lokale që punojnë për personat me aftësi të kufizuara.

## *ii. Drejtimit e ndërhyrjes në fushën e shërbime sociale e shëndetësore*

Vizioni: *“Personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë e Lezhës trajtohen me dinjitet, përmes sigurimit të së drejtës për të marrë shërbime të përshtatura me nevojat, moshën, gjininë dhe sa më pranë vendbanimit të tyre.”*

### **Ndërhyrja I. Planifikimi i burimeve njerëzore dhe fuqizimi i kapaciteteve të strukturave përgjegjëse.**

Si element i rëndësishëm në garantimin e zbatimit të këtij plani, është fuqizimi i kapaciteteve të stafit i cili do të punojë në Sektorin e Personave me Aftësi të Kufizuara, në Drejtorinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë në Bashkinë e Lezhës. Është urgjent nominimi i një personi, i cili do të punojë vetëm me dizenjimin dhe monitorimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara. Shtimi I një vendi të ri pune në këtë sektor, së pari është një detyrim ligjor që vijon nga Ligji nr.93/2014, datë 24.7.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” dhe së dyti, në morinë e problematikave që ka për shërbime në Bashkinë e Lezhës, personat me aftësi të kufizuara nuk mund të trajtohen së bashku me grupet e tjera në nevojë, por duan një trajtim specifik. Personi përgjegjës duhet të ketë njohuritë bazë të fushës sociale e do të trajnohet në vazhdimësi për shërbimet e nevojshme që duhen ngritur për personat me aftësi të kufizuara e familjet e tyre. Më pas, një strukturë specifike me staf të përgatitur, duhet të ngrihet për të koordinuar, menaxhuar të gjitha nevojat për shërbime që ka individi dhe përshtatjen individualisht të tyre me rrjetin e shërbimeve që duhet të fillojë të operojë në qytet. Po në këtë linjë, funksioni i Administratorit Social duhet të ripërtërihet në përputhje me kërkesat ligjore, duke mos u fokusuar vetëm në plotësimin e dokumentacionit për kategoritë përfituese nga skema e aftësisësë kufizuar, por duke u

përfshirë në identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara në njësitë administrative për të cilat është përgjegjës.

Sa më sipër, shkon në linjë me reformën e modernizimit të sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, sipas modelit Bio-Psiko-Social, si edhe me reformën e shërbimeve sociale, reformat të cilat kanë filluar tashmë nga MMSR.

Një drejtim tjetër, ku duhet punuar në vitet në vijim, është edhe ai i gjithëpërfshirjes së shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara në shërbime të ofruara për grupe të tjera në nevojë si fëmijët, gratë, të moshuarit, romët etj. Trajnimet në vazhdimësi për stafin e qendrave që ofrojnë shërbime dhe që do të ofrojnë ato në të ardhmen, në përputhje edhe me standartet për personat me aftësi të kufizuara, duhen parë me prioritet pasi janë një element i rëndësishëm në shtimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për këtë target grup.

Ndërkohë, rezulton si domosdoshmëri ngritja e kapacitetit të stafit të Bashkisë për të identifikuar nevojat, për të planifikuar në përputhje me këto nevoja në mënyrë strategjike e gjithashtu për të thithur fonde nga burime të ndryshme.

## **Ndërhyrja II. Të realizohet mbledhja e të dhënave të sakta për gjendjen dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Lezhë**

Në mënyrë që të ketë një zbatim real të këtij plani, duhet të synohet nga Bashkia Lezhë mbledhja e të dhënave të sakta mbi gjendjen dhe nevojat që paraqesin personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës. Krijimi i një data baze elektronike me të dhëna të plota në këtë drejtim, duhet parë me prioritet. Realizimi i këtij objektivi do të mundësohet nëpërmjet të dhënave që duhet të mblidhen rregullisht nga Sektori i Personave me Aftësi të Kufizuara, e cili fillimisht duhet të hartojë indikatorët dhe protokollet për mbledhjen e tyre. Mbledhja e të dhënave dhe përditësimi i tyre nga të gjithë ofruesit potencialë të shërbimeve në qytet, është një iniciativë, e cila do të ndihmonte për të orientuar personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre drejt ofruesve të shërbimeve shoqërore në përputhje me nevojat e tyre. Përditësimi i informacionit të detajuar mbi gjendjen dhe nevojat për shërbime, është një indikator, i cili është më së shumti në funksion të zbatimit të objektivit të tretë të këtij plani lokal (shih për më shumë objektivin III).

Njohja dhe vlerësimi i situatës sociale të personave me aftësi të kufizuara synon gjithashtu nxitjen e politikave të reja lokale për mbështetjen e komunitetit sipas prioritetëve. Të dhënat e mbledhura do t'i shërbejnë studimeve më të detajuara, mund të gërshetohen me njëra tjetrën dhe të japin informacion gjithëpërfshirës, lidhje të aftësisë së kufizuar me varfërinë, me punësimin, sëmundshmërinë në grupmosha të ndryshme, prirjet e personave me aftësi të kufizuara në sektorë të ndryshëm të tregut të punësimit e të tjera.

Edhe mbledhja e të dhënave, shkon në linjë me reformat që po ndërmer MMSR, të lidhura këto me reformimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, si edhe reformën e pilotimit të shërbimeve sociale në komunitet.

### **Ndërhyrja III. Të pilotohet, të ngrihet dhe funksionojë zinxhiri i shërbimeve sociale në Bashkinë Lezhë.**

Objektivi i tretë, është orientuar në pilotimin e shërbimeve shoqërore më të domosdoshme, të cilat duhet të përmbushin nevojat e personave me aftësi të kufizuara në këtë rajon. Ngritja e tyre, duhet të ecë paralelisht me realizimin e vlerësimit të nevojave për shërbime në qytetin e Lezhës.

Bashkia Lezhë, ka një traditë të mirë në ofrimin e shërbimeve ditore në qendrën 'Trendafilat'. Pavarësisht kësaj, është e nevojshme që kjo qendër të zgjerohet më tej, për të pritur një numër më të madh përfituesish nga qyteti dhe rrethinat e tij. Po ashtu, është i rëndësishëm, rikonstruksioni fizik i qendrës, për ta bërë atë të aksesueshme për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, përfshi edhe ata me probleme në lëvizje apo përdorues të karriges me rrota. Së treti, për shkak se qendra frekuentohet nga grupmosha të ndryshme, është i rëndësishëm bashkëpunimi me institucionet arsimore, për të realizuar arsimimin e fëmijëve në institucionet e arsimit për të gjithë, si edhe punësimin e atyre klientëve që janë në moshë pune, në përputhje me aftësitë e mundësitë e tyre. Së katërti, duhet të sigurohet transporti i përshtatur për klientët e qendrës.

Bashkia Lezhë duhet të pilotojë ngritjen e shërbimeve *në fushën e ndërhyrjes për fëmijërinë e hershme*, të cilat ofrojnë mundësi të ndryshme shërbimesh për fëmijët parashkollorë që janë në rrezik për të zhvilluar aftësi të kufizuara apo kanë lindur me aftësi të kufizuar fizike, mendore, shqisore etj.. Kjo do të kërkonte caktimin e një stafi koordinues që punon së pari me familjen në bazë të një plani multidisiplinar, duke patur në qendër fëmijën. Në këtë mënyrë, fëmijës do t'i ofrohet ndërhyrje terapeutike multidisiplinare, sipas nevojave të veçanta që paraqet (terapist të foluri, fizik, okupacional, etj.) në mjedisin natyral.

*Pilotimi i shërbimeve të pjesëmarrjes në komunitet:* Këto shërbime do të krijojnë mundësinë e pjesëmarrjes në jetën e komunitetit për individë me aftësi të kufizuara, që kanë nevojë për mbështetje dhe mbikqyrje të vazhdueshme. Aktivitetet do të përfshijnë programe zbatimese dhe shlodhjeje, aktivizimin politik (si pjesëmarrje në shoqata, etj.) si edhe punë vullnetare. Shërbimet e pjesëmarrjes në komunitet i japin mundësinë individëve të ndjehen të integruar, ndërsa komunitetit i japin mundësinë të shohë të gjithë diversitetin e tij, duke kontribuar kështu në zhvillimin e frymës së mirëkuptimit

dhe tolerancës. Individit me aftësi të kufizuara merr pjesë në aktivitete të shoqëruara nga një ndihmë personale.

*Pilotimi i shërbimit të transportit të përshtatur:* Ky shërbim, synon ofrimin e transportit të përshtatur në ndihmë të individëve me aftësi të kufizuara për ndjekjen e aktiviteteve të përditshme si në ambientin e shkollës, punës apo në aktivitete të ndryshme në komunitet. Ky shërbim mund të sigurohet nëpërmjet blerjes të një ose disa mjeteve të përshtatura të transportit publik nga Bashkia Lezhë, apo duke kontraktuar mjete të përshtatura nga qendra apo operatorë privatë që kanë në pronësi mjete të përshtatura transporti, në plotësim të nevojave të personave me aftësi të kufizuara. Sigurimi i këtij shërbimi do të zgjidhte nevojat për transport të përshtatur të qendrave e shërbimeve të tjera sociale që janë në varësi të Bashkisë Lezhë. Ofrimi i këtij shërbimi do të zgjidhte edhe problemet që paraqesin personat me aftësi të kufizuara të cilët banojnë në zonat periferike, ku janë më së shumti të lokalizuara rastet më të rënda dhe të izoluar.

*Pilotimi i shërbimit të Ndihmës Personale:* Është një shërbim i domosdoshëm, krejtësisht në përputhje me Ligjin nr.93/2014, datë 24.7.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, i cili synon në lehtësimin e familjes dhe rritjen e shkallës së independencës e të pjesëmarrjes së individit me aftësi të kufizuara. Shërbimi duhet të fillojë në një numër të kufizuar personash dhe më pas eksperiencën e fituar të shtrihet më gjerë.

*Pilotimi i qendrave për jetesë të pavarur:* Ky shërbim mund të realizohet përmes blerjes apo marrjes me qera të ambjenteve të banimit nga Bashkia Lezhë, me qëllim vendosjen në to për të banuar të 4-5 anëtarëve me aftësi të kufizuara mbi moshën 18 vjeç. Gjatë orëve të pasdites në shtëpi ka staf që ndihmon banorët për kryerjen e veprimtarive të nevojshme si blerje, gatim, pastrim të shtëpise si edhe për higjienën e tyre personale. Edhe gjatë kohës së natës, ka staf për mbështetje dhe mbikqyrje të personave me aftësi të kufizuara.

*Pilotimi i shërbimit “Respite care”:* Ky program i jep familjes mundësi të çlirohet nga përkujdesja e vazhdueshme për personin me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të realizojë funksionet e saj. Studimet kanë treguar se kjo është mbështetja më e mirë që ndihmon në realizimin e “normalizimit” për familjet që kanë anëtarë me aftësi të kufizuara. Shërbimet “Respite” reduktojnë stresin e familjes dhe ndihmojnë në mirëfunksionimin e saj.

Bashkia Lezhë, duhet gradualisht të planifikojë buxhete për ngritjen e shërbimeve shoqërore, të cilat fillimisht mund të konsiderohen si shërbime pilot, me qëllim gjithëpërfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës. Shërbimet mund

të administrohen direkt nga Bashkia, apo mund të kontraktohen agjensi të specializuara e me kapacitete në ofrimin e tyre.

#### **Ndërhyrja IV. Fuqizimi i Ushtrimit të Kompetencave në Fushën e Shërbimeve Shëndetësore**

Kjo ndërhyrje synon të nxisë bashkinë që të mendojë mundësinë e bashkëpunimit më të ngushtë me institucionet shëndetësore rajonale dhe të krijojë terren për të planifikuar mbi nevojat që kanë personat me aftësi të kufizuara, të cilat duhet të realizohen nga ofruesit e shërbimeve shëndetësore. Edhe pse shëndetësia mbetet një përgjegjësi kryesore e pushtetit qendror, pushteti lokal, ka përgjegjësi për kujdesin në familje, shërbime e të tjera. Në këtë drejtim, sygjerimet janë: (a) bashkëpunimi i sektorit të aftësisë së kufizuar me institucionet shëndetësore për të siguruar në kohë identifikimin dhe ndërhyrjen e hershme; (b) bashkëpunim me sektorin e Shëndetit Mendor Në Drejtorinë Rajonale Shëndetësore për të ideuar, projektuar e ngritur fonde për të realizuar ngritjen e një Qendre Komunitare për Shëndetin Mendor (mund të merren modelet e QKSHM, të ideuara nga OBSH në disa qytete të tjera të vendit); (c) ristrukturimi dhe rehabilitimi i qendrës së rehabilitimit fizik.

#### **Ndërhyrja V. Të fuqizohen partneritetet dhe të shkëmbehet informacioni**

Fuqizimi i bashkëpunimit në kuadër të shkëmbimit të informacionit me Zyrat Rajonale të shërbimeve shoqërore, Punësimin, Arsimit, Urbanistikës, Shëndetësisë, Komunitetin e Biznesit, ofrues të tjerë të shërbimeve publike në Bashkinë e Lezhës, duhet të jetë pjesë e punës në vazhdim për ofrimin e shërbimeve cilësore për personat me aftësi të kufizuara në këtë rajon. Në këtë kuadër, rekomandojmë gjithashtu, që të ketë ngritje të kapaciteteve të burimeve njerëzore në lidhje me njohjen e legjislacionit për administratën publike, Kodin e Procedurave Administrative, ligje të fushave specifike të veprimit të institucioneve, kodeve të sjelljes së mirë apo praktikave të mira, njohuri me teknika të ndryshme bashkëpunimi e komunikimi, vendosje të marrëdhënieve të qëndrueshme mes institucioneve, përmes ngritjes së mekanizmave specifikë të bashkëpunimit. Këto mund të jenë mbledhje, platforma të ndryshme elektronike, nënshkrim i memorandumeve të bashkëpunimit etj.

#### **Ndërhyrja VI. Të realizohet rishpërndarja e drejtë dhe rritja e burimeve financiare**

Sigurimi i financimeve të qëndrueshme, përmes të cilave do të sigurohet vazhdimësia e qëndrueshmëria e shërbimeve ekzistuese si edhe planifikimi i shërbimeve të reja, mbetet një nga prioritetet që duhet të kenë Shërbimet Sociale pranë Bashkisë. Një përqindje minimale e buxhetit të Bashkisë, duhet të shkojë çdo vit në drejtim të ngritjes dhe mbajtjes së shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara (rekomandohet 0,5-1%). Është

e rëndësishme të planifikohet e ngrihet zëri në nivel vendor mbi emergjencën për shërbime për këtë kategori, për të rritur të ardhurat e akorduara për Bashkinë e Lezhës nga Pushteti Qendror. Bashkia e Lezhës duhet të përfshijë shërbimet për personat me aftësi të kufizuara në buxhetet që ajo aktualisht akordon për shërbime, por ato duhet të jenë edhe një indikator specifik në raste të projekteve të mbështetura nga donatorë. Shërbimet Sociale në bashki, duhet të luajnë rolin e koordinimit për fonde nga burime të tjera lokale në ndihmë të ngritjes e qëndrueshmërisë së shërbimeve për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Komuniteti i biznesit është një prej burimeve të mundshme lokale për mbështetje.

Për realizimin e të gjitha objektivave të këtij plani veprimi është e domosdoshme të zbatohet një masë shumë e rëndësishme që është parakusht për integrimin e personave me aftësi të kufizuara. Kjo masë ka të bëjë me përshtatjen e mjediseve dhe mjeteve të qendrave ekzistuese që ofrojnë shërbime. Të gjitha qendrat e reja që do të ngrihen duhet të jenë të përshtatura për t'u përdorur lehtësisht nga personat me aftësi të kufizuara. Ky detyrim rrjedh nga "Rregullorja për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara" (VKM nr 1405, datë 19.11.2008); Ligji Nr. 107/2014 « Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit »; Ligji Nr. 10 221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

#### ***Ndërhyrja VII. Përmirësimi i situatës së strehimit të personave me aftësi të kufizuara***

Në lidhje me përmirësimin e situatës së personave me aftësi të kufizuara, rekomandojmë një rol më aktiv të Bashkisë në identifikimin e qytetarëve me aftësi të kufizuara të pastrehë, përmes realizimit të një vlerësimi, për t'i ardhur në ndihmë atyre me nevoja më të mëdha.

Duke pasur në vëmendje përparësinë me të cilën trajtohen nga vetë ligji dhe nga aktet e tjera nënligjore, bashkia duhet të ndjekë procedura të përshpejtuara për personat me aftësi të kufizuara përgjatë procesit të aplikimit dhe lehtësime të tjera. Përmes vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe politikave të tjera aktive, bashkia mund të rrisë gradualisht numrin e përfituesve me aftësi të kufizuara nga programet e strehimit. Gjatë planifikimit të ndërtimit të banesave sociale, Bashkia duhet të konsiderojë krijimin e infrastrukturës së përshtatur për përfitues me aftësi të kufizuara.

### **IV.3. ARSIMI**

#### ***i. Vlerësimi i gjendjes***

Dokumentat politikë dhe ligjorë kombëtarë, ndërkombëtarë, si edhe praktika të mira të krijuara në nivel lokal<sup>4</sup>, udhëheqin qeverinë Shqiptare në nivel qendror, rajonal dhe lokal, për të garantuar të drejtën për arsim gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara duke nxitur zbatimin e tyre për të sjellë ndryshimin sasior dhe cilësor në arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

DAR Lezhë, si struktura përgjegjëse për arsimin për qytetin e Lezhës, evidenton se ka një ndërgjegjësim dhe hapa konkretë në funksion të realizimit të arsimit gjithëpërfshirës. Kjo e ndihmuar nga faktorë të tillë si aprovimi i akteve nënligjore në zbatim të *Ligj Nr. 69/2012 'Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë'*, por edhe i praktikave të mira që po krijohen nga partneriteti i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve me OJF ndërkombëtare dhe vendase<sup>5</sup>, shtrirja e këtij partneriteti në programe konkrete në nivel rajonal dhe vendor, përmes angazhimit konkret të strukturave drejtuese dhe stafëve përgjegjëse për arsimin në qytetin e Lezhës.

Në rrethin e Lezhës, funksionojnë 18 objekte arsimore, 12 publike dhe 6 private. Arsimi parashkollor mbulohet nga 7 kopshte. Shërbimi bazë arsimor mbulohet nga 6 shkolla 9-vjeçare dhe 4 shkolla të mesme, dhe një gjimnaz profesional "Kolin Gjoka".

DAR Lezhë, raporton se numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të përfshirë në kopshte, në arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë në shkollat e Bashkisë Lezhë në vitin mësimor 2014- 2015 është 43, nga të cilët vetëm 27 janë paraqitur dhe komisionuar pranë KMCAP.

---

<sup>4</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

-Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", dhe ligje të tjera në fuqi Udhëzimi nr.38, datë 07.10.2014 "Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar"

-Urdhër i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nr. 344, datë 19.08.2013 "Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko- social"

- Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2009 – 2013

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007 – 2013

- Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Plani i Veprimit, 2005

- Plani i Veprimit për Fëmijë, hartuar nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale e Shanseve të Barabarta, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, 2012-2015

-Programi i OKB-së, "Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit", Programi i "Arsimit për të Gjithë (EFA)"

- Deklarata e Salamankës dhe plani i veprimit për edukimin për fëmijët me nevojë të veçanta/1994

- Konventa për të Drejtat e Fëmijës/ 1989

- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara/ 2006

<sup>5</sup>Praktika disavjecare dhe modelet e krijuara në vend nga SC Shqipëri, World Vision, MEDPAK, FSHDPAK, Ndihamoni Jetën dhe organizatat e tjera lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.




Figura 7. Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara, të paraqitur pranë KMCAP, të përfshirë në kopshte e shkolla

Mbledhja e të dhënave për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte dhe shkolla, është një përpjekje e koordinuar e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe DAR, për identifikimin e nevojave specifike të këtyre nxënësve në funksion të përcaktimit të drejtimeve për ndërhyrje prioritare, me qëllim mbarëvajtjen e procesit mësimor. Mbledhja e të dhënave realizohet mbi baza mujore nga Psikologët e shkollave. Në shumë raste, në mungesë të vërtetimit nga KMCAP (fakt që për psikologët dhe pjesmarrësit e tjerë në vlerësim ishte shqetësues, pasi shumë nga prindërit nuk duan t'i deklarojnë dhe nuk duan ta pranojnë faktin që ata janë me aftësi të kufizuara), evidentimi dhe vlerësimi i tyre realizohet nga psikologët dhe stafi pedagogjik, vlerësim i cili plotësohet më tej nga Komisioni i Vlerësimit i ngritur pranë DAR<sup>6</sup>, i cili ka në përbërjen e tij edhe një mjek.

Figura 8, ofron të dhëna mbi numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të përfshirë në institucionet arsimore të Bashkisë Lezhë me apo pa vërtetim KMCAP, si edhe raportin mes të dy kategorive.

<sup>6</sup>Dispozitat Normative në zbatim të ligjit nr.69/2012, date 21.06.2012 “ Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”






Figura 8. Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara me vërtetim KMCAP, kundrejt atyre që nuk janë paraqitur pranë KMCAP të përfshirë në sistemin arsimor

Ngritja e komisionit të vlerësimit, në nivel DAR dhe pranë shkollave, vlerësohet si një hap i rëndësishëm për të siguruar mirëorganizimin dhe mbështetjen e nevojshme për realizimin e një plani individual për arsimim dhe zhvillim për nxënësit me aftësi të kufizuara, bazuar në specifikat që burojnë nga lloji i aftësisë së kufizuar. Në përbërje të komisionit janë 5(pesë) persona, mësues, njëkohësisht dhe supervizor i SHPS, 1(një) mjek, 1(një) psikolog, 1(një) specialist i shëndetit mendor, 1(një) mësuese e ciklit të ulët me përvojë në trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët japin një vlerësim profesional për fëmijën me aftësi të kufizuara dhe rekomandojnë kopshtin/ shkollën më të përshtatshme për të, sugjerojnë, për drejtuesit e shkollave dhe prindërit, programet e veçanta që duhet të aplikohen në shkolla dhe kopshte si dhe shërbimet mbështetëse që fëmija mund të marrë në komunitet.

Drejtues dhe specialistë të DAR Lezhë, njohin të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga Dispozitat Normative për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Sektori i Kurrikulës dhe Cilësisë, është struktura që ka përgjegjësinë për ndjekjen e procesit të arsimit gjithëpërfshirës. Në përbërje të tij janë 4 (katër) persona, 1 drejtues dhe 3(tre) specialistë, 1 prej të cilëve trajton edhe problematikën e arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Por, detyrat e tij nuk janë të lidhura vetëm me problematikën e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, gjë që ndikon në cilësinë e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të ndërhyrjeve në fushën e arsimit gjithëpërfshirës. Drejtuesit dhe specialistët e përfshirë në vlerësim, në zbatim të akteve nënligjore<sup>7</sup> konsiderojnë si shumë të rëndësishëm rishikimin e strukturës aktuale pranë DAR dhe zgjerimin e sektorit

<sup>7</sup>Ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe Dispozitat Normative

të paktën me një specialist që do të ketë përgjegjësinë për të ndjekur vetëm problematikën e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara. Stafit aktual i sektorit, përfaqësues të Komisionit të Vlerësimit pranë DAR, dhe pranë shkollave, janë përfshirë në trajnime, të cilat janë organizuar kryesisht nga organizata ndërkombëtare, përmendur këtu World Vision. Trajnimet kanë qënë të karakterit të përgjithshëm por edhe të fokusuar në mënyrë specifike në problematikën e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Me rishikimin e strukturës, krahas zgjerimit të sektorit, mbetet domosdoshmëri krijimi i kapaciteteve përmes informacionit të vazhdueshëm, trajnimeve e seminareve për të qënë në koherencë me ndryshimet por edhe për të pasur mundësi për zhvillim të njohurive në një fushë kaq komplekse e të vështirë sikurse është arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Në praktikë vihen re mungesa të theksuara për realizimin e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në përputhje me standartet dhe detyrimet ligjore që lidhen me faktorë frenues si në aspektin organizativ (kryesisht mungesë strukturash), por që lidhen edhe me qëndrimet, sjelljet, mungesa në pajisje didaktike, mungesë profesionistësh, si edhe mungesa financiare. Këto pengesa gjenden brenda vetë nxënësve, shkollave, sistemit arsimor, brenda vetë familjeve dhe mjedisit më të gjerë.

Gjatë procesit të vlerësimit, u evidentua se fëmijët me aftësi të kufizuara, ende nuk përfitojnë nga sistemi arsimor në kushte të barabarta me bashkëmoshatërit e tyre. Megjithëse dispozitat normative i parashikojnë, në shkolla praktikisht mungon(-jnë): (a) infrastruktura fizike, elemente të përshtshmërisë ndërtimore për fëmijët me aftësi të kufizuara fizike; (b) mjete alternative komunikimi për fëmijët me probleme në shikim (tekste me shkrim të zmadhuar apo tekste me shkrim në relief) apo informacioni i thjeshtëzuar për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale, përkthyes i gjuhës së shënjave për fëmijët që nuk dëgjojnë e që nuk flasin<sup>8</sup>; (c) një vlerësim i saktë i aftësive në të nxënë i nxënësve me aftësi të kufizuara; (d) përvojë dhe trajnime për hartimin e planeve individuale të standartizuara për mësuesit në përputhje me specifikat e kategorive e niveleve të ndryshme të aftësisë së kufizuara; (e) tekste dhe udhëzues në ndihmë të mësuesve dhe prindërve të fëmijëve; (f) mjete didaktike për të punuar në mënyrë individuale me fëmijët brenda dhe jashtë institucioneve arsimor; (g) mësues mbështetës; (h) ambiente burimore në shkolla. Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në Bashkinë Lezhë, ofrohet përmes përfshirjes në shkollat e zakonshme. Nuk ka institucione publike që ofrojnë arsim special. Ekziston vetëm një institucion arsimor privat për fëmijët me probleme në dëgjim e komunikim i ngritur që prej vitit 2001, në Piraj. Në këtë shkollë arsimohen 19 fëmijë me probleme në dëgjim, të grupmoshave nga 3-17 vjec, të cilët ndjekin kopshtin dhe shkollën dhe përfitojnë njëkohësisht edhe kujdes rezidencial.

---

<sup>8</sup> Qeveria shqiptare ka zyrtarizuar gjuhën e shënjave, duke marrë përgjegjësinë për ta garantuar atë në institucionet publike, përfshirë ato arsimore, VKM/Datë 3 Dhjetor 2014

Fëmijët janë mbështetur me aparate dëgjimi, për komunikim përdoren alternativa përfshirë gjuhën e shënjave. Fëmijëve ju ofrohet mbështetje psikosociale si edhe trajtim nga një specialist lokopedist.

Mungon një studim/vlerësim i përvitshëm i situatës nga këndvështrimi nevojave specifike për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, për cdo shkollë dhe në nivel DAR për të bërë të mundur më tej një plan të detajuar dhe me buxhete përkatëse për zgjidhjen dhe plotësimin e mangësive të identifikuara, me qëllim që kërkesat të jenë të bazuara në vlerësime konkrete e të detajuara në përputhje me realitetin e shkollave në Bashkinë Lezhe.

Shpesh mangësitë e përmendura më sipër, janë rezultat i mungesës së vëmendjes dhe mos parashtrimit të kërkesave nga drejtuesit e shkollave e më tej nga DAR. DAR duhet të bashkëpunojë edhe me Bashkinë e Lezhës, Drejtorinë e Arsimit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve e cila ka përgjegjësinë në mënyrë të vecantë për realizimin e investimeve sa i përket infrastrukturës, dhe transportit. Për këtë arsye, nevojitet që DAR në projekt-buxhetin vjetor që paraqet në institucionet qendrore dhe në kërkesat e projekt buxhetin që paraqet pranë Bashkisë, të parashikojë edhe zëra financiarë që kanë të bëjnë me realizimin e përshtatshmërisë ndërtimore të shkollave, kopshteve dhe transportit të përshtatur. Në kushtet kur burimet financiare në sektorin e arsimit janë të kufizuara, është domosdoshmëri mobilizimi i burimeve të ndryshme financiare në nivel lokal.

Shërbimi psiko-social vlerësohet si zhvillim pozitiv dhe një pikë e fortë dhe e rëndësishme sa i përket mbështetjes së procesit të përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla. Evidentohet si domosdoshmëri rritja e numrit të tyre dhe pjesëmarrja e tyre në trajnime për trajtimin e çështjeve të lidhura me nxënësit me aftësi të kufizuara si edhe krijimi i ambienteve të veçanta në shkolla me qëllim që ata të mund të zhvillojnë me profesionalizëm detyrat e tyre.

Evidentohet gjithashtu mos informim dhe mos koordinim mes aktorëve të ndryshëm që operojnë në fushën e arsimimit por edhe në fusha të tjera që kanë në fokus aftësinë e kufizuar, kjo shkakton shpesh mbivendosje projektesh, përqëndrim të burimeve në zona të caktuara dhe ngadalësim i procesit të gjithëpërfshirjes. Ndërkohë që, eksperinca të mira të mbështetura nga donatorë, shpesh përfundojnë pa arritur të replikohen apo të bëhen pjesë e sistemit. Kjo kërkon ndërhyrje sa i përket rrjetëzimit dhe ndarjes dhe përthithjes së eksperiencave më të mira.

## ***ii. Drejtimet e ndërhyrjes në fushën e Arsimit***

*Vizioni: Personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë e Lezhës gëzojnë të drejtën për arsim pa diskriminim dhe mbi bazën e mundësive të barabarta. Bashkia Lezhë siguron një sistem edukimi përfshirës në të gjitha nivelet.*

**Ndërhyrja I. Rivlerësim i burimeve njerëzore, planifikimi i pozicionit dhe përzgjedhja e specialistit për arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara; fuqizimi i kapaciteteve brenda strukturave të DAR në funksion të garantimit të arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara.**

Në funksion të përmbushjes së detyrimeve për të garantuar zhvillim sasior dhe cilësor në arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, rekomandohet rivlerësim i Sektorit të Kurrikulës dhe Cilësisë, rishikim i strukturës dhe krijimi i pozicionit të Specialistit për arsimin për fëmijët me aftësi të kufizuara. Kjo ndërhyrje rrit përgjegjshmërinë dhe njëkohësisht mban në fokus të DAR problematikën shumë komplekse të arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ky pozicion garanton vlerësimin, planifikimin, adresimin e problematikave dhe ndjekjen deri në realizim të të gjithë hapave për realizimin e detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat normative, Ligji 69/2012 dhe aktet nënligjore për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e sistemit arsimor në Bashkinë Lezhë.

Përzgjedhja duhet të shoqërohet me fuqizimin e rolit dhe kapaciteteve të tij dhe të strukturave të tjera përfshirë Njësinë e Shërbimit Psiko-social dhe Komisionin e Vlerësimit pranë DAR. Është e rëndësishme që DAR Lezhë në bashkëpunim me MAS të informojnë dhe të organizojnë sesione periodike trajnimesh me specialistin e përzgjedhur dhe anëtarët e komisionit pranë DAR dhe komisioneve në nivel institucionesh arsimore (kopshte, shkolla), për procedurat që duhet të ndiqen dhe respektohen nga ato në zbatim të politikave të MAS.

**Ndërhyrja II. Të realizohet në mënyrë sistematike mbledhja dhe përpunimi i statistikave dhe të dhënave me fokus nxënësit me aftësi të kufizuara si parakusht për ndërhyrje bazuar në nevojat.**

Megjithëse mblidhen të dhëna përmes SHPS dhe komisioneve të vlerësimit të ngritura pranë institucioneve arsimore, rekomandohet rishikimi, shtimi i indikatorëve dhe përditësimi periodik i tyre. Kjo për arsye se treguesit ekzistues janë hartuar përpara ngritjes së komisioneve të vlerësimit dhe ofrojnë të dhëna personale dhe me karakter mjeksor/diagnoza. Këto të dhëna nuk i përgjigjen qasjes bio-psiko sociale dhe nuk ndihmojnë në vlerësimin e nevojave në funksion të realizimit të arsimit për çdo individ me aftësi të kufizuara. Një sistem i dixhitalizuar të dhënash, i ndërtuar me tregues të përgjithshëm dhe specifik për fëmijët me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollat dhe

kopshtet publike të qytetit, me tregues specifik bazuar në vlerësimet e kryera nga komisioni i vlerësimit për çdo nxënës me aftësi të kufizuara do të shërbejë si një bazë e mirë për të vlerësuar situatën e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës dhe do të orientojnë ndërhyrje të nevojshme prioritare, në zbatim të gjithëpërfshirjes së tyre në institucionet arsimore.

### **Ndërhyrje III. Sigurimi i infrastrukturës mbështetëse për të garantuar aksesin dhe cilësinë e arsimimit për fëmijët e të rinjtë me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore.**

Baza e të dhënave( ndërhyrja 2) përmes vlerësimeve periodike, do t'i shërbejë planifikimit të ndërhyrjeve në terma edhe financiarë për të bashkërenduar me institucione që kanë detyrimin ligjor si MAS dhe Bashkia/Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për të garantuar realizimin e infrastrukturën mbështetëse për nxënësit me aftësi të kufizuara, përfshirë (i) përshtatshmërinë ndërtimore dhe transport të përshtatur(ref fushës I në këtë plan), (ii) pajisjen e nxënësve me nevojat vecanta me mjetet arsimore ndihmëse didaktike dhe tekstet e përshtatura, (iii) krijimin e ambienteve burimore brenda institucioneve arsimore, (iv) mësues ndihmës, (v) shprehjet e interpretimit në klasat shkollave të zakonshme, (vi) udhëzues për mësuesit që punojnë me nxënës me aftësi të kufizuara vecanërisht për hartimin e PEI dhe përdorim të metodave të përshtatshme të mësimdhënies për fëmijët me aftësi të kufizuara, etj. Pjesë e rëndësishme e krijimit të infrastrukturës mbështetëse është edhe investimi dhe realizimi i trajnimeve për krijimin e kapaciteteve të stafit pedagogjik por edhe shërbimit psikosocial që punojnë me nxënës me aftësi të kufizuara, për të ofruar mësimdhënie në përputhje me detyrimet dhe standartet e përcaktuara nga MAS dhe institucionet e varësisë. Duhet të planifikohen dhe organizohen cikleve të trajnimeve edhe për specialistë të DAR, drejtues të shkollave dhe kopshteve, për çështje specifike të lidhura me gjithëpërfshirjen. Duhet të synohet përzgjedhja e ekspertëve në fushën e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, dhe certifikimi i trajnimeve në funksion të shtimit të interesit të mësuesve për pjesëmarrje, si edhe në funksion të rritjes së cilësisë dhe standartit të trajnimeve të ofruara.

### **Ndërhyrja IV. Zgjerimi dhe konsolidimi i një partneriteti aktiv mes institucioneve shtetërore, organizatave jofitimprurëse dhe grupeve të tjera të interesit që punojnë apo ndikojnë në realizimin e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.**

Hartimi i një data-baze në nivel lokal, me aktorët të cilët kanë në fokus të programeve të tyre arsimin për fëmijët me aftësi të kufizuara, dhe përcatimi i takimeve periodike për shkëmbimin e vazhdueshëm dhe në kohë të informacionit dhe eksperiencave, është një hap që do të orientojë drejtë programet dhe burimet financiare. Raportet vjetore, buletinet

e përgatitura nga DAR për situatën e arsimit të personave me aftësi të kufizuara, do t'ju shërbejnë institucioneve në nivel qendror, lokal, partnerëve dhe komunitetit më gjerë. Kjo do të mundësojë përfshirje e pjesëmarrje aktive të gjithë rrjetit të institucioneve në Bashkinë e Lezhës me fokus arsimin gjithëpërfshirës.

**Ndërhyrja V. Ndërgjegjësim i komuniteteve, para së gjithash atij të prindërve, familjarëve dhe vetë fëmijëve e të rinjëve me aftësi të kufizuara dhe komunitetit në tërësi, në mbështetje të arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara.**

Fusha e informimit dhe ndërgjegjësimit, para së gjithash për grupet e interesit si edhe për komunitetin, përbëjnë faktor thelbësor në heqjen e barrierave në qëndrime, të konsideruara si më të vështirat drejt realizimit të komuniteteve realisht gjithëpërfshirëse dhe mosdiskriminuese<sup>9</sup>. MAS dhe DAR duhet të planifikojë organizimin e takimeve konsultative dhe informuese, jo vetëm me drejtues dhe specialistë të institucioneve arsimore por edhe me komunitetin e prindërve, nxënësve etj. Në kuadër të nismës "Shkollat si Qendra Komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë", DAR dhe drejtues të shkollave duhet të organizojnë aktivitete ndërgjegjësuese për komunitetin e nxënësve, prindërve dhe mësuesve me qëllim krijimin e një ambienti "mikëpritës" në shkollë për nxënësit me aftësi të kufizuara.

**Ndërhyrja VI. Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të planit lokal për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat dhe kopshtet e zakonshme**

DAR Lezhë është institucioni i cili duhet të monitorojë realizimin e ndërhyrjeve të vendosur në këtë plan lokal, për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla dhe kopshte publike. Për të matur progresin e arritur në zbatim të këtyre ndërhyrjeve për fushën e arsimit, DAR ndërton matricën e monitorimit dhe vlerësimit. Në funksion të informimit të të gjithë aktorëve lokalë por dhe atyre të interesuar, DAR përgatit raportin vjetor të monitorimit dhe vlerësimit dhe buletine periodike.

---

<sup>9</sup> Ligj Nr. 93/2014, Për përfshirjen sociale dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, neni 18.

## IV.4. Punësimi

### *i. Vlerësimi i gjendjes*

Ndërkohë që dokumentat politikë<sup>10</sup> në nivel vendor, ofrojnë informacion në lidhje me punësimin e qytetarëve të Lezhës, përfshirë edhe përfaqësues nga grupet e popullsisë rome dhe egjiptiane, në këto dokumenta nuk gjejmë informacion në lidhje me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Me ratifikimin e KDPAK<sup>11</sup>, shteti shqiptar riafirmoi edhe njeherë detyrimin për të garantuar të drejtën për punësim për personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë kuadri ligjor shqiptar (ref. aneksit2 në këtë dokument) i plotësuar në vite, përfshirë vecanërisht ndryshimet e realizuara gjatë vitit 2014, shpreh dhe mbron interesat e personave me aftësi të kufizuara për punësim dhe trajnim profesional, në praktikë ende nuk po gjen zbatim në nivelin e duhur për të bërë të mundur akses të barabartë e mosdiskriminim për personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë e Lezhës.

Në evidencat e regjistrimit të punëkërkuësve të papunë pranë DRSHKP, gjatë këtyre viteve të fundit, evidentohen edhe punëkërkuësit e papunë me aftësi të kufizuara. Shifrat tregojnë se numri i të regjistruarve të papunë pranë DRSHK së Punësimit Lezhë, për Bashkinë Lezhë, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2014 është 3463, prej të cilëve 1729 femra. Numri i personave me aftësi të kufizuara të regjistruar si punëkërkuës të papunë është 44 prej të cilëve 14 janë femra dhe 28 kryefamiljarë. Formulari i intervistës dhe si rrjedhim edhe të dhënat e mbledhura, japin informacion edhe për nivelin arsimor, kështu nga punëkërkuësit e papunë me aftësi të kufizuara të regjistruar pranë DRSHKP Lezhë, 7 prej tyre kanë nivel më pak se fillor, 11 kanë përfunduar arsimin fillor, 21 arsimin 9 vjeçar, 1 arsimin e mesëm<sup>12</sup>, asnjë arsimin profesional dhe 4 arsimin universitar. Por këto të dhëna nuk paraqesin gjëndjen reale të punëkërkuësve të papunë me aftësi të kufizuara.

---

<sup>10</sup>Plani Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2013-2030, Bashkia Lezhë, 2013

<sup>11</sup>*Neni 27 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, garanton të drejtën e punës dhe punësimin e PAK si të drejta të rëndësishme qoftë në aspektin social të përfshirjes dhe të ndjerit të tyre pjestarë aktiv të shoqërisë, qoftë edhe në atë ekonomik duke i siguruar PAK burimet e nevojshme financiare për të jetuar një jetë dinjitoze nëpërmjet punës së tyre. Për të arritur në këtë praktikë, ky nen kërkon që Shtetet Palë të marrin masa që ambjentet e punës të jenë të arritshme për PAK, pra të lejojnë përdorimin e ambjenteve dhe të garantojnë aksesin në vendin e punës për ta. Gjithashtu, ato duhet të marrin masa kundër diskriminimit në punësim duke përfshirë të gjitha hallkat e procesit të rekrutimit, vazhdimin të punës, apo promovimin në karrierë si të gjithë personat e tjerë. Një rëndësi e veçantë i kushtohet, në kuadër të punësimin të PAK, edhe pagës në proporcion me punën e kryer nga PAK dhe vlerësimin të saj njësoj si për personat e tjere dhe në të njëjtën kohë të drejtave sindikaliste që lindin për shkak të punësimin. Vetpunësimi dhe promovimi i sipërmarrjes së lirë nga PAK është gjithashtu një nga fushat ku Shtete Pale duhet të marrin masa për të mbështetur PAK.*

<sup>12</sup> Terminologjia është ajo që perdoret aktualisht në tabelat statistikore të DRSHKP. Ndryshimi I terminologjise në sistemin arsimor nuk gjendet i reflektuar në institucionet e tjera




Figura 9. Niveli arsimor i punë kërkuesve të papunë me aftësi të kufizuara

Numri i personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë e Lezhës është 989, prej të cilëve 422 janë persona me aftësi të kufizuara, të bërë të tillë për shkaqe që nuk lidhen me punësimin dhe që trajtohen nga skema e shërbimit social pranë Bashkisë Lezhë, dhe 567 janë invalidë pune që trajtohen nga skema e Institutit të Sigurimve Shoqërore.<sup>13</sup> Ndërkohë numri i personave me aftësi të kufizuara në moshë pune është 886, prej të cilëve 464 përfitues nga skema e invalidëve të punës dhe 422 nga skema e shërbimeve sociale.

Po kështu, pranë DRSHKP mblidhen të dhëna në lidhje me tregun e punës. Për mbledhjen e të dhënave organizohet një studim kombëtar 1(një) herë në vit. Anketimi nga Zyrat e Punës në rreth bëhet me qëllim studimin e nevojave për aftësi. Të dhënat bazë periodike mblidhen 1(një) herë në tre muaj dhe ofrojnë informacion për numrin dhe natyrën e aktivitetit të subjekteve shtetërore dhe atyre private, këto të fundit të klasifikuara në ndërmarrje që kanë deri në 25 punonjës dhe ndërmarrje që kanë mbi 25 punonjës, si edhe për numrin e të punësuarve në këto subjekte, bazuar në deklaratimet e subjekteve. Burimet zyrtare të informacionit<sup>14</sup>, tregojnë se numri i subjekteve publike dhe private të deklaruara në Zyrën e Punësimit Lezhë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2014 është 1851 dhe numri i të punësuarve në to po sipas statistikave të së njëjtës periudhë është 8649, prej të cilëve 2745 të punësuar në shtet. Sipas këtyre statistikave, 3581 persona janë të punësuar në ndërmarrje private që kanë deri në 24 punonjës, ndërkohë që 2068 persona janë të punësuar në ndërmarrje private me më shumë se 25 punonjës. Ndërkohë, sipas Drejtorisë Rajonale të Inspektoriatit Shtetëror të Punës, numri i të punësuarve, persona me aftësi të kufizuara në subjektet publike (n=43) është 20 persona, ndërsa numri i të punësuarve, persona me aftësi të kufizuara në subjekte private (n=1808) është 6(gjashtë).

<sup>13</sup>Bashkia Lezhë.

<sup>14</sup>Drejtoria Rajonale e Punësimit Lezhë






Figura 10. Numri i personave me aftësi të kufizuara, të punësuar krahasuar me numrin total të të punësuarve në sektorin publik dhe privat

Pranë Zyrës Vendore të Punësimit Lezhë, mblidhen të dhëna edhe për programet e nxitjes së punësimit duke specifikuar numrin e projekteve sipas fushave të ndryshme të aktivitetit të subjekteve dhe numrin e përfituesve. Ajo që vihet re, është se në formularin me të dhëna, specifikohen vetëm disa projekte, ato bazuar në VKM Nr 47, Nr 48, Nr 873 dhe Nr. 632, dhe programet e tjera klasifikohen në grupin ‘Të tjera’. Nuk është e pasqyruar në formular VKM Nr 248. Sipas këtyre të dhënave, rezulton se nga këto programe, nuk ka pasuar asnjë përfitues, nga grupi i punëkërkuarve të papunë me aftësi të kufizuara.

Gjatë vlerësimit të situatës, pjesëmarrësit, evidentuan disa mangësi në fushën e statistikave. Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar që prek çështjet e punësimit, por më specifikisht në nenin 11 të Ligjit nr.93/2014, datë 24.7.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, shteti ka përgjegjësinë të mbledhë statistika të vecanta për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat, përfshirë atë të punësimit. Evidentimi i të punësuarve me aftësi të kufizuara nga ndërmarjet, ndërkohë që ato janë të klasifikuara, (me 24 punonjës ose me mbi 25 punonjës) do t’i shërbente lehtësimit të procesit të monitorimit të nivelit të zbatimit të detyrimit ligjor<sup>15</sup> dhe do të ofronte një statistikë aktualisht të munguar për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Ndërkohë, statistika duhet të mblidhen në mënyrë të specifikuar edhe për programin e nxitjes së punësimit, VKM 248. Pjesëmarrësit në procesin e vlerësimit/planifikimit të planit të veprimit në fushën e punësimit, propozuan gjithashtu mbledhje dhe raportim mujor dhe me karakter progresiv të statistikave, me qëllim mirëmanaxhimim dhe rritjen e transparencës. Statistikat janë një komponent i rëndësishëm në identifikim dhe më tej në orientimin e drejtë të problematikës, programeve e financimeve sa i përket formimit e punësimit, monitorimin e zbatimit dhe efektivitetin e tyre, dhe për këtë arsye kërkojnë vëmendje dhe ndërhyrje të vecantë.

<sup>15</sup>Ligji nr. 7995, dt. 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit” parashikon në nenin 15 “Detyrimet e punëdhënësit për të punësuar personat me aftësi të kufizuar”.

Strukturat përgjegjëse në nivel lokal të cilat kanë rolin zbatues dhe monitorues të politikave dhe kuadrit ligjor në këtë drejtim janë DRSHK të Punësimit Lezhë, e cila ofron shërbimet e punësimit që synojnë të mbështesin në mënyrë të balancuar dy grupe të mëdha klientësh brenda tregut të punës; punëkërkuarit, përfshirë punëkërkuarit me aftësi të kufizuara dhe punëdhënësit dhe Drejtoria Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror të Punës, Lezhë, institucion që duhet të sigurojë përmes inspektorëve të punës, zbatimin e dispozitave ligjore në lidhje me punësimin, përfshirë punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Ndërkohë që për ndjekjen e aspekteve të formimit profesional, në Bashkinë Lezhë nuk ka Drejtori Rajonale për Formim Profesional. Ky rol, mbulohet nga Qendra e Lëvizshme për Rajonin Verilindor me qendër në Tiranë. Kjo e fundit, vlerëson kërkesat që vijnë nga DRSHKP Lezhë dhe financon instruktorët që ofrojnë trajnime pranë subjekteve të ndryshme private.

Pyetjes nëse ka një plan veprimi për të nxitur punësimin e personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë e Lezhës, përfaqësuesit e institucioneve ju përgjigjën negativisht. Megjithatë përfaqësuesit e DRSHKP Lezhë, informojnë se ka një vëmendje të shtuar ndaj kategorisë së personave me aftësi të kufizuara. Megjithëse, statistikat provojnë që pamvarësisht se Zyra e Punësimit është e hapur dhe ofron shërbime për gjithë punëkërkuarit e papunë dhe gjithë punëdhënësit, kategoria e personave me aftësi të kufizuara nuk ka përfituar nga këto shërbime. Nga diskutimet u evidentua fakti se nuk ka ekspertizë dhe eksperiencë në vlerësimin, këshillimin, orientimin e ndërmjetësimin për punësim për PUPA me aftësi të kufizuara. Për shkak të mungesës së njohurive të mjaftueshme për të kryer vlerësimin e saktë të aftësive dhe nevojave specifike që mund të kenë individë të kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar, stafi e ka të vështirë, dhe shpesh thuhet të pamundur për të ndërtuar një plan veprimi për të mundësuar punësimin e një individi me aftësi të kufizuara. Informacioni dhe trajnimet me fokus PUPA me aftësi të kufizuara ka qënë i munguar. Ndërkohë që raportohet se janë organizuar trajnime me karakter të përgjithshëm, nuk janë organizuar trajnime me fokus problematikën e punësimit të personave me aftësi të kufizuara. DRSHKP dhe DRISHP është përfshirë vetëm në një trajnim me fokus Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku janë trajtuar edhe konceptet mbi mundësitë e barabarta dhe mohimin e përshtatjes së arsyeshmeky i fundit i njohur si shkak që përbën diskriminim në punësim për personat me aftësi të kufizuara. Numri i kufizuar i specialistëve të DRSHKP, mungesa e ambjenteve dhe përshtatshmërisë ndërtimore janë të tjerë faktorë që identifikohen si frenues në ofrimin e shërbimeve të mjaftueshme dhe eficente për punëkërkuarit e papunë me aftësi të kufizuara. Drejtues të DRSHKP, bëjnë me dije se në zbatim edhe të udhëzimeve nga MMSR dhe SHKP, po punohet për ambjente të reja të zyrës së punës, të cilat duhet të jenë në katet e para dhe në qendër të qytetit me synimin për të qënë lehtësisht të arritshme për të gjithë qytetarët, përfshirë ata me aftësi të kufizuara.

Konsiderohet me rëndësi, zgjerimi i strukturës së DRSHKP, duke rritur numrin të paktën me një specialist i cili të ketë përgjegjësinë për të ofruar shërbim të specializuar në të

gjithë hallkat e tij, përfshirë intervistimin, vlerësimin dhe këshillimin e personave me aftësi të kufizuara si dhe ndërmjetësimin e tyre në kurse të formimit profesional apo pranë subjekteve punëdhënëse. Trajnimi i vazhdueshëm i specialistëve të DRSHKP dhe veçanërisht i specialistit që do të ofrojë shërbimin e punësimit për personat me aftësi të kufizuara është shumë i rëndësishëm.

Një tjetër faktor frenues për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, është edhe hezitimi për të kërkuar këtë shërbim, nga vetë individët me aftësi të kufizuara, duke mos u paraqitur pranë zyrave të punës për të përfituar nga shërbimet që ajo ofron. Ka arsye të ndryshme se përse ata nuk paraqiten pranë këtij institucioni, arsye të cilat u evidentuan si nga specialistët e zyrave të punës por edhe vetë individë me aftësi të kufizuara dhe përfaqësues të organizatave të tyre gjatë takimit të organizuar me ta. Disa prej tyre, e shpjegojnë mungesën e interesit, me frikën se në momentin e kërkesës dhe gjetjes së një vendi pune, do të humbisnin pagesën që marrin për shkak të aftësisë së kufizuar, ndërkohë që vendi i punës mund të mos ju ofrojë garanci dhe gjithashtu edhe ata vetë mund të mos ndjehen të sigurtë mbi aftësitë dhe mundësitë për t'u përshtatur dhe për ta mbajtur një vend pune.

Individët me aftësi të kufizuara, përfaqësuesit e organizatave të tyre, por edhe përfaqësuesit e DRSHKP Lezhë, si edhe punonjës të tjerë të pushtetit lokal, nuk ishin në dijeni të ndryshimit të fundit ligjor i cili i krijon individit një periudhë të mjaftueshme 24 mujore për t'u akomoduar në vendin e me procesin e punës, duke ruajtur gjatë kësaj periudhe dhe pagesën që merr për shkak të aftësisë së kufizuar.<sup>16</sup> Ndryshimet e fundit ligjore, paraqesin gjithashtu interes edhe për subjektet punëdhënëse, që punësojnë këta individë, përmes incentivave financiare të garantuara përmes programit/fondit për nxitjen e punësimit, i cili ka parashikuar vec pagave, sigurimeve shoqërore, edhe një financim për realizimin e akomodimit të arsyeshëm, përshtatjen e vendit të punës, garantimin e pajisjeve teknologjike dhe shërbimeve mbështetëse në përputhje me nevojat specifike të individit. Ajo që duhet theksuar, është domosdoshmëria për informim dhe trajnime para së gjithash, të strukturave përgjegjëse në nivel vendor por edhe të gjithë grupeve të interesit, për të marrë informacion të plotë për politikën, kuadrin ligjor vendas dhe ndërkombëtar në lidhje me punësimin dhe formimin profesional të personave me aftësi të kufizuara, për të garantuar zbatimin e tyre dhe realizimin në praktikë të kësaj të drejte.

Për të kaluar nga përfitues pasiv në kontribues aktiv, një punëkërkuar i papunë me aftësi të kufizuara ka nevojë për shërbime mbështetëse. Ky proces, është një proces i vështirë për individin me aftësi të kufizuara, kërkon vlerësim dhe rehabilitim profesional (vocational rehabilitation), punë individuale me një shtrirje në hapsirë kohore në varësi të nivelit të dëmtimit dhe funksionimit të individit, që më tej e orienton në formim profesional apo në punësim/vetpunësim. Ky shërbim është aktulisht i munguar në

---

<sup>16</sup>Ligji nr. 47/2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" (i ndryshuar)

sistemin aktual të shërbimit ofruar nga SHKP përmes DRSHKP dhe Zyrave të Punësimit, dhe përbën ndër faktorët kryesorë të frenimit të punësimit.

Krahas punësimit në tregun e hapur të punës, punësimit përmes programeve të financuara të nxitjes për punësim, DRSHKP Lezhë, ka gjithashtu detyrimin të orientojë personat që paraqiten pranë saj edhe në kurse të formimit profesional. Për të garantuar formim profesional në funksion të përgatitjes së kontigjentit të rregjistruar si punëkërkues të papunë, për t'iu përgjigjur mundësive që ofron tregu i punës, DRSHKP Lezhë, bashkëpunon me Qendrën e Lëvizshme për FP. Në bashkëpunim me Qendrën e Lëvizshme të Formimit Profesional për Zonat Verilindore janë trajnuar 96 persona, nga këta, për profesionin kamarier 2 grupe me 31 persona, receptioniste 16 persona, shërbim hoteli (pastrues) 14 persona, banakier 15 dhe bërës këpucësh 20 persona.

Gjithashtu në bashkëpunim me QFP Shkodër janë formuar 11 persona në profesionin parukieri. Pra në total, gjatë vitit 2014 kanë ndjekur kurse formimi 107 persona, prej të cilëve raportohet se nuk ka asnjë përfitues më aftësi të kufizuara. Po kështu Zyra e Punës, ka bashkëpunuar me vetë subjektet punëdhënëse për të garantuar mundësi për formim profesional përmes punës për punëkërkuesit e papunë. Po t'i referohemi të dhënave të punëkërkuesve të papunë me aftësi të kufizuara, të rregjistruara pranë zyrës së punës, shikojmë që programet e formimit profesional, të terapisë okupacionale dhe rehabilitimit profesional (këto të fundit nuk egzistojnë në bashkinë e Lezhës) janë të domosdoshme për këtë kategori që për faktorë që analizohen në fushën e arsimit, kanë pasur mundësi të kufizuara edhe për arsimim. Ndërkohë, evidentohet se në krahasim DRSHKP dhe Qendrës së Lëvizshme për Formim Profesional, në Lezhë ka organizata të shoqërisë civile të cilat të mbështetura nga projekte e donatorë kanë bërë të mundur që ti ofrojnë këto mundësi edhe për një numur të kufizuar individësh me aftësi të kufizuara.

Kryqi i Kuq Shqiptar, menaxhon një qendër të Formimit Profesional në qytetin e Lezhës, dhe përmes një programi të realizuar në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Gjerman ka ndihmuar për formim profesional 30 vajza dhe gra nga qyteti i Lezhës, mes të cilave edhe tre vajza me aftësi të kufizuara, në profesionin e rrobaqepësisë. Ndërkohë që edhe organizata e të verbërve (organizatë që numëron 65 anëtarë) ka ofruar për anëtarët e vet, kurse për formim profesional për gjuhë të huaja, për programime të ndryshme kompjuterike, sidoms programe në ndihmë të komunitetit të personave që nuk shikojnë, për shkrimin Braill etj.

Në qytetin e Lezhës zhvillon aktivitetin Shkolla e Mesme Profesionale 'Kolin Gjoka', në drejtimet Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Administrim Zyre/sekretari dhe Ekonomi Biznes, shkollë e cila pritet që të rindërtohet për të ofruar standarte bashkëkohore e mundësi për formim profesional për të rinjtë e qytetit të Lezhës, përfshi të rinjtë me aftësi të kufizuara. Ndërkohë mund të shfrytëzohen ambjente, burimet njerëzore dhe materiale, në funksion të ofrimit të kurseve të formimit profesional, edhe

për kategori nga punëkërkuesit e papunë, përfshirë punëkërkuesit e papunë me aftësi të kufizuara.

Subjektet punëdhënëse, si një nga klientët më të rëndësishëm të Zyrës së Punësimit, shfaqin hezitim ndaj punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Kërkesat e Zyrës së Punësimit kanë rezultuar negative, si rezultat i mungesës së ofertave për vende pune të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara nga subjektet punëdhënëse që pretendojnë për mungesë kushtesh të përshtatshme dhe pozicione e kushte pune të vështira për këtë kategori. Sipas specialistëve në DRSHK të Punësimit, mosrespektimi i ligjit nga subjektet private e publike është gjithashtu një nga barrierat kryesore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Po sipas tyre, institucionet publike janë të parat që nuk e zbatojnë këtë ligj. Problem mbetet ndërgjegjësimi i subjekteve publike dhe private për aftësitë, kapacitetet, përshtatjen e ambjenteve dhe proceseve të punës për personat me aftësi të kufizuara, por njëkohësisht edhe për zbatimin e detyrimit ligjor që buron nga Ligji 7995/1995 (i ndryshuar) “Për nxitjen e punësimit” dhe ushtrimi i penaliteteve në rast të moszbatimit të tij.

Për këtë, ato vlerësojnë si shumë të rëndësishme bashkëpunimin me DRISHP, institucion i cili në zbatim të kuadrit ligjor duhet të ndjekë ecurinë e zbatimit të politikave të punësimit të personave me aftësi të kufizuara në tregun e hapur të punës. Sipas DRISHP, gjatë vitit 2014 janë ushtruar 402 kontrolle në subjekte. Gjatë kontrollove në të shumtën e rasteve nuk u kërkohet zbatimi i nenit 25 të ligjit për PAK, megjithëse në modelet e akteve të inspektimit ka një fjali ku thuhet "persona PAK të konstatuar në këtë subjekt", kjo e justifikuar me faktin se për këtë ligj mungojnë aktet nënligjore përkatëse<sup>17</sup>. Sipas Inspektoriatit të Punës, barrierat që pengojnë punësimin e personave me aftësi të kufizuara, janë vende të punës të papërshtatura për PAK, mentaliteti i gabuar si nga punëdhënësit ashtu edhe nga vetë personat me aftësi të kufizuara, mungesa e informacionit, moszbatimi i legjislacionit etj. Për të dalë nga gjendja aktuale, specialistë të këtij institucioni rekomandojnë hartimin e një programi punësimi nga DRSHKP, në varësi të kërkesë-ofertës, në përputhje edhe me mundësitë dhe kapacitetet për punë të personave me aftësitë kufizuara, ndërhyrjen e Inspektoriatit të Punës për të kontrolluar zbatimin e detyrimeve ligjore, plotësimin e ligjit me akte nënligjore, rritjen e bashkëpunimit mes DRSHKP, Inspektoriatit Shtetëror, Bashkisë dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

Aktualisht egziston bashkëpunim i DRSHKP me Sektorin e Ndhmës Ekonomike, pranë Drejtorisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, në Bashkinë Lezhë, por kryesisht i fokusuar në verifikimin e listave të punëkërkuesve të papunë, përfitues të ndihmës ekonomike, me

---

<sup>17</sup> Ende nuk ka dalë një VKM, parashikuar në Ligjin për nxitjen e Punësimit, ligj Nr. 7995/1995 (i ndryshuar) që do të bëjë të mundur krijimin e një fondi ku subjektet të derdhin detyrimin që lind për shkak të mos zbatimit të kuotës për punësim të PAK

qëllim mbështetjen e tyre përmes programeve të punësimit që ofron Zyra e Punës. Egziston bashkëpunim me Dhomën e Tregëtisë dhe Industrisë kryesisht për lidhjen me bizneset, si edhe me Sindikatat, kryesisht për shkëmbim informacioni për kushtet, pagat dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura. Është e rëndësishme që ky bashkëpunim të shtrihet edhe me organizata të shoqërisë civile, kryesisht me fokus personat me aftësi të kufizuara me synimin që sëbashku edhe me aktorët e tjerë, të ofrojnë dhe zgjidhjen e drejtë të problematikës së punësimit të punëkërkuarve të papunë me aftësi të kufizuara.

Nëse i referohemi opinionit të personave me aftësi të kufizuara, përfaqësuesve të organizatave të tyre por edhe të organizatave të tjera që u përfshinë në vlerësimin e situatës, situata rezulton të jetë shumë pesimiste. Personat me aftësi të kufizuara, e vlerësojnë punësimin si shumë të rëndësishëm dhe shprehen se janë të interesuar të ndjekin kurse të formimit profesional mbështetur edhe në aftësitë e tyre me qëllim që të arrijnë përmes mbështetjes së nevojshme, të punësohen apo vetëpunësohen. Ata mendojnë se mund të marrin formim profesional për kompjuter, rrobaqepsi, hoteleri turizëm, sekretari – recepsion, gjuhë të huaja etj. profesione të cilat ata i mendojnë të përshatshme për ta por edhe për tregun e punës. Ndërkohë, ata e shohin punësimin si të lidhur shumë ngushtë me arsimimin.

Si parakusht i domosdoshëm për të vlerësuar mundësitë, shërbimet dhe programet që nxisin punësimin dhe formimin profesional, personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre u nevojitet informacion. Ky informacion është detyrim ligjor të ofrohet nga strukturat shtetërore përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional në nivel lokal. Por, nga ana tjetër, vetë personat me aftësi të kufizuara, dhe organizatat e tyre, pranojnë se nuk janë aktivë për ta kërkuar informacionin që u nevojitet. Ky fakt konfirmohet edhe nga drejtues të DRSHKP. Ata theksojnë se mungesat janë të dyanshme në kuptimin që strukturat shtetërore nuk ofrojnë për ta informacion sipas nevojave që kanë për punë të caktuara apo kurse të formimit profesional, por nga ana tjetër vetë ata nuk praqesin formalisht si individualisht por edhe të organizuar nevojat për punësim dhe formim profesional bazuar në aftësitë. Sipas opinionit të personave me aftësi të kufizuara, dhe familjarëve të tyre të përfshirë në fokus grupe, mungojnë vlerësime në nivel lokal për njohjen e nevojave të personave me aftësi të kufizuara; politika për nxitjen e punësimit dhe formimit profesional të personave me aftësi të kufizuara; struktura dhe specialistë për vlerësimin e aftësive për punë të personave me aftësi të kufizuara; mungon infrastruktura fizike e përshtatur në institucionet ku merret informacioni për punësim dhe formim profesional. Shpesh nga vetë ata ngrihen barrierat për mundësitë që ato duhet të kenë për punësim dhe formim profesional. Izolimi i personave me aftësi të kufizuara shpeshherë ndodh edhe për shkak të mundësive të kufizuara ekonomike të familjeve të tyre. Në shumë raste evidentohet fakti që personat me aftësi të kufizuara kanë vetvlerësim të ulët

dhe nuk njohin aftësitë e tyre për punë. Por ndërkohë, ata e konsiderojnë punësimin shumë të rëndësishëm për tu ndjerë aktiv, kontribues dhe për të përmirësuar në rritjen e cilësisë së jetës së tyre dhe të familjeve.

## *ii. Drejtimet e ndërhyrjes në fushën e punësimit*

Vizioni: *“Personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës, jo më persona pasivë, përfitues të kontributeve, por persona aktivë, kontribues në zhvillimin e qytetit si edhe të gjithë qytetarët e tjerë, përmes realizimit të së drejtës për punësim.”*

**Ndërhyrja I. Rivlerësim i strukturës dhe i shërbimit, planifikim i burimeve njerëzore dhe krijimi i kapaciteteve të tyre, në funksion të rritjes së standartit dhe ofrimit të një shërbimi të specializuar të punësimit për punëkërkuesit e papunë me aftësi të kufizuara.**

Rivlerësimi i burimeve njerëzore dhe përzgjedhja e një stafi për të qënë përgjegjës për të ndjekur problematikën e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, është një nga ndërhyrjet që do të përmirësojë ndjeshëm situatën. Nisur nga detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni përkatës në këtë fushë, por edhe për shkak të problematikës mjaft komplekse që ka kjo kategori, në dallim nga gjithë grupet e punëkërkuesve të tjerë në vështirësi, është domosdoshmëri vendosja e një stafi si specialist që do të ketë përgjegjësinë vec të tjerash të intervistojë, vlerësojë aftësitë për punë të punëkërkuesit të papunë me aftësi të kufizuara, të ofrojë këshillim dhe përgatitje për të hyrë në tregun e punës, orientim për formim të mëtejshëm profesional /apo ose orientim dhe ndërmjetësim për punësim në tregun e hapur të punës, punësim përmes referimit në programet e nxitjes për punësim apo orientim për vetëpunësim. Detyra e tij gjithashtu do të jetë koordinimi me gjithë strukturat e tjera brenda Zyrës së Punësimit, por edhe me struktura të tjera në nivel vendor me qëllim realizimin e të gjitha hallkave që cojnë drejt një punësimi të sukseshmën e të qëndrueshëm. Krahas bashkëpunimit në nivel vendor, kjo strukturë duhet të bashkërendojë edhe me DRSHPK në rajone të tjera, si edhe me Shërbimin Kombëtar të Punësimit në funksion të krijimit të kapaciteteve dhe fuqizimit të shërbimit për punëkërkuesit e papunë me aftësi të kufizuara. Ka përpjekje e plane të përbashkëta të shoqërisë civile<sup>18</sup> dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit, për krijimin e këtij shërbimi, i cili do të ketë në fokus krijimin e guidës për vlerësim dhe shërbim të specializuar për punëkërkuesit e papunë me aftësi të kufizuara, përcaktimin e profilit të punës për specialistin që do të luaj rol in e këshilluesit për punësim për punëkërkuesin e papunë me aftësi të kufizuara dhe subjektet punëdhënëse, krijimin e infrastrukturës së nevojshme në mjedis dhe në mjete për të garantuar funksionim të skemës për këtë kategori për të

---

<sup>18</sup>ëëë.adrf.org.al, Fuqizim ekonomik përmes punësimit për personat me aftësi të kufizuara, program me fokus ngritjen e një shërbimi të punësimit për personat me aftësi të kufizuara FSHDPAK/USAID

garantuar punësimin e qëndrueshëm të tyre. Ristrukturimi i i strukturës brenda DRSHKP, kërkon krahas rivlerësimit të detyrave të specialistit, edhe pajisjen e tij me njohuri për ta kryer këtë rol bazuar në procedura të standartizuara. DRSHKP dhe vecanërisht specialisti që do të ofrojë shërbim të specializuar për PUPA me aftësi të kufizuara, në funksion të përfshirjes së një numri sa më të madh të personave me aftësi të kufizuara në tregun e hapur të punës, duhet që përmes trajnimeve, seminareve dhe fletëve informative, guidave shpjeguese, të informojë së pari vetë stafet e institucioneve përgjegjëse, të DRSHKP dhe DRISHP si edhe subjektet publike dhe private dhe vetë individët me aftësi të kufizuara, për detyrimet që kanë bazuar në ligj, për punësimin e personave me aftësi të kufizuara si dhe për masat lehtësuese të parashikuara në rastet e punësimin të këtyre personave. Fushata ndërgjegjësuere përmes medias, përfshirë median sociale, duhet të promovojnë modelet pozitive për të shmangur stigmën e paragjykimin e për të nxitur punësimin. Pranë laboratoreve të punës të Shkollës Profesionale të qytetit, të ofrohen kurse formimi profesional për personat me aftësi të kufizuara; për këtë qëllim është e nevojshme që edhe instruktorët/ mësuesit e kësaj shkolle, të marrin njohuri për mënyrën se si mund t'i përshtasin programet për përfshirjen dhe mësimin e një profesioni kategorisë së personave me aftësi të kufizuara.

## **Ndërhyrja II. Përmirësimi i sistemit të mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave për situatën e punësimin të personave me aftësi të kufizuara.**

Data – baza ekzistues, duhet të përfshijë mbledhjen e të dhënave që do të prodhojnë raporte në lidhje me punëkërkuesit e paunë me aftësi të kufizuara, sipas grupmoshave, gjinisë, nivelit arsimor, por edhe në bazë të aftësive dhe kapaciteteve dhe nevojave për mbështetje bazuar në shkallën e dëmtimit dhe nivelin e funksionimit. Edhe data baza e të dhënave të subjekteve punëdhënëse, duhet të përfshijë indikatorë sa i përket numrit të të punësuarve me aftësi të kufizuara, ambjenteve dhe proceseve të punës që mund të mundësojnë punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Edhe data baza dhe formularët që ajo gjeneron, me fokus pasqyrimin e programeve të nxitjes së punësimin dhe përfituesve nga këto programe, duhet të plotësohet me programin specifik, ( VKM nr. 248) për të shtuar vëmendjen por edhe për të patur sa më shumë përfitues nga grupimi i personave me aftësi të kufizuara.

## **Ndërhyrja III. Nxitja e formimit profesional, formimit nëpërmjet punës dhe punësimin të punëkërkuesve të papunë me aftësi të kufizuara**

DRSHKP Lezhë në funksion të shërbimit të punësimin që parashikon orientim e ndërmjetësim për punësim, të përcaktojë indikatorë të matshëm për punësimin e punëkërkuesve të papunë me aftësi të kufizuara. Të informojë dhe të realizojë vlerësime të bizneseve mbi mundësitë për pozicione apo përshtatje pozicionesh për punësim në përmbushje edhe të detyrimit ligjor që këto subjekte kanë, por edhe duke i nxitur ato të



aplikojnë në programet e nxitjes së punësimit. Krahas detyrës së infomimit dhe ndërmjetësimit, për subjektet punëdhënëse dhe punëmarrëse, zyra e punësimit duhet të ofrojë dhe këshillim të vazhdueshëm për të dy klientët e saj. Në partneritet me Shkollën e Mesme Profesionale, subjektet private dhe bizneset, Zyra e Punesimit duhet të orientojë PUPA me aftësi të kufizuara drejt kurseve të formimit profesional apo trajnimit nëpërmjet punës. Në përmbushje të këtij objekti, DRSHKP Lezhe duhet të punojë në partneritet me DRISHP i cili ka përgjegjësinë për të realizuar inspektimin e subjekteve punëdhënëse sa i përket zbatimit të detyrimit ligjor, neni 15 i Ligjit nr. 7995/1995 (i ndryshuar) “Për nxitjen e punësimit”.

#### **Ndërhyrja IV. Sigurimi i financimit, në zbatim të politikave të nxitjes së punësimit dhe formimit profesional në nivel lokal.**

DRSHKP Lezhë duhet të bëjë një shpërndarje të drejtë të fondeve të programeve të nxitjes së punësimit për të rritur numrin e përfshirjes së punëkërkesve të papunë me aftësi të kufizuara, për ta kthyer bilancin aktual negativ në kahje pozitive dhe me tendencë në rritje. Për të arritur këtë nevojitet vëmendje dhe vendosje e katagorisë së PUPA me aftësi të kufizuara në grupet prioritare e me nevojat më të shumta për mbështetje. Përmes fondeve të grumbulluaranga burime të ndryshme, përfshirë fondet e derdhura si rezultat i penalteteve nga bizneset për mosrepektim të kuotës për punësim të personave me aftësi të kufizuara, të nxitet ngritja dhe funksionimi i programeve të reja dhe inovative që mbështesin punësimin e PUPA me aftësi të kufizuara, përfshirë vlerësim dhe rehabilitim profesional, kurse formimi profesional, ngritja e bizneseve sociale, iniciativa të vetpunësimit (start ups) etj.

#### **Ndërhyrja V. Monitorim dhe vlerësim i zbatimit të planit lokal për punësimin dhe formimin profesional të personave me aftësi të kufizuara**

DRSHKP Lezhë, është institucioni i cili duhet të ndjekë realizimin e ndërhyrjeve për punësimin dhe formimin profesional të personave me aftësi të kufizuara, të vendosur në këtë plan lokal. Institucionalizimi i tryezave me përfaqësues të institucioneve të tilla si DRISHP, Bashkisë, Shkollës Profesionale, subjekteve punëdhënëse publike dhe private, OJF dhe grupeve të interesit do të krijojë një partneritet të qëndrueshme dhe do të kontribuojë në drejtim të punësimit dhe formimit profesional të personave me aftësi të kufizuara. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet të gjithë aktorëve të interesuar do të ndihmojë për monitorim dhe rivlerësimin periodik të prioriteteve për zbatimin e politikave për punësimin dhe formimin profesional të personave me aftësi të kufizuara në bashkinë e Lezhës. Në funksion të informimit të të gjithë aktorëve lokalë por dhe atyre të interesuar, DRSHKP Lezhë përgatit raportin vjetor të monitorimit për progresin e arritur në zbatim të këtyre ndërhyrjeve

## IV.5. Informimi dhe përfshirja

### i. *Vlerësimi i gjendjes*

Me ratifikimin e KDPAK, situata ligjore dhe praktike e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, është futur tashmë në një proces të gjatë ndryshimesh. Legjislacioni ynë kombëtar është përfshirë në procesin e përshtatjes dhe harmonizimit të tij me standartet ndërkombëtare në fushën e aftësisë së kufizuar. Mund të përmendim si shembull miratimin e Ligjit Nr. 93/2014 datë 24.07.2014 »Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë», si edhe miratimin e dy ligjeve të tjera të rëndësishme, siç janë ai mbi informimin dhe mbi konsultimin publik.

KDPAK vë një theks të veçantë mbi përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara. Motoja e vetë KDPAK është “Asgjë për ne, pa ne”, duke theksuar gjithpërfshirjen dhe eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit, e gjithashtu promovimin e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara. Përfshirja është një parim, i cili është theksuar në nenin 3 të KDPAK dhe patjetër është një mjet për të arritur një vendimarrje gjithëpërfshirëse, ku personat me aftësi të kufizuara janë të pranishëm në të gjithë nivelet e kësaj vendimarrjeje, përfshirë dhe nivelin lokal. Neni 4 i KDPAK kërkon gjithashtu nga Shtetet, që të konsultohen dhe të përfshijnë në mënyrë aktive personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë këtu edhe fëmijët përmes organizatave të tyre përfaqësuese gjatë zhvillimit, hartimit dhe zbatimit të politikave apo legjislacionit.

Në kushtet e një konvente të re, e cila sjell koncepte dhe qasje krejtësisht të reja, nevoja për informim është një nga nevojat më imediate, si për zbatuesit e hartuesit e ligjeve, aq edhe për vetë komunitetin e personave me aftësi të kufizuara dhe shoqërisë në përgjithësi. Është në frymën e kësaj konvente, informimi e ndërgjegjësimi, si detyrime të përgjithshme për shtetet. Kështu, institucionet publike, duke përfshirë edhe pushtetin lokal, kanë detyrime për të siguruar akses në informacion për personat me aftësi të kufizuara dhe nga ana tjetër, kanë detyrime për të trajnuar stafet e tyre, në mënyrë që ato të japin një asistencë e të ofrojnë shërbimet e duhura, në përputhje me standartet e konventës për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara.

Në kuadër të vlerësimit të kryer në Bashkinë e Lezhës dhe në bazë të intervistave të zhvilluara me përfaqësues të institucioneve lokale dhe organizatave lokale, përfaqësues direktë të komunitetit, por njëkohësisht edhe duke u bazuar në shkallën e rëndësisë që ka informimi dhe përfshirja në këtë fazë fillestare të zbatimit të KDPAK për Shqipërisë, vendosëm këtë seksion të posaçëm mbi informimin dhe përfshirjen, si një objektivi apo një drejtim strategjik i këtij dokumenti. Edhe pse përfshirja nga njëra anë mund të konceptohet si një qëllim përfundimtar, për qëllimet e këtij seksioni, ajo do të konsiderohet si një proces i veçantë, i cili shkon paralelisht me të gjithë proceset e tjerë të zhvillimit dhe me vetë përfshirjen të konceptuar si qëllim në vetvete.

Bazuar mbi intervistimet e zhvilluara me përfaqësues të institucioneve, persona me aftësi të kufizuara dhe me përfaqësues të organizatave, që operojnë në Bashkinë e Lezhës, përsa i përket informimit dhe përfshirjes të personave me aftësi të kufizuara në vendimarrje, konsultime, apo dhe përfshirje në një kuptim jo patjetër formal të tyre, në mënyrë të qartë niveli i informimit dhe i përfshirjes është i ulët.

Edhe pse parashikimet ligjore, si në ligjin për pushtetin vendor, por edhe në ligjet e sipërpërmendura, të posaçme, e në rregulloren e miratuar nga Bashkia kërkojnë qartazi një përfshirje të qytetarëve në proceset vendimarrëse dhe konsultative, kjo përfshirje nuk është arritur siç duhet. Sigurisht, që është pikërisht mungesa e informacionit mbi atë se si mund të përfshihen qytetarët me aftësi të kufizuara, apo se si ata mund të informohen, që ka shkaktuar edhe këtë nivel të ulët të zbatimit të këtyre parashikimeve ligjore. Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligji nr. 146/2014 Për njoftimin dhe konsultimin publik dhe Ligji Nr. 93/2014 datë 24.07.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” janë ligje të miratuara së fundmi, e rrjedhimisht akoma bashkitë nuk kanë arritur që të njohin detyrimet që burojnë nga to për pushtetin lokal në veçanti. Përveç këtyre ligjeve, gjatë seancave të zhvilluara në Bashkinë e Lezhës, edhe ligje të tjera të ndryshuara gjatë vitit 2014, që lidhen drejtëpërdrejtë me personat me aftësi të kufizuara, nuk njihen. Kjo për shkak të mungesës së komunikimit dhe koordinimit me institucionet në nivel qendror, sipas përfaqësuesve të institucioneve lokale.

Nga njëra anë, sektorë të ndryshëm brenda Bashkisë duke mos ofruar shumë shërbime, për shkak të mungesave financiare, siç sqarojnë ata, nuk kanë zhvilluar mjete komunikimi, metoda për informimin e këtij komuniteti dhe janë kufizuar në mbulimin e tij me informacion apo përfshirje në mënyrë të ngjashme me pjesën tjetër të komunitetit. Nga ana tjetër, përfaqësues të bashkisë deklarojnë gjithashtu, që vetë komuniteti i personave me aftësi të kufizuara nuk tregon gatishmëri për të marrë pjesë apo për të qënë aktivë.

Ndërsa vetë komuniteti, shprehet të ketë kontakte me bashkinë vetëm në raste kur diskutohen problemet e pagesave të aftësisë së kufizuar. Një problem tjetër, i cili lidhet drejtëpërdrejtë me informimin dhe përfshirjen ka të bëjë me faktin që bashkia, nga pikëpamja infrastrukturore mbetet një institucion i papërshtatur për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara. Për komunitetin e personave me aftësi të kufizuara në lëvizje, kjo përbën pengesën e parë dhe kryesore për të pasur akses në këtë institucion. Patjetër, që barierra infrastrukturore është vetëm një nga llojet e barierrave. Duhet të kemi në vëmendje dhe personat me aftësi të kufizuara në shikim, në dëgjim dhe në të folur, persona me aftësi të kufizuara intelektuale apo me probleme të shëndetit mendor, të cilët ndihen edhe më të përjashtuar. Patjetër që aksesin në informacion dhe në vendimarrje, i përket të gjithë këtyre grupimeve dhe duhet të identifikohen e zbatohen mënyra e praktika për ta siguruar atë.

Nga intervistat e zhvilluara në Bashki, me përfaqësues, specialistë dhe drejtues të këtij institucionin, rezulton që ata kanë një ndjeshmëri të lartë përsa i takon komunitetit të personave me aftësi të kufizuara. Kjo ndjeshmëri shoqërohet edhe më vullnetin për të ndryshuar situatën e përfshirjes së tyre në vendimarrje. Por disa nga sfidat, që stafi i Bashkisë ka për të arritur këtë dhe të cilat u evidentuan gjatë intervistimeve janë: mungesa e informacionit për knoë- hoë, mungesa e fondeve apo projekteve të ndryshme, mungesa e kapacitetit për të pasur platforma, strategji, dokumentë apo praktika të mira të informimit dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara. Megjithatë, ata vlerësojnë si shumë pozitiv faktin, që Bashkia e Lezhës, stafi dhe autoritetet drejtuese kanë vullnet për të përvetësuar dhe për të zhvilluar praktika të mira në drejtim të informimit dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara. Ata vlerësojnë shumë trajnimet, që synojnë rritjen e kapaciteteve dhe kuptimin e saktë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Të tilla trajnime e aktivitete kanë qënë të pakta. Kjo qoftë për shkak të mungesave të iniciativave nga institucionet lokale, por edhe për shkak të një mungese vëmendjeje nga donatorë apo institucionet qendrore.

## *ii. Drejtimet e ndërhyrjes në fushën e informit dhe pjesmarrjes*

### **Ndërhyrja I. Krijimi i një mjedisi pa barriera në informim dhe përfshirje**

Ndërhyrja e parë në këtë drejtim, është krijimi i një mjedisi pa barierra në informim dhe në përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara.

Masat që duhen ndërmarrë në lidhje me arritjen e kësaj ndërhyrjeje mund të jenë të natyrave të ndryshme. Një propozim është ai i hartimit të një ministrategjie komunikimi në nivel bashkie, e cila mund të integrohet në rregulloren bazë të veprimit të bashkisë ose të qëndrojë si dokument më vete. Në rregullore duhet të shihet mundësia e riformatimit të marrëdhënieve me publikun, duke vendosur trajtim më prioritar për personat me aftësi të kufizuara. Këtu, patjetër që mund të përfshihen të gjithë personat, të cilët konsiderohen të riskuar nga diskriminimi, e për rrjedhojë janë të marginalizuar.

Një shembull shumë pozitiv mund të jetë hedhja e disa hapave të parë, si për shembull prodhimi i disa fletëve të informacionit mbi të drejtat, krijimi i një baze të dhënash të shërbimeve që ofrohen në Bashkinë Lezhë, vendosja e një bashkëpunimi të përhershëm me organizatat lokale por edhe ato rajonale me anë të njoftimeve elektronike dhe grupeve të përhershme të këshillimit. Në konsideratën tonë, këto mund të jenë disa nga hapat e parë, të cilët do të ndikojnë në mënyrë të ngadaltë por në një rritje konstante, të informimit dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në procese vendimarrëse apo në aktivitetet e programe që ofrohen nga Bashkia.

Duke identifikuar mungesën e informacionit, një propozim tjetër është edhe përvetësimi i ligjeve të reja të sapomiratuara, siç janë: Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë, Ligji për Informimin, Ligji për Konsultimin Publik. Këto ligje kanë detyrime të qarta për pushtetin lokal, siç platforma informative, detyrimet për të botuar projek- akte të ndryshme apo politika.

Vendosja e informacionit në disa formate të aksesueshme, është një tjetër masë që mund të ndërmerret në realizimin të kësaj ndërhyrjeje. Përdorimi i gjuhës së thjeshtë dhe të qartë gjatë komunikimit me persona me aftësi të kufizuara por edhe gjatë hartimit të vendimeve të ndryshme në nivel lokal.

## **Ndërhyrja II. Rrymëzimi i aftësisë së kufizuar në politikat, rregulloret dhe procedurat e Bashkisë**

Ndërhyrja e dytë mund të arrihet përmes disa formave apo teknikave të integritit të personave me aftësi të kufizuara apo çështjeve të aftësisë së kufizuar.

Krijimi i një grupi konsultativ, me disa përfaqësues të përzgjedhur, që përfaqësojnë të gjithë llojet e aftësive të kufizuara, moshat dhe gjininë është një opsion, i cili mund t'i shërbejë përfshirjes dhe vendosjes së një marrëdhënieje sistematike.

Një tjetër praktikë pozitive, është marrja e mendimit të specialistëve që merren direkt me çështje të aftësisë së kufizuar në bashki sa herë që hartohen vendime apo politika, me qëllim identifikimin e ndikimit që mund të kenë këto vendime për komunitetin e personave me aftësi të kufizuara. Kjo masë, duhet të shtrijë detyrimin edhe për organizata të personave me aftësi të kufizuara.

## **Ndërhyrja III. Ngritja dhe rritja e kapacitetit të stafit të Bashkisë mbi aftësinë e kufizuar**

Ndërhyrja e tretë, ka të bëjë me rritjen e kapacitetit të stafit të bashkisë për mënyra të komunikimit me personat me aftësi të kufizuara, mbi detyrimet ligjore dhe mjetet që duhen përdorur për të realizuar përfshirjen e plotë dhe efikase të personave me aftësi të kufizura dhe informimin. Për të realizuar ndërhyrje e mësipërme kërkohen aftësi të veçanta nga personat që janë përgjigjës për çështje të informimit por edhe të gjithë stafit. Duke qënë se në Lezhë nuk ka pasur trajnime apo projekte në lidhje me aftësimin e stafit të Bashkisë për të tilla tematika, vendosja e kësaj ndërhyrjeje përforcohet edhe më shumë.

Kjo mund të kërkojë bashkëpunimin me ekspertë të fushës së komunikimit, etikës, të drejtave të njeriut dhe aftësisë së kufizuar. Trajnimet, seminarët dhe aktivitetet të ndryshme me qëllim rritjen e kapaciteteve janë gjithashtu disa nga mënyrat në kuadër të rritjes së aksesit në informacion.

Për të siguruar mbarëvajtjen e aktiviteteve, do të ishte i nevojshëm një planifikim dhe vlerësim i nevojave të stafit të bashkisë. Për këtë nevojitet një bashkëpunim i mirë ndërrajonale me organizata e me institucioneve qendrore ose rajonale me qëllim përforcimin e bashkëpunimit, për shkëmbim informacioni dhe pjesëmarrje, sa herë paraqitet një mundësi.

#### **Ndërhyrja IV. Fuqizimi i komunitetit të personave me aftësi të kufizuara dhe i organizatave përfaqësuese mbi pjesëmarrjen, rritjen e bashkëpunimit dhe informimit.**

Ndërhyrja e katërt ka të bëjë me fuqizimin e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara. Besojmë që paralelisht me rritjen e kapacitetit të stafit lokal, duhet të shkojë edhe rritja e kapaciteteve të vetë komunitetit dhe bashkinë e shohim si një institucion i cili duhet të ofrojë mundësi trajnimi dhe ndërgjegjësimi. Kjo ndërhyrje mund të arrihet përmes edukimit të personave me aftësi të kufizuara, përmes programeve të informimit që mund të ofrojë bashkia, ose përmes shpërndarjes në mënyrë të vazhdueshme të materialeve informuese. Një masë tjetër e cila mund të ndërmerret nga bashkia është edhe vendosja e informacionit mbi të drejtat në ambiente të arritshme për personat me aftësi të kufizuara. Vendosja e një sistemi të përhershëm komunikimi me shoqatat e personave me aftësi të kufizuara është një mënyrë tjetër.

**Drejtimit strategjike dhe plani i veprimit të fushës së  
përshtatshmërisë në qytetin e Lezhës  
Matrica e projekteve konkrete**

OBJEKTIVI	NDËRHYRJET	PROJEKTE/ HAPA KONKRETE	BURIMET E FINANCIMIT	AFATE KOHORE	PERGJEGJESITE
<b>Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Gjithpërfshirja e tyre në Politikat dhe Programet e Qeverisjes Vendore</b>	I. Ndalimi i menjëhershëm i krijimit të barrierave të reja dhe planifikimi për heqjen e barrierave egzistuese në mjedisin e ndërtuar, transport e komunikim, duke rishikuar instrumentet vendore dhe siguruar përfaqje me planin e përgjithshëm të zhvillimit lokal	I.1 Rishikimi dhe plotësimi i Rregullores Vendore të Planifikimit e të Zhvillimit, me kërkesat dhe standartet e përshtatshmërisë ndërtimore dhe reduktimit të kohës dhe dokumentacionit të nevojshëm për sigurimin e lejes në objektet ekzistuese	Bashkia, MZHUT	2015	Bashkia, MZHUT
		I.1,a ) Të saktësohen në nene të veçanta të Rregullores Vendore të Planifikimit të Territorit (RrVPT) dhe të Rregullores Vendore të Zhvillimit të Territorit (RrVZhT), kërkesat për detyrimin e vendosjes së elementëve të përshtatshmërisë për çdo leje të re ndërtimi, si edhe për vendosjen e tyre në objektet ekzistuese.	Bashkia, MZHUT	2015	Bashkia, MZHUT
		I.1, b) Të plotësohet në RrVPT & RrVZhT lista e dokumentave <i>përfshi</i>	Bashkia, MZHUT	2015	Bashkia, MZHUT Këshilli Bashkiak



		<p><i>kërkesën për projekt të veçantë përshtatshmërie, në formularët e aplikimit për çdo projekt të ri (infrastrukturë rrugore ose objekt) që paraqitet për leje ndërtimi.</i></p> <p>I. 1, c) Të detajohet në RrVPT &amp; RrVZhT <i>dokumentacioni i reduktuar</i> në formularët për leje për vendosjen e elementëve të përshtatshmërisë në objektet dhe infrastrukturën rrugore ekzistuese.</p>	Bashkia, MZHUT, Këshilli Bashkiak	2015	Bashkia, MZHUT, Këshilli Bashkiak
		I.2. Miratimi në K. Bashkiak i Rregulloreve Vendore	Bashki, K.Bashkia	2015	Bashki, K.Bashkia
		<p>I.3. Të plotësohet informacioni (me të dhëna të detajuara dhe foto) për të gjitha objektet e ndërtuara pa leje, për të lehtësuar vendimmarrësit mbi qëndrimin ndaj tyre.</p> <p>1.4.Vendim i veçantë i Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak mbi aplikimin e</p>	<p>Bashkia, Këshilli Bashkiak</p> <p>Bashkia, Këshilli Bashkiak</p>	<p>2015</p> <p>2015</p>	<p>Bashkia, Këshilli Bashkiak</p> <p>Bashkia, Këshilli Bashkiak</p>

		standarteve të përshtatshmërisë në të gjitha rikonstruksionet e aseteve të bashkisë			
		I.5. Rishikim i projekteve të rikonstruksionit për asetet e bashkisë në vitin 2015, në drejtim të aplikimit të standarteve të përshtatshmërisë	Bashkia	2015	Bashkia
		I.6. Hartimi i një plani bashkiak për heqjen graduale të barrierav ekzistuese në mjedisin e ndërtuar	Bashkia	2015	Bashkia
		I.7. Miratimi nga Këshilli Bashkiak i planit për heqjen e barrierave ekzistuese në mjedisin e ndërtuar dhe detajimi i tij për çdo vit pasues	Bashkia	Mars 2015	Bashkia, Këshilli Bashkiak
		I.8. Monitorimi i planit bashkiak për heqjen e barrierave në objek ekzistuese dhe raportimi periodik pranë K. Bashkiak	Bashkia, Këshilli Bashkiak	Në vijim	Bashkia, Këshilli Bashkiak
	II. Rritja e	II.1 Trajnim nga ekspertët e			

	<p>kapaciteteve të strukturave përgjegjës për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit për të respektuar kërkesat dhe standartet në parandalimin e barrierave në projektet e reja dhe në heqjen graduale të barrierave egzistuese</p>	<p>fushës: a) për stafin e zyrës së urbanistikës në bashki, kontrollin e projekteve, këshillin teknik, komisionin e planifikimit të territorit pranë Këshillit Bashkiak, inspektoriatin ndërtimor e urbanistik vendor, etj, për të parandaluar shfaqjen e barrierave në objektet e reja dhe heqjen e barrierave egzistuese</p> <p>b) për stafin e departamentit të transportit në bashki për të mos lejuar blerjen dhe qarkullimin e mjeteve të transportit të papërshtatura, kur të vendosen në këtë bashki pas zgjerimit</p>	<p>MMSR &amp; Donatorë &amp; Organizata të specializuara</p> <p>MMSR &amp; Donatorë &amp; Organizata të Specializuara</p>	<p>2015 - 2017</p> <p>2015 - 2017</p>	<p>MMSR &amp; Donatorë &amp; Organizata të specializuara</p> <p>MMSR &amp; Donatorë &amp; Organizata të Specializuara</p>
		<p>II. 2. Ndërgjegjësim dhe njohje e subjekteve projektuese dhe zbatuese mbi detyrimet ligjore për zbatimin e kërkesave dhe standarteve të përshtatshmërisë në objektet e reja dhe ato në proces</p>	<p>MMSR &amp; Donatorë &amp; Organizata të specializuara</p>	<p>2015 - 2017</p>	<p>MMSR &amp; Donatorë &amp; Organizata të specializ</p>

		ndërtimi ose rikonstruksioni.			
		II.3. Ndërgjegjësim dhe njohje e pronarë/administratorëve të bizneseve private mbi detyrimet ligjore për zbatimin e kërkesave dhe standarteve të përshtatshmërisë në objektet e reja dhe ekzistuese	MMSR& Donatorë & organizata të specializuara	2015 – 2019	MMSR& Donatorë & organizata të specializ
		II.4. Rritje të nivelit të ndërgjegjësimit në komunitet për një mjedis të përshtatur.	MMSR& Donatorë & organizata të specializuara	2015 - 2019	MMSR& Donatorë & organizata të specializ
	III.Zbatimi i përgjegjësive e forcimi i rolit të pushtetit vendor në realizimin e mjedisit dhe transportit të përshtatur përmes politikave gjithpërfshirëse dhe përmirësimit të legjislacionit	III. 1, a) Të forcohet detyrimi dhe kontrolli për zbatimin e RrVPT dhe RrVZhT në kërkesat për detyrimin e vendosjes së elementëve të përshtatshmërisë për çdo leje të re ndërtimi, si edhe për vendosjen e tyre në objektet ekzistuese.  III.1, b) Të forcohet kërkesa e detyrimit për përshtatshmëri në mjetet e transportit publik, në	Bashkia, Këshilli Bashkiak  MTI & Bashkia	2015  2015 në vazhdim	Bashkia, Këshilli Bashkiak  MTI & Bashkia

	<p>sigurimin e licensës për linja urbane &amp; interurbane. Propozim për ndërhyrje në legjislacion</p> <p>III.1, c) Të shtohet kërkesa e detyrimit për përshtatshmëri për subjektet që hartojnë dhe zbatojnë projektet e sinjalistikës vertikale dhe horizontale si edhe të caktimit të vend-parkimeve në qytet. Propozim për Vendim në Këshill Bashkiak</p>	MTI & Bashkia	2015 në vazhdim	MTI & Bashkia
	<p>III.2. Të krijohet një strukturë e veçantë për kontrollin e zbatimit të kërkesave dhe standarteve të përshtatshmërisë ndërtimore, ose të emërohet një person me këtë detyrë, brenda strukturës ekzistuese të kontrollit të dokumentacionit dhe zbatimit të lejeve të ndërtimit.</p>	MMSR, MZHUT	2015	MMSR, MZHUT
	<p>III.3. Të përgatiten dhe të miratohen në Këshill Bashkiak vendimet e</p>	Bashkia, Këshilli Bashkiak	2015 -2016	Bashkia, Këshilli Bashkiak

		nevojshme			
		III. 4. Këshilli Bashkiak të detyrojë e parashikojë aplikimin e një % të buxhetit të bashkisë për zbatimin e elementëve të përshtatshmërisë në të gjitha projektet e rikonstruksioneve	Këshilli Bashkiak	2015 e vazhdim	Këshilli Bashkiak
	IV. Në bashkëpunim me sektorët e tjerë përgjegjës në bashki, të krijohet baza e të dhënave për realizimin e ndërhyrjeve në objektet egzistuese me qëllim përshtatjen e tyre për Personat me Aftësi të Kufizuara	IV.1. Të vlerësohet dhe evidentohet niveli i përshtatshmërisë në objektet egzistuese, duke filluar nga objektet publike/asete të bashkisë (objekte, rrugë, sinjalistikë, vend-parkime, mjete të transportit publik), obj. arsimore & shëndetësore &si edhe objektet private	Bashkia, DRA, DRSHP ose ekspertë të fushës	2015 -2016	Bashkia, DRA, DRSHP ose ekspertë të fushës
		IV.2. Të përgatitet lista e objekteve (fillimisht publike), duke i renditur ato sipas prioriteteve/frekuentimit dhe nevojave për rikonstruksione.	Bashkia, DRA, DRSHP	2015	Bashkia, DRA, DRSHP
		IV. 3. Të hartohet plani dhe	Bashkia, MAS, DRA,	2015 e vazhdim	Bashkia, MAS, DRA,

	<p>projektet konkrete (projekt ide) për ndërhyrje për përshtatjen e objekteve, duke filluar nga objektet publike me frekuentim më të lartë.</p> <p>a) Përshtatja e spitalit, qendrave shendetësore dhe qendrave sociale</p> <p>b) Përshtatja e kopshteve dhe shkollave</p> <p>c) Përshtatja e zyrave të institucioneve vendore</p> <p>d) Përshtatja e qendrave kulturore/sportive</p> <p>e) Përshtatja e infrastrukturës dhe sinjalistikës rrugore urbane</p> <p>f) Përshtatja e mjeteve të transportit urban/interurban</p>	<p>MSH, DRSHP/ekspertë të fushës &amp; studio projektimi</p> <p>MSH, Bashkia</p> <p>MAS,DRA&amp;Bashki</p> <p>Bashkia &amp; K. Bashkiak</p> <p>MAS,DRA&amp;Bashki</p> <p>Bashkia&amp; Këshilli Bashkiak</p> <p>MTI &amp; Bashki</p>	<p>2015 e vazhdim</p> <p>2015 e vazhdim</p> <p>2015 e vazhdim</p> <p>2015 e vazhdim</p> <p>2015 e në vazhdim</p> <p>2015 e vazhdim</p>	<p>MSH, DRSHP/ekspertë të fushës &amp; studio projektimi</p> <p>MSH, Bashkia</p> <p>MAS,DRA&amp;Bashki</p> <p>Bashkia &amp; K. Bashkiak</p> <p>MAS,DRA&amp;Bashki</p> <p>Bashkia&amp; Këshilli Bashkiak</p> <p>Bashkia</p>
	<p>IV. 4. Të përfshihen në buxhetin e bashkisë fondet për përshtatjen e objekteve sipas prioriteteve, bazuar në vlerësimin e situatës, projektet e përgatitura dhe në konsultim me sektorët e tjerë në bashki.</p>	<p>Bashkia &amp; Këshilli Bashkiak</p>	<p>2015 e vazhdim</p>	<p>Bashkia &amp; Këshilli Bashkiak</p>

	<p>V. Të forcohet kontrolli mbi aplikimin dhe zbatimin e detyrueshëm të kërkesave dhe standarteve të përshtatshmërisë në projektet që paraqiten për leje ndërtimi. Të rishikohen në drejtim të forcimit ndaj kërkesave të përshtatshmërisë, përgjegjësitë e strukturës ekzistuese të kontrollit në nivel vendor ose të një strukture të re/person të ngarkuar me këtë përgjegjësi</p>	<p>V.1. Të caktohet person përgjegjës pranë strukturës së kontrollit të projekteve (sekretaria teknike) për të kontrolluar dhe mbajtur përgjegjësi mbi aplikimin e kërkesave dhe standarteve të përshtatshmërisë në objektet që paraqiten për leje ndërtimi. Propozim për Vendim të Këshillit Bashkiak</p>	<p>Bashkia &amp; Këshilli Bashkiak</p>	<p>2015</p>	<p>Bashkia &amp; Këshilli Bashkiak</p>
		<p>V.2 Të ngrihet strukturë ose caktohet person përgjegjës (arkitekt ose ingjnier) pranë Zyrës Rajonale të SHSSH për të kontrolluar e konfirmuar aplikimin e kërkesave dhe standarteve të përshtatshmërisë në objektet që paraqiten për leje ndërtimi</p>	<p>MMSR</p>	<p>2015</p>	<p>MMSR</p>



		Propozim ligjor nga MMSR.			
	VI. Të parashikohen burime financiare për heqjen graduale të barrierave në objektet egzistuese	VI.1. Të planifikohet një % e buxhetit vjetor të bashkisë nga fondi për rikonstrksion dhe mirëmbajtje për përshtatjen e objekteve shëndetësore, arsimore, social –kulturore dhe infrastrukturë rrugore.	Bashkia & Këshilli Bashkiak dhe institucionet përgjegjëse	2015 e vazhdim	Bashkia & Këshilli Bashkiak dhe institucionet përgjegjëse
		VI.2. Të parashikohet buxhet për realizimin e përshtatshmërisë fizike të objekteve të poshtëshënuara:	Bashkia & Këshilli Bashkiak	2015 e në vazhdim	Bashkia & Këshilli Bashkiak
		VI.2.1.Aplikimi i standarteve të përshtatshmërisë në projektin e rehabilitimit të sheshit qendror të qytetit. Në këtë kuadër, aplikimi i standarteve të përshtatshmërisë në hyrje të bashkisë me qëllim sigurimin e shërbimeve nga PAK, në sportelet e informacionit.	Bashkia	2015	Bashkia
		VI.2.2.Aplikimi i standarteve të përshtatshmërisë në godinën e bashkisë për	Bashkia & Këshilli Bashkiak	2015-2017	Bashkia & Këshilli Bashkiak

	<p>arritjen e nivelit bazë të përshtatshmërisë dhe aksesit nga PAK.</p> <p>VI.2.3.Aplikimi i standarteve të përshtatshmërisë në projektin e rikonstruksionit të Pallatit të Kulturës dhe hyrjes në këtë institucion.</p> <p>VI. 2.4. Aplikimi i standarteve të përshtatshmërisë në projektin e rikonstruksionit të pjesës së ekspozimit të relikeve (në katin përdhe të godinës së bibliotekës)</p> <p>VI.2.5.Aplikimi i standarteve të përshtatshmërisë në shkollat që janë parashikuar për rikonstruksion gjatë vitit 2015 (DRA të kërkojë buxhet shtesë për vitin 2015)</p> <p>VII 2.6.Aplikimi i standarteve të përshtatshmërisë në një shkollë model</p>	<p>Bashkia&amp; K. Bashkiak e Ministria e Kulturës</p> <p>Ministria e Kulturës, Bashkia</p> <p>DRA,MAS &amp; Bashkia</p> <p>DRA, MAS &amp; Bashkia</p> <p>DRSHP, MSH &amp; Bashkia</p>	<p>2015-2017</p> <p>2015 - 2017</p> <p>2015</p> <p>2015-2019</p> <p>2015</p>	<p>Bashkia &amp; Këshilli Bashkiak</p> <p>Bashkia &amp; Këshilli Bashkiak</p> <p>DRA, MAS &amp; Bashkia</p> <p>DRA, MAS &amp; Bashkia</p> <p>DRSHP, MSH &amp; Bashkia</p>
--	---	--	--	---

		<p>VII.2.7.Aplikimi i standarteve të përshtatshmërisë në poliklinikën dhe në qendrat shëndetësore në qytet dhe komuna. DRSHP të kërkojë buxhet shtesë për vitin 2015.</p> <p>VII.2.8.Përshtat.e trotuareve në kryqëzimet e rrugëve dhe rrugët e brendshme në blloqet e banimit.</p>	Bashkia & Këshilli Bashkiak	2015 e në vazhdim	Bashkia & Këshilli Bashkiak
	VII. Të rritet atraksioni turistik i qytetit te lezhës duke garantuar përshtatshmërinë e mjedisit për të gjithë.	<p>VII.1. Të vlerësohet sa më parë niveli i përshtatshmërisë në objektet muzeale, arkeologjike e të kulturës në pronësi dhe/ose në administrim të bashkisë.</p> <p>VII.2. Të bashkëpunojnë me institucionet përgjegjëse të kulturës, arkeologjisë dhe turizmit, për të propozuar projekte konkrete e siguruar financime për garantimin e përshtatshmërisë së objekteve turistike</p> <p>VII.3. Të merren masa detyruese për operatorët</p>	<p>Bashkia &amp; Këshilli Bashkiak</p> <p>Bashkia &amp; Këshilli Bashkiak &amp; institucionet përgjegjëse të kulturës, arkeologjisë dhe turizmit,</p> <p>Bashkia &amp; Këshilli Bashkiak&amp; institucionet</p>	<p>2015-2016</p> <p>2015- 2019</p> <p>2015-2019</p>	<p>Bashkia &amp; Këshilli Bashkiak</p> <p>Bashkia &amp; Këshilli Bashkiak &amp; institucionet përgjegjëse të kulturës, arkeologjisë dhe turizmit,</p> <p>Bashkia &amp; Këshilli</p>

	privatë në sektorin e turizmit, që të zbatojnë kërkesat dhe standartet e përshtatshmërisë në objekte në shërbim të turizmit	përgjegjëse të kulturës, arkeologjisë dhe turizmit,		Bashkiak& institucionet përgjegjëse të kulturës, arkeologjisë dhe turizmit,
--	---	---	--	---

# **Drejtimit strategjike dhe plani i veprimit të fushës së Shërbimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Bashkinë Lezhë**

## **Matrica e projekteve konkrete**

	NDËRHYRJE	TREGUES	BURIMET FINANCIMIT	E	AFATE KOHORE	PERGJEGJESITE
<b>Përfshirja sociale e personave me aftësi të kufizuara</b>	I.Fuqizimi dhe zgjerimi i burimeve njerëzore	1.Caktimi i një personi përgjegjës për çështje të aftësisë së kufizuar brenda DSHS 2.Trajnime për stafin e bashkisë 3.Përmirësimi i komunikimit të stafit me institucione të tjera	Bashkia MMSR Donatorë		2015-2016	Bashkia
	II. Përmirësimi i mbledhjes dhe dhe përdorimit të të dhënave	1.Krijimi i një baze elektronike me të dhëna të shumëllojshme; 2.Kryerja e vëzhgimeve të shkurtra përmes intervistimeve me metoda sasiore e cilësor për identifikimin e nevojave; 3.Realizimi i raporteve të vlerësimit të nevojave; 4.Monitorim i vazhdueshëm i situatës.	Bashkia MMSR Donatorë		2015-2016	Bashkia
	III.Ngritja dhe funksionimi i shërbimeve mbështetëse	1.Vlerësim i nevojave; 2.Dizenjim i shërbimeve të mundshme; 3. Identifikim i burimeve financiare; 4.Identifikim i specialistëve.	Bashkia Donatorë MMSR		2015-2017	Bashkia, Donatorë, MMSR, SHSSH

	IV. Fuqizimi i ushtrimit të kompetencave në fushën e shërbimeve shëndetësore	1.Rritje e bashkëpunimit me institucionet rajonale shëndetësore për të siguruar në kohë identifikimin dhe ndërhyrjen e hershme; 2.Bashkëpunim me sektorin e Shëndetit Mendor Në Drejtorinë Rajonale Shëndetësore për të ideuar, projektuar e ngritur fonde për të realizuar ngritjen e një Qendre Komunitare për Shëndetin Mendor; 3.Ristrukturimi dhe rehabilitimi i qendrës së rehabilitimit fizik.	Bashkia Drejtoria Rajonale e Institutit të Shëndetit Publik	2016	Bashkia
	V. Planifikim dhe shpërndarje e burimeve financiare për shërbime për personat me aftësi të kufizuara	1. Zëra në buxhetin e bashkisë për çështje të aftësisë së kufizuara; 2. Identifikim dhe krijim i marrëdhënieve të vazhdueshme me donatorë potencialë dhe biznese; 3.Kërkesë për buxhet shtesë pranë MMSR.	Bashkia MMSR Donatorë	2015- 2019	Bashkia

# **Drejtimit strategjike dhe plani i veprimit të fushës së Arsimit**

## **Matrica e projekteve konkrete**



<b>QOBJEKTIV</b>	<b>NDËRHYRJE</b>	<b>TREGUES</b>	<b>BURIMET E FINANCI MIT</b>	<b>AFATE KOHO RE</b>	<b>PERGJEGJ ESITE</b>
<b>Përfshirja sociale e personave me aftësi të kufizuara</b>	I. Rritje e numrit të specialistëve në DAR, përgjegjës për zbatimin e politikave të MAS për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme në qytetin e Lezhës.	I.1. Rivlerësimi i strukturës së sektorit të Kualifikimit dhe Cilësisë, në DAR Lezhë duke shtuar një specialist vetëm për nxënësit me aftësi të kufizuara	Buxheti i shtetit	2016	MAS
		I.2. Hartimi i procedurave për mbarvajtjen dhe vlerësimin periodik të punës së Komisionit të Vlerësimit të DAR Lezhë	Buxheti i shtetit	2015 e në vijim	DAR Lezhë
		I.3. Rritja e numrit të psikologëve të shërbimit psiko-social në shkolla	Buxheti i shtetit	2015	MAS

	II.Mbledhja, përditësimi, raportimi i të dhënave për situatën e nxënësve me aftësi të kufizuara të cilët frekuentojnë shkollat e zakonshme me qëllim parashikimin e ndërhyrjeve të nevojshme.	II.1. Krijimi i një data-base elektronik me tregues të përgjithshëm dhe specifik për fëmijët me aftësi të kufizuara që frekuentojnë shkollën e zakonshme/kopshtin.	Buxheti i shtetit	2015	DAR/MAS
		II.2. Instalimi i data-bases në çdo shkollë të zakonshme dhe kopësht të qytetit të Lezhës.	Buxheti i shtetit	2015-2016	DAR Lezhë
		II.3. Instalimi i një baze të dhënash në DAR Lezhë, për pasqyrimin e të dhënave përmbledhëse e progresive, për situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët frekuentojnë shkollat e zakonshme dhe kopshtet në qytetin e Lezhës.	Buxheti i shtetit	2015-2016	DAR Lezhë
		II.4. Krijimi i një baze të dhënash elektronik në DAR Lezhë, me tregues që pasqyrojnë rezultatet e vlerësimeve të kryera nga Komisioni i Vlerësimit në DAR Lezhë	Buxheti i shtetit/Dona torë	2015-2016	MAS/OJF

		Përgatitja nga DAR e raporteve përmbledhëse për situatën e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla të zakonshme dhe kopshte.			
	III.Sigurimi i infrastrukturës mbështetëse në shkollat e zakonshme, me qëllim rritjen cilësisë së mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuara.	III.1. Drejtoritë e shkollave dhe kopshteve përgatisin një evidencë të detajuar për nevojat për mjete didaktike për nxënësit me aftësi të kufizuara.	Buxheti i shtetit/Dona torë	2015 e në vijim	Drejtoritë e shkollave dhe kopshteve/O JF
		III.2. DAR përgatit evidencën përmbledhëse për nevojat për mjete didaktike për nxënësit me aftësi të kufizuara.	Buxheti i shtetit	2015 e në vijim	DAR Lezhë
		III.3.Sigurimi i mjeteve didaktike për të lehtësuar mësimdhënien e nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme	Buxheti i shtetit/Dona torë	2016 e në vijim	MAS/DAR/OJF
		III.4.DAR vlerëson nevojat për mësues ndihmës në shkolla të	Buxheti i shtetit	2015 e në vijim	DAR

		zakonshme.			
		III.5. Përfshirja e mësuesit ndihmës në strukturën organizative të shkollave të zakonshme ku mësojnë fëmijë me aftësi të kufizuara.	Buxheti i shtetit	2015	MAS
		III.6. Krijimi i ambienteve burimore në çdo shkollë të zakonshme për të mësuar nxënësit me aftësi të kufizuara jashtë orës së mësimi.	Buxheti i Bashkisë	2016 e në vijim	Bashkia Lezhë
		III.7. Vlerësimi i nevojave për transport të përshtatur për nxënësit me aftësi të kufizuara, përdorues të karrigeve me rrota, të cilët frekuentojnë shkollat e zakonshme dhe kopshtet.	Buxheti i shtetit	2015 e në vijim	Drejtoritë e shkollave të zakonshme/ DAR Lezhë
		III.8. Sigurimi i transportit të përshtatur për nxënësit me aftësi të kufizuara, përdorues të karrigeve me rrota.	Buxheti i Bashkisë Lezhë	2016 e në vijim	Bashkia Lezhë
		III.9. Realizimi i cikleve të trajnimit për specialistët e sektorit të Kualifikimit dhe Cilësisë, pranë DAR të fokusuar në çështje të gjithëpërfshirjes, kuadrit ligjor në zbatim të politikave për garantimin	Buxheti i shtetit/Dona torë	2015 e në vijim	MAS/OJF

		e të drejtës për arsim fëmijët me aftësi të kufizuara.			
		III.10.Trajnimi i specialistit që do të angazhohet në kohë të plotë në DAR, përgjegjës për çështje të gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla të zakonshme dhe kopshte.	Buxheti i shtetit/Donatorë	2016	MAS/ OJF
		III.11.Realizimi i cikleve të trajnimit, për drejtues, mësues, edukatorë të shkollave dhe kopshteve publike të qytetit, të fokusuar në praktikën bashkëkohore të mësimdhënies në përputhje me nevojat specifike të fëmijëve me aftësi të kufizuara.	Buxheti i shtetit/Donatorë	2016 e në vijim	MAS/ OJF
		III.12.Trajnimi i mësuesve ndihmës.	Buxheti i shtetit/Donatorë	2015 e në vijim	MAS/ZA/OJF
		III.13.Trajnimi i psikologëve të shkollave, pjesë e shërbimit psikosocial në shkolla.	Buxheti i shtetit/Donatorë	2015-2016	MAS/ OJF
	IV.Zgjerimi dhe konsolidimi i një partneriteti aktiv mes institucioneve shtetërore, organizatave jofitimprurëse dhe	IV.1 Bashkëpunim me OJF të vendit dhe të huaja për marrjen e ekspertizës së tyre, modeleve, për zbatimin në praktikë të arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me	Donatorë  Buxheti i	2016 e në vijim	ZA/OJF  DAR/ashkia

	<p>grupeve të tjera të interesit që punojnë apo ndikojnë në realizimin e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.</p>	<p>aftësi të kufizuara.</p> <p>IV.2. Realizimi i tryezave të rrumbullakëta për konsultim dhe shkëmbim informacioni ndërmjet DAR, Bashkisë Lezhe, OJF të aftësisë së kufizuar dhe komunitetit të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara.</p> <p>IV.3. Përgatitja dhe publikimi i raporteve vjetore nga strukturat përgjegjëse në nivel lokal për situatën e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhë.</p>	<p>shtetit/Donatorë</p> <p>Buxheti i shtetit/Donatorë</p>	<p>2015 e në vijim</p> <p>2016 e në vijim</p>	<p>Lezhë/Donatorë</p> <p>DAR</p>
	<p>V.Ndërgjegjësim i komuniteteve para së gjithash atij të prindërve, familjarëve dhe vetë fëmijëve e të rinjëve me aftësi të kufizuara dhe komunitetit në tërësi në mbështetje të arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara.</p>	<p>V.1.Fushata informimi me komunitetin e prindërve, nxënësve me dhe pa aftësi të kufizuara dhe komunitetin për krijimin e një klime gjithëpërfshirëse</p>	<p>Donatorë/Buxheti i Bashkisë Lezhë</p>	<p>2015 e në vijim</p>	<p>DAR/Bashkia Lezhë/OJF të aftësisë së Kufizuar</p>
	<p>VI.Monitorimi dhe Vlerësimi i zbatimit të</p>	<p>VI.1. Përgatitja e matricës së monitorimit dhe vlerësimit të</p>	<p>Buxheti i shtetit</p>	<p>2015</p>	<p>DAR Lezhë</p>

	planit lokal për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme dhe kopshte.	ecurisë së gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme dhe kopshte, bazuar në matricën e planit lokal.			
		VI.2. Përgatitja e raporteve vjetore të monitorimit dhe vlerësimit të procesit të zbatimit të planit lokal për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme dhe kopshte.	Buxheti i shtetit/Dona torë	2016 e në vijim	DAR Lezhë

# **Drejtimit strategjike dhe plani i veprimit të fushës së Punësimit**

## **Matrica e projekteve konkrete**



<b>OBJEKTIV</b>	<b>NDËRHYRJE</b>	<b>TREGUES</b>	<b>BURIMET E FINANCIMIT</b>	<b>AFATE KOHORE</b>	<b>PERGJEGJESI TE</b>
<b>Përfshirja sociale e personave me aftësi të kufizuara</b>	Ndërhyrja I. Rivlerësim i strukturës dhe i shërbimit, planifikim i burimeve njerëzore dhe krijimi i kapaciteteve të tyre, në funksion të rritjes së standartit dhe ofrimit të një shërbimi të specializuar të punësimit për punëkërkuarit e papunë me aftësi të kufizuara.	I.1. Rivlerësimi i strukturës së DRSHKP Lezhë, duke shtuar numrin e specialistëve me një specialist, puna e të cilit të fokusohet në kohë të plotë në ndjekjen e ecures së zbatimit të politikave dhe kuadrit ligjor për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara punëkërkuarit të papunë, në qytetin e Lezhës.	Buxheti i shtetit	2016	MMSR/SHKP
		I.2. Zhvillimi i procedurave për realizimin e procesit të vlerësimit të aftësive për punë të punëkërkuarit të papunë me aftësi të kufizuara, bazuar në kriteret dhe dokumentacionin përkatës të miratuar nga MMSR dhe SHKP për këtë	Buxheti i shtetit/ Donatorë	2015	MMSR/ShKP/OJ F

		qëllim.			
		I.3. Krijimi i infrastrukturës së nevojshme dhe kapaciteteve të stafit në DRSHKP për të realizuar procesin e vlerësimit, këshillimit dhe orientimi të personave me aftësi të kufizuara, punëkërkues të papunë.	Buxheti i shtetit	2015-2016	ShKP/DRSHKP Lezhë
	II.Përmirësimi i sistemit të mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave për situatën e punësimit të personave me aftësi të kufizuara.	II.1. Përcaktimi në data – base i treguesve specifik për rregjistrimin e punëkërkuesve të papunë me aftësi të kufizuara.	Buxheti i shtetit	2015	ShKP
		II.2. Përcaktimi në data-base i treguesve specifik për të punësuarit me aftësi të kufizuara në subjekte publike dhe private.	Buxheti i shtetit	2015	ShKP
		II.3. Përgatitja nga DRSHKP e raporteve përmbledhëse, periodike dhe progresive, për situatën e punësimit dhe formimit profesional të personave me aftësi të kufizuara në qytetin	Buxheti i shtetit/Donatorë	2015 dhe në vijim	DRSHKP Lezhë

		e Lezhës			
	III. Nxitja e formimit profesional, formimit nëpërmjet punës dhe punësimit të punëkërkuarve të papunë me aftësi të kufizuara	III.1. Realizimi takimeve/sesioneve për informimin e specialistëve të DRSHK, IShP për ndryshimet ligjore në zbatim të ligjit “ Për nxitjen e Punësimit”.	Buxheti i shtetit/ Donatorë	2015	ShKP
		III.2. Trajnimi i specialistit që do të angazhohet në kohë të plotë në DRSHKP Lezhë për çështje të lidhura me punësimin dhe formimin profesional të personave me aftësi të kufizuara.	Buxheti i shtetit/ Donatorë	2016	ShKP/OJF
		III.3. Realizimi i një cikli trajnimesh për drejtues të subjekteve punëdhënëse publike dhe private si dhe për drejtues të departamenteve të burimeve njerëzore të këtyre subjekteve mbi koncepte që lidhen me punësimin e	Buxheti i shtetit/ Donatorë	2015 dhe në vijim	ShKP/OJF

		PAK, si akomodimi arsyeshëm, mosdiskriminimi etj..			
		III.4. Trajnimi i instruktorëve/ mësuesve të disa specialiteteve, të shkollës profesionale në qytetin e Lezhës.	Buxheti i shtetit	2016	ShKP/ DRSHKP Lezhë/shkolla e mesme profesionale
		III.5. Realizimi i disa seminareve ndërgjegjësuese si dhe ditëve të informacionit, për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre, për rëndësinë që ka për to punësimi dhe formimi profesional, drejt një jetese të pavarur.	Buxheti i shtetit/Donatorë	2015 dhe në vijim	ShKP/Bashkia Lezhe/OJF
		III.6. Shkëmbimi i përvojave të suksesshme, në media, ndërmjet subjekteve punëdhënëse dhe komunitetit të qytetit, për raste të punësimit të personave me aftësi të kufizuara.	Donatorë	2015 dhe në vijim	ShLP/Bashkia Lezhë/OJF
	IVSigurimi i	IV.1. Përgatitja nga	Buxheti i shtetit	2015 e në	DRSHKP Lezhë

	financimit në zbatim të politikave të nxitjes së punësimit dhe formimit profesional, në nivel lokal.	DRSHKP i evidencës për numrin e subjekteve që nevojitet të subvencionohen në raport me numrin e punëkërkuessve me AK që do të punësohen për tu mbështetur me programet e nxitjes së punësimit( jo vetëm me VKM 248).		vijim	
		IV.2. IShP ndjek ecurinë e shlyerjes së detyrimeve financiare nga subjektet punëdhënëse që nuk kanë përmbushur detyrimin për të punësuar persona me aftësi të kufizuara, bazuar në ligjin “Për Nxitjen e Punësimit”.	Buxheti i shtetit	2015 e në vijim	DRSHKP Lezhë
		IV.3. DRSHKP orienton donatorë të vendit dhe vendas për zhvillimin dhe zbatimin e programeve të nxitjes dhe promovimit të punësimit dhe trajnimit profesional të personave me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës.	Donatorë	2015 e në vijim	DRSHKP Lezhë
		IV.4 Krijimi i mekanizmave ligjorë që mundësojnë autonominë e DRSHKP në	Buxheti i shtetit	2016	MMSR/ShKP

		nivel lokal me qëllim manaxhimin e burimeve financiare në përputhje me nevojat e identifikuara.			
	IX.Monitorimi dhe Vlerësimi i zbatimit të planit lokal për punësimin dhe formimin profesional të personave me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës	IX.1. Përgatitja e matricës së vlerësimit të ecurisë së procesit të punësimit dhe formimit profesional të personave me aftësi të kufizuara, bazuar në matricën e planit lokal.	Buxheti i shtetit/Donatorë	2015	DRSHKP Lezhë
		IX.2. Përgatitja e raporteve vjetore të monitorimit dhe vlerësimit të procesit të zbatimit të planit të veprimit për punësimin dhe formimin profesional të personave me aftësi të kufizuara.	Buxheti i shtetit/Donatorë	2016 e në vijim	DRSHKP Lezhë

# **Drejtimit strategjike dhe plani i veprimit të fushës e Pjesmarrjes dhe Informimit**

Matrica e projekteve konkrete

<b>OBJEKTIV</b>	<b>NDËRHYRJET</b>	<b>TREGUES</b>	<b>BURIMET E FINANCI MIT</b>	<b>AFATE KOHORE</b>	<b>PERGJEGJESITE</b>
<b>Përfshirja sociale e personave me aftësi të kufizuara</b>	I. Krijimi i një mjedisi pa barierra në informim	<p>I.1. Përshtatshmëri infrastrukture e ndërtesës së bashkisë (shih Fusha e Përshtatshmërisë së Ambjentit të Ndërtuar).</p> <p>I.2. Prodhimi i materialeve informuese në formate të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara.</p> <p>I.3. Ndërgjegjësim i stafit të bashkisë dhe komunitetit të personave me aftësi të kufizuara mbi detyrimet e reja ligjore mbi informimin, përfshirjen dhe konsultimin.</p> <p>I.4. Strategji lokale për komunikimin.</p> <p>I.5. Rishikimi i rregullores së bashkisë së Lushnjës.</p>	Bashkia, Donatorë	2015-2016	Bashkia, OJF lokale, institucione rajonale
	II. Rrymëzimi i aftësisë së kufizuar në politikat, rregulloret e procedurat e bashkisë	<p>II.1. Përfshirje të çështjeve të aftësisë së kufizuar në politika, vendime.</p> <p>II.2. Krijim i një kalendari takimesh dhe mbledhjesh me anëtarë të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara.</p> <p>II.3. Konsultime me anëtarë të</p>	Bashkia, Donatorë	2016-2017	Bashkia, OJF lokale, institucione rajonale



		komunitetit të personave me aftësi të kufizuara para marrjes së vendimeve.			
	III Ngritja dhe rritja e kapacitetit të stafit të bashkisë mbi aftësinë e kufizuar: Informim dhe përfshirje.	III.1.Programe afatgjata trajnimi për stafin e bashkisë. III.2.Zhvillim i teknikave dhe mënyrave të komunikimit.	Bashkia, Donatorë	2016- 2019	Bashkia, OJF lokale, institucione rajonale
	IV Fuqizimi i komunitetit të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave përfaqësuese për të drejtat, pjesëmarrje, bashkëpunim dhe informim.	IV.1.Trajnime, seminare dhe aktivitete ndërgjegjësuëse. IV.2.Materiale informuese të përshtatura për kategori të ndryshme të aftësisë së kufizuar.	Bashkia, Donatorë, OJF	2016- 2019	Bashkia, OJF lokale, institucione rajonale

## **ANEKS 2. PËRMBLEDHJE E BAZËS LIGJORE**

Në këtë pjesë të dokumentit strategjik për bashkinë e Lushnjës, do të bëjmë një përmbledhje të ligjeve, politikave dhe vendimeve të ndryshme. Objektivat dhe ndërhyrjet e parashikuara në këtë plan janë bazuar pikërisht në këto dokumentë ligjore dhe politikë.

Duhet theksuar, që gjatë zhvillimit të ciklit të trajnimeve mbi Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, të cilët i paraprinë analizës së situatës në Bashkinë e Lushnjës dhe në institucionet e tjera në nivel lokal, konstatoam mungesë të informacionit mbi legjislacionin për personat me aftësi të kufizuara, sidomos mbi ligjet e vendimet e miratuara rishtazi. Duke pasur parasysh këtë numër të konsiderueshëm ligjesh e vendimesh të miratuar gjatë viteve të fundit, gjykojmë si të nevojshëm përfshirjen e këtij seksioni të veçantë, në mënyrë që ky dokument të shërbejë edhe si referencë për të gjithë drejtuesit, specialistët, punonjësit e institucioneve lokale në Lushnjë por t' i shërbejë edhe vetë komunitetit.

### **(a) Instrumentët ndërkombëtarë**

#### *Konventa për të Drejtat e Personave të Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK)*

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokollin Opsional i saj u miratuan më 13 Dhjetor 2006 dhe hyri në fuqi më 3 Maj 2008. KDPAK, si mesazh kryesor ka garantimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë personat me aftësi të kufizuara. Konventa përshkohet nga disa parime themelore, nga të cilët shumë i rëndësishëm mbetet parimi i mosdiskriminimit përgjatë promovimit të këtyre të drejtave. KDPAK e cila tashmë është ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar më 15 Nëntor 2012, dekretuar nga Presidenti i Republikës më 3 Dhjetor të vitit 2012, dhe pranuar në OKB në 22 shkurt 2013, përshkohet nga fryma e gjithëpërfshirjes në politika dhe në programe të çështjeve të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Ajo tashmë përfaqëson në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar instrumentin më të fuqishëm ligjor dhe specifik për personat me aftësi të kufizuara.

KDPAK shënjon një ndryshim thelbësor në fushën e aftësisë së kufizuara, duke krijuar kushtet për respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara përmes detyrimit të Shtetit Shqiptar për të krijuar strukturat dhe shërbimet e nevojshme për ta.

Pushteti lokal ka një rol thelbësor, ashtu siç edhe pushteti qendror në zbatimin e KDPAK. Kjo, duke pasur parasysh faktin që KDPAK përfshin disa fusha zbatimi, siç janë, transporti, strehimi, arsimit, infrastruktura, punësimi, shërbimet sociale, shërbimet shëndetësore, gjithëpërfshirja, pjesëmarrja e të tjera. Pushteti lokal ka detyrimet e kompetencat e veta apo të deleguara në këto fusha. Prandaj, është e rëndësishme, që të

gjithë detyrimet dhe masat, që kërkon vetë KDPAK e që ndërmerren nga qeverisja qëndrore, të jenë gjithashtu të përkthyer në mënyrë të përshtatshme, në detyrime e masa për pushtetin lokal.

### *Protokolli Opsional*

Protokolli Opsional është gjithashtu një instrument ligjor. Ai mundëson procedurat e ankimimit në rast të shkeljeve të të drejtave të parashikuara në KDPAK para Komitetit për Personat me Aftësi të Kufizuara. Ankimimet, në bazë të këtij protokoll mund të kryhen nga individë, grupe individësh apo palë të të treta për llogari të tyre. Ato mund të kryhen vetëm kundër shteteve të cilat e kanë ratifikuar Protokollin Opsional dhe me kushtin e ezaurimit të të gjithë mjeteve ligjore efektive në nivel kombëtar. Komiteti, pasi shqyrton ankesat, në rastet e konstatimit të shkeljeve, lëshon për shtetet vendime të cilat i detyrojnë ato që të rivendosin të drejtat e shkelura dhe njëkohësisht të ndjekin rekomandime përkatëse.

*'Plani për veprim për promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrjen efektive të tyre në shoqëri: rritje e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara në Europë 2006-2015' (Këshilli i Europës 2006)*

Ky plan parashikon objektiva dhe masa të hollësishme në çdo aspekt të fushës së aftësisë të kufizuar. Ky plan rekomandon për çdo shtet që të zbatojë këtë plan brenda kontekstit kombëtar e strukturave lokale. Ky plan bazohet dhe njeh të gjithë dokumentët ndërkombëtarë të fundit mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Objektivat e vendosur mbulojnë të gjithë fushat, duke filluar nga informimi e komunikimi, shëndetësia, mbrojtja sociale, transporti, dhuna dhe shfrytëzimi, punësimi, arsimimi etj.

### *Strategjia mbi Aftësinë e Kufizuar e Bashkimit Europian*

Strategjia konsiderohet të jetë një angazhim i rinovuar për një Europë pa barriera. Strategjia u hartua në Nëntor të vitit 2006. Përmes ratifikimit të KDPAK, Europa dhe Shtetet anëtare të saj, në nivel kombëtar, angazhohen për të fuqizuar personat me aftësi të kufizuara dhe për të mundësuar gëzimin e të drejtave nga ana e tyre. Shqipëria, sigurisht në kuadër të marrëveshjes së stabilizim-asocimit, dhe në përputhje me objektivat qeverisës ka detyrimin për t'iu bashkuar qëllimeve të kësaj strategjie. Fushat prioritare ë përcaktuara në strategji, janë:

- Aksesibiliteti
- Pjesëmarrja
- Punësimi
- Barazia
- Arsimimi dhe trajnimi
- Mbrojtja sociale

- Shëndetësi
- Veprimtari jashtë BE-së, siç janë programet e zhvillimit të BE-së.

*Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit*

Ky klasifikim është rekomanduar nga OBSH, si një instrument bazë për identifikimin e llojeve dhe niveleve të ndryshme të aftësisë së kufizuar, si domosdoshmëri për të siguruar të dhëna dhe statistika në nivel kombëtar në ndihmë të orientimit të politikave. Ky klasifikim siguron një përshkrim të situatave që kanë të bëjnë me funksionimin njerëzor dhe kufizimet e tij, si dhe shërben si kornizë apo sfond për të organizuar këtë formacion. Ai strukturon informacionin në mënyrë të kuptueshme, të ndërlidhur dhe lehtësisht të përdorshëm.

Synimi kryesor i klasifikimit është sigurimi i një gjuhe standarde të unifikuar dhe një informacioni për të përshkruar shëndetin dhe situatat e lidhura me të. Ai përcakton komponentët e shëndetit, si dhe ata komponentë që lidhen me mirëqenien dhe funksionimin, të tillë si edukimi dhe puna.

Në kuadër të reformës të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në Shqipëri, ky klasifikim është rekomanduar të përfshihet si bazë për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe nga KDPAK, por ato ende nuk kanë gjetur zbatim në praktikat aktuale në Shqipëri. Integrimi i këtij sistemi vlerësimi në sistemin shqiptar do të kërkojnë angazhimin maksimal edhe të strukturave lokale.

Rregullat standarde të OKB, 1992 për Barazinë e Mundësive për Personat me Aftësi të Kufizuara<sup>19</sup>, përcaktojnë aksesin dhe lëvizshmërinë personale si parakusht për pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara.

Axhenda Territoriale e Bashkimit European 2020 Diversiteti territorial dhe sfidat sociale, mënjanimi i grupeve vulnerable ku inkurajon aksesin e zonave periferike për të eliminuar politikat e disfavorshme ekonomike që mund të çojnë në veçimin e grupeve vulnerabël

Strategjia e re Europiane për aftësinë e kufizuar, 2010-2020<sup>20</sup>, ka në planin e veprimit të saj përshtatshmërinë si fushë të parë, duke vazhduar ta theksojë si parakusht për integrimin e personave me aftësi të kufizuara.

Aftësia e Kufizuar dhe Objektivat e Zhvillimit të Milleniumit (MDG), ku specifikohet që Objektivat e Mileniumit janë të lidhura ngushtë me paaftësinë dhe të gjitha përpjekjet e MDG duhet të përfshinë edhe PAK, si edhe të monitorojnë dhe vlerësojnë këtë përfshirje për të garantuar që ajo të jetë e drejtë dhe efektive. Të injorosh milionat e Personave me Aftësi të Kufizuar që jetojnë në botë, është jo vetëm të humbësh një shans, por edhe mësimet mbi mundësinë e suksesit për të gjithë.

<sup>19</sup>1993 (Rezoluta 48/96), Rregullat Standarte mbi Barazinë e Mundësive për Personat me Aftësi të Kufizuar

<sup>20</sup> European Disability Strategy, 2010-2020. A Renewed Commitment for Barrier Free Europe

## **(b) Instrumentët ligjorë kombëtarë**

- (i) Informim dhe Përfshirje
- (ii) Arsim
- (iii) Shërbime Sociale dhe Shëndetësorë
- (iv) Punësim
- (v) Përshtatshmëri

Më poshtë do të pasqyrojmë në mënyrë të përmbledhur disa nga ligjet kryesore, që mbulojnë fushat kryesore të trajtuara në këtë strategji

### **Ligje të posaçme**

*Ligji Nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”*

Ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ai. Autoritet publike, duke përfshirë këtu dhe njësitë e pushtetit vendor kanë detyrimet ligjore për të krijuar një ambient, i cili promovon barazinë dhe lufton për eliminimin e të gjithë formave të diskriminimi.

*Ligji Nr. 93/2014 datë 24.07.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i të drejtave thelbësore që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë këta persona në kushte të barabarta me të tjerët. Ky ligj ka për qëllim të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët dhe të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë

Institucionet shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me ministrin që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, për shkëmbimin e informacionit dhe lehtësimin e përbushjes së funksionit të tij. Për këtë qëllim, në çdo ministri, me urdhër të ministrit përkatës, caktohet një nëpunës që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar. Institucionet vendore, në zbatim të këtij ligji detyrohen të marrin gradualisht masat për sigurimin e fondeve të nevojshme për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore në ofrimin e shërbimeve publike. Organet e qeverisjes

vendore emërojnë një ose disa nëpunës vendorë, që merren me çështje të aftësisë së kufizuar, pranë tyre. Ky nëpunës duhet të ketë një formim të posaçëm në fushën e aftësisë së kufizuar dhe të monitorojë që ligjet dhe politikat hartohen në përputhje me këtë ligj. Institucionet vendore gjithashtu kanë detyrimin të mbledhin të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar sipas fushave ku ato operojnë.<sup>21</sup> Ligji trajton edhe disa koncepte të reja siç është vendimarrja e mbështetur apo jetesa e pavarur, duke prekur të gjitha fushat e jetës e për pasojë duke vendosur edhe detyrime të reja për organet e pushteti lokal.

### **Informim dhe përfshirje**

#### *Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”*

Ky ligj, i bazuar në modelet më të përparuara të vendeve evropiane dhe atyre të rajonit, pritet të garantojë rregulla konkrete për mbrojtjen dhe shndërrimin e të drejtës së informimit në një të drejtë reale dhe lehtësisht të zbatueshme në praktikë. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë ë autoriteteve publike. “Autoriteti publik”, që përfshin dhe organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni. Ligji ka hyrë tashmë në fuqi dhe është publikuar ne Fletoren Zyrtare më 17 Tetor 2014. Ky ligj, përcakton edhe disa informacione të cilat duhet të jenë pjesë e programit dhe të botuara në faqen zyrtare të internetit. Këto informacione, duhet të jenë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme. Patjetër, që këtu do të përfshihen dhe informacione për personat me aftësi të kufizuara, në formate të aksesueshme (të përshtatura) edhe për ata. Kjo duhet të vijë edhe në përputhje me parimin e rrymëzimit të çështjeve të aftësisë së kufizuar në programe, ligje e politika.

#### *Ligji nr. 146/2014 Për njoftimin dhe konsultimin publik*

Ky ligj, përmes parimeve dhe procedurave që përcakton, ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve që krijohen në një proces të konsultimit publik, transparent, gjithëpërfshirës, të realizuar në kohë dhe efektiv ndërmjet organeve publike qendrore dhe vendore dhe palëve të interesuara, në procesin e vendimmarrjes së projektakteve si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politikave me interes të lartë publik. Ai përmban dispozita lidhur me detyrimin që kanë organet publike për të marrë të gjitha masat e nevojshme për pjesëmarrjen e publikut, dhe të gjithë palëve të interesuara, në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, si dhe parashikimin se çdo

<sup>21</sup>Në lidhje me mënyrën e mbledhjes së statistikave pritet të dalë së shpejti një Vendim i Këshillimit të Mnistrave.

projektakt duhet të publikohet në regjistrin elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik, që është një faqe zyrtare interneti, e cila shërben si një pikë qendrore konsultimi. Ky ligj përveç detyrimeve konkrete e të detajuara që vendos mbi çdo autoritet, duke përfshirë organet e qeverive lokale, mund të shfrytëzohet si instrument efikas i komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, në vendimarrjen lokale.

## **Arsimi**

### *Ligj Nr. 69/2012 'Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë'*

Qëllimi i këtij ligji është garantimi i së drejtës kushtetuese për arsimim, sipas kuadrit ligjor përkatës për funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar. Duke qënë se ky ligj është hartuar me një pjesëmarrje të gjerë të grupeve të interesit, komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, në bazë të seancave të thëlluara dëgjimore dhe këshillimore, ai ka arritur të përfshijë koncepte dhe qasje bashkëkohore për nxënësit me aftësi të kufizuara. Në këtë ligj gjen reflektim parimi i mosdiskriminimit duke garantuar që në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t'u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral. Ligji kujdeset që nxënësve me aftësi të kufizuara t'i ofrohet një mbrojtje e posaçme.

Njësitë vendore, sipas këtij ligji janë veshur me disa përgjegjësi në fushën e arsimit. Kështu, këto njësi të qeverisjes vendore kanë për detyrë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike.

Kompetencat kryesore të njësisë bazë të qeverisjes vendore janë:

- a) ndërtimi dhe rikonstrukcioni i godinave të institucioneve arsimore publike, sipas standardeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me fonde të Buxhetit të Shtetit ose me fonde nga transferta e pakushtëzuar ose të ardhurat e veta;
- b) garantimi i paprekshmërisë së institucioneve arsimore në juridiksionin e saj, si dhe i mjediseve të tyre;
- c) ruajtja dhe mirëmbajtja e institucionit arsimor publik;
- ç) garantimi i kushteve higjieno-sanitare e atyre të ngrohjes në godinat e institucioneve arsimore publike.

Njësia bazë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me njësinë përkatëse arsimore vendore dhe institucionet arsimore publike, është përgjegjëse për regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë.

Ministria përfaqësohet në nivelin vendor nga njësitë arsimore vendore, të cilat krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Përveç disa detyrave kryesore që kanë njësitë vendore arsimore, ato gjithashtu bashkëpunojnë me njësinë bazë të qeverisjes vendore për

planifikimin, realizimin e investimeve dhe mirëmbajtjen e institucioneve arsimore, si dhe për rastet e braktisjes së shkollës<sup>22</sup>.

Në mbështetje të ligjit dhe të dispozitave normative janë miratuar këto vendime:

- *Urdhër Nr. 344, datë 19.8.2013 Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social.*
- *Udhëzim Nr.40, datë 17.10.2007 Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të shkollës*
- *Udhëzim Nr. 37, datë 13.8.2013 Për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit vendor të arsimit parauniversitar*
- *Vendim Nr.66, datë 3.2.2010 Për riorganizimin e Drejtorive rajonale dhe zyrave arsimore;*
- *Rregullore për funksionimin e drejtorisë arsimore rajonale dhe zyrës arsimore;*
- *Udhëzim Nr. 38, datë 07.10.2014 Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar;*
- *Dispozitat Normative 2013*

### **Shërbimet Shoqërore dhe Shëndetësore**

*Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (i ndryshuar)*

Ky është një ndër ligjet më të rëndësishme për mirëqenien dhe mbrojtjen sociale të fëmijëve dhe familjeve në situata të vështira, përfshirë ato me aftësi të kufizuara. Ligji ka për qëllim të përcaktojë ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë nevojat e tyre jetike, ndër to edhe individët me aftësi të kufizuara.

*Vendim Nr. 618 date 7.09.2006 (Ndryshuar me vendimin Nr.872, datë 18.6.2008) Për përcaktimin e kriterëve,të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara*

Ky vendim është një nga vendimet më të rëndësishme në zbatim të Lijgut për Ndihmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore. Ai përcakton kriteret dhe grupet, që përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuara.

*Vendim Nr. 326, datë 12.3.2009 Për disa shtesa në vendimin nr.31, datë 20.01.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, i ndryshuar*

Sipas këtij vendimit, periudha e shërbimit si kujdestar, për invalidin paraplegjik dhe tetraplegjik, i cili nuk është ekonomikisht aktiv, si dhe nuk përfiton të ardhura nga skema

---

<sup>22</sup>Informacion më i detajuar paraqitet në pjesë III, ‘Vlerësim i gjendjes në fushën e arsimit’.



e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë dhe sigurimi shëndetësor.

*Vendim Nr. 78 Datë 07.02.2007 (ndryshuar me vendim Nr.873, datë 18.6.2008) “Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjeno-sanitare për paraplegjikët dhe tetraplegjikët”*

Para dhe Tetraplegjikët, të cilët kanë përfituar statusin me Vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë për Punë (KMCAAP) dhe që vlerësohen se kanë humbje të plotë të sensibilitetit dhe të motorikës nga niveli i dëmtimit të poshtëm në të dyja anësitë, përfitojnë një pagesë shtesë, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë). Tashmë kjo shumë aktualisht është 14 000 lekë.

*Vendim Nr. 658 datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve shoqërore”*

Standardet përfaqësojnë një nivel të përbashkët të funksionimit dhe të kryerjes së veprimtarisë, që kërkohet të arrihet nga të gjitha llojet e shërbimeve shoqërore. Standardet janë parime të përgjithshme që shërbejnë për të siguruar cilësinë e shërbimeve shoqërore. Ato i drejtojnë shërbimet në plotësimin e nevojave të ndryshuara të përfituesve të tyre dhe të komunitetit të cilit i shërbejnë. Ato përfaqësojnë një mjet për të vlerësuar si nivelin e përmbushjes së nevojave të përfituesve, ashtu dhe të praktikave të shërbimeve shoqërore.

*Vendimi Nr. 209 date 14.4.2006 “Per përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave ne institucionet rezidenciale, publike dhe private, të përkujdesit shoqëror”*

Ky vendim përcakton kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm për pranimin e personave ne institucionet rezidenciale, publike dhe private, të përkujdesit shoqëror.

*Vendim Nr. 404, datë 20.6.2012 për përcaktimin e masës së kriterëve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën telefonisë fikse*

Vendimi përcakton rregullat dhe masën e rimbursimit të faturave të energjisë elektrike për kategoritë e përcaktuara në emërtimin e këtij vendimi. Rimbursimet kryhen në njësitë vendore.

*Vendim Nr. 822 datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, në qendrat rezidenciale dhe ditore”*

Standardet shërbejnë si dokument bazë për Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për të vlerësuar kapacitetet e ofruesve të shërbimeve për pajisjen me liçencë. Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, për personat me aftësi të kufizuara, synojnë respektimin e parimeve të dokumenteve themelore, si: parimi i së drejtës civile, barazisë dhe mosdiskriminimit, i vetëvendosjes, i përfshirjes, i pjesëmarrjes dhe mundësive të

barabarta, i jetesës pa barriera dhe mjedisit të lirë, i rehabilitimit, parandalimit, identifikimit dhe trajtimit të hershëm të aftësisë së kufizuar, integritit shoqëror dhe pjesëmarrjes në jetën e komunitetit.

*Ligj Nr.10 107, Datë 30.3.2009 Për kujdesin shëndetësor në Republikës e Shqipërisë*

Ka disa ligje që rregullojnë shërbimet shëndetësore në Shqipëri. Ndër më thelbësorët në këtë fushë, është Ligji për Kujdesin Shëndetësor. Neni 2 i këtij ligji sanksionon të drejtën për kujdes shëndetësor si një të drejtë themelore. Disa nga kompetencat për pushtetin vendor në këtë ligj janë: krijimi dhe ruajtja e një mjedisi të shëndetshëm brenda juridiksionit të territorit të tyre, administrimi i objekteve të shërbimit të kujdesit shëndetësor, të cilat janë në pronësi të tyre, përfshirje në politikat dhe organizmat drejtues të institucioneve shëndetësore brenda juridiksionit të tyre, dhënie e kontributeve financiare për institucionet shëndetësore brenda juridiksionit të tyre.

*Ligj Nr. 44/2012 Për Shëndetin mendor*

Ky ligj përcakton procedurën dhe kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor, nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, sigurimit të një mjedisi social të përshtatshëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor dhe nëpërmjet politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor. Disa kompetenca e detyrime të parashikuara për pushtetin lokal, që kanë të bëjnë me shëndetin mendor dhe të cilat listohen në ligj kanë të bëjnë krijimin e shërbimeve në familje nga ana e pushteti vendor dhe e organizatave që veprojnë, bashkëpunimin me familjarët, dhe marrjen e të gjitha masave për të mbështetur personat me çrregullime të shëndetit mendor dhe familjet e tyre.

*Urdhëri i MSH dhe ISSH Nr. 386, datë 17.06.2013*

Në lidhje me komisionimin e personave me probleme të shëndetit mendor, procedurat e paraqitjes në KMCAP kanë ndryshuar gjatë vitit 2013. Deri në këtë periudhë, fletët e drejtimit për në KMCAP mund të lëshoheshin vetëm nga shërbimet psikiatrike me shtretër, ndërkohë që tashmë këto mund të lëshohen edhe nga komisione pranë Qendrave Komunitare të Shëndetit Mendor (QKSHM). Ky hap, përveç disa aspekteve pozitive nxit edhe më shumë bashkëpunimin nga ana e pushtetit lokal dhe qendrave, duke i sjelle ato më afër.

*Ligji Nr.9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”*

Ligji përcakton rregullat dhe procedurat administrative për mënyrat e sigurimit, të shpërndarjes, të administrimit dhe të planifikimit të programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe për ndihmën e shtetit. Trajtohen me përparësi individët ose familjet individët me aftësi të kufizuar, të cilët gëzojnë statusin e të verbrit të grupit të parë, të invalidit paraplegjik ose tetraplegjik,

të invalidit të punës dhe të invalidit të Luftës Nacionalçlirimtare. Bashkitë, për menaxhimin e programeve të strehimit, sipas këtij ligji, kryejnë funksionet e mëposhtme:

- a) identifikojnë nevojat për strehim, sipas programeve të hartuara në bazë të këtij ligji për popullsinë nën juridiksionin territorial të tyre;
- b) hartojnë programe 10-vjeçare për strehimin dhe projekte trevjeçare, bazuar në burimet financiare që zotërojnë;
- c) sigurojnë sheshet e ndërtimit dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë, në zbatim të programeve të strehimit, të hartuara në bazë të këtij ligji;

## **Punësimi**

### *Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësim 2014-2020*

Një nga konstatimet e kësaj strategjie, është përcaktimi i grupeve më të riskuara për përjashtim social që janë: Personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë e rrezikuar, grupet e veçanta të femrave dhe pakicat rome dhe egjiptiane. Fëmijët e grupeve të popullsisë rome dhe fëmijët me aftësi të kufizuara kanë shkallën më të ulët të regjistrimit në shkollë, krahasuar me mesataren kombëtare. Papunësia në radhët e punëkërkueseve femra të regjistruara do të përgjysmohet dhe do të krijohen mundësitë e qasjes së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet kurseve të përshtatura të formimit profesional. Përveç kësaj, edhe pengesat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara, të cilët përfitojnë nga Arsimi dhe Formimi Profesional si: mundësia e qasjes fizike në kurset e AFP-së, mungesa e instruktorëve të trajnuar, mungesa e materialeve të përshtatshme, informacioni i kufizuar, ngurrimi i kompanive si edhe i institucioneve publike për t'i punësuar ata, mungesa e shërbimeve shoqëruese mbështetëse, si dhe e personave që përkujdesen për to, bashkë me çështjet e transportit, duhen zgjidhur me masa konkrete. Një objektiv i kësaj strategjie është rritja vjetore e raportit të personave me aftësi të kufizuara në AFP 1 pikë përqindje. Ndërsa një objektiv tjetër është rritja e numrit të përfituesve nga ndihma sociale të përfshirë te programet e nxitjes së punësimit në 10% të numrit total të pjesëmarrësve në programet e nxitjes së punësimit.

### *Ligji “Për nxitjen e punësimit” Nr. 7995, datë 20.09.1995 (i ndryshuar)*

Ky ligj përcakton që shërbimet e riaftësimit profesional janë të mundshme për të gjithë PAK, me kusht që ata të mund të përgatiten për to dhe të kenë perspektivë të arsyeshme për sigurimin dhe mbajtjen e punëve të përshtatshme. Megjithatë, shërbimet rehabilituese me qëllim aftësimin për punë janë inekzistente. Ky ligj vendos edhe detyrimin që, çdo punëdhënës që punëson më tepër se 24 punonjës, është i detyruar të punësojë një person me aftësi të kufizuara për çdo 25 punonjës të personelit të tij, një punëdhënës mund të punësojë një person me handikap të rëndë në vend të pesë personave me handikap<sup>23</sup> të

---

<sup>23</sup>Terminologji e vjetruar

lehtë. Neni 16 parashikon stimujt për inkurajimin e punësimit të PAK. Në këtë kuadër përcaktohet se punëdhënësi mund të kërkojë subvencion nga zyra kompetente e punësimit (rajonale) për të pajisur siç duhet vendin e punës të PAK dhe për t'i siguruar atij/asaj një përgatitje thelbësore për punën

Në zbatim të ligjit për nxitjen e punësimit janë miratuar edhe disa programe të veçanta të nxitjes së punësimit:

*Vendim nr. 248 “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara”*

Ky vendim vlerësohet në mënyrë të veçantë pasi, pas shume vitesh, erdhi si një program i posaçëm për personat me aftësi të kufizuara, duke njohur kështu specifikat e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë të veçantë. Ai vepron mbi parime të ngjashme me programe të tjerë paraprirës por sjell edhe disa risi, siç është financimi i përshtatjes së arsyeshme. Sipas tij, punëdhënësi, fiton një financim mujor në masën deri në 100 për qind të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të pjesës së kontributit të punëdhënësit, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit. Punëdhënësi gjithashtu përfiton një financim për të pajisur siç duhet vendin e punës/transport (përshtatja e arsyeshme) të personit me aftësi të kufizuar dhe për t'i siguruar atij/asaj një përgatitje thelbësore për punën deri në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë, nëse punëson më shumë se dy persona.

*Vendim Nr. 47, datë 16.1.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”*

Një nga programet që vjen në mbështetje të ligjit për nxitjen e punësimit është programi për nxitjen përmes trajnimit. Kohëzgjatja e tij është 6 muaj. Punëdhënësi, që organizon trajnim, të përgjithshëm, për qëllim formimi, nëpërmjet punës së personave punëkërkues të papunë, mund të përfitojë financime nga zyra përkatëse e punësimit, në masën 70 për qind të kostove të trajnimit, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe 50 për qind të kostove të trajnimit, për ndërmarrjet e mëdha. Punëdhënësi, në përfundim të periudhës së formimit, duhet të punësojë jo më pak se 50 për qind të të trajnuarve, me kontratë mësimi profesioni, për një periudhë 6-mujore. Kursantët, punëkërkues të papunë, përfitojnë një pagesë pjesëmarrjeje në kurs, në masën 50 për qind të pagës minimale, në shkallë vendi, për të gjithë kohëzgjatjen e trajnimit, e cila përballohet nga zyra përkatëse e punësimit, nga fondet e nxitjes së punësimit.

*Vendim Nr. 48 për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë në vështirësi*

Një vendim tjetër për nxitjen e punëdhënësve është vendimi 48, i cili parashikon mbulimin e sigurimeve të detyrueshme dhe një numër të caktuar pagash. Konkretisht parashikohet që punëdhënësi, që punëson me kontratë, me kohëzgjatje njëvjeçare,

punëkërkues të papunë në vështirësi (sipas përcaktimit në ligj, të tillë janë dhe personat me aftësi të kufizuara), mund të përfitojë një financim për një vit, në masën 100 për qind të sigurimeve të detyrueshme shoqërore të pjesës së punëdhënësit dhe një financim për katër muaj, në masën 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, duke filluar

*Vendim Nr. 632, datë 18.09.2003 për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë femra*

Ky vendim, përveç financimit të sigurimeve të detyrueshme të punëdhënësit, në rastin e punësimit të punëkërkuesve femra të papuna, i cili rritet në varësi të kohëzgjatjes së kontratës së punës, parashikon gjithashtu që, në rastin e punësimit të femrave romë, vajzave nëna, femrave të divorcuara me probleme sociale dhe femrave me aftësi të kufizuara, ky financim shtohet deri në nivelin e katër pagave minimale për kontrata njëvjeçare, gjashtë paga për dy vite dhe tetë paga për tre vite.

*Ligji “Mbi arsimin profesional në RSH”, Nr. 8872, datë 29.03.2002*

Në nenin 5 të këtij ligji parashikohet hapja e shkollave dhe klasave të posaçme si dhe kualifikimi i personelit për të punuar me PAK. Kuadri ligjor siguron ofrimin e kurseve të formimit profesional me çmime të reduktuara apo falas për grupet në nevojë përfshirë personat me aftësi të kufizuara. Ky ligj, bazuar në informacionet nga MMSR, është në proces ndryshimi.

*Udhëzim Nr. 2222 datë 31.10. 2002 “Mbi këshillimin dhe orientimin në formimin profesional”*

Këshillimi dhe orientimi në formimin profesional u ofrohet shtetasve për t’u siguruar atyre mbështetje dhe orientim të gjithanshëm mbi formimin profesional, mbi karierrën, këshillim të plotë individual, ndërmjetësim në qendrat e formimit profesional dhe nxitjen e formimit profesional të nevojshëm në raste te veçanta. Sipas këtij udhëzimi, kujdes i veçantë në këshillimin dhe orientimin profesional t’u kushtohet grupeve te veçanta, të përcaktuara në ligj dhe në akte nënligjore.

### **Përshtashmëria**

*Vendimin Nr.1503, datë 19.11.2008 rregulloren “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*

Rregullorja ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.

*Ligji Nr. 107/2014 Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*

Ndër parimet që përshkojnë ligjin ka dhe një parashikim për personat me aftësi të kufizuara: planifikimi e zhvillimi duhet të garantojnë eliminimin e barrierave, për një përdorim të sigurt, të barabartë e të pavarur të hapësirave nga të gjithë personat, përfshirë

ata me aftësi të kufizuar ose grupe të veçanta, për të cilët janë të nevojshme zgjidhje teknike apo pajisje të veçanta.

Ligji Nr. 107/2014 Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, sanksionon konceptin **“Hapësirë e përshtatur”** si “hapësira që ofron përdorim të sigurt, të barabartë e të pavarur nga të gjithë personat, përfshirë ata me aftësi të kufizuar ose grupe të veçanta, për të cilët janë të nevojshme zgjidhje teknike apo pajisje të veçant”. Në këtë ligj përcaktohen kriteret për përgatitjen dhe përmbajtjen e **Rregulloreve të ndërtimit**: Rregulloret e ndërtimit përcaktojnë normat dhe kushtet teknike bazë, të detyrueshme të projektimit, zbatimit të punimeve, përdorimit, mirëmbajtjes, prishjes dhe heqjes së strukturave dhe zhvillimin e infrastrukturës publike, materialet, cilësinë dhe përdorimin e tyre, me qëllim garantimin e sigurisë dhe të cilësisë së jetës e të shëndetit, konservimin e energjisë, mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimin e rregullave për përshtatjen e strukturave e të territoreve për individët me aftësi të kufizuar, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe legjislacionit të fushës në fuqi.

Rregullorja e Planifikimit të Territorit në të cilën sanksionohen autoritetet dhe përmbajtja e Instrumentave Kombëtarë dhe Vendorë të planifikimit të territorit, si edhe Rregullorja e Zhvillimit të Territorit ku përcaktohen kriteret dhe mënyrat e miratimit të lejeve për të gjitha kategoritë e ndërhyrjeve në territor.

### (c) Instrumentët lokalë

*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*, ka sanksionuar se qeverisja vendore ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore. Pjesa e gjashtë e Kushtetutës, ka hedhur bazën e hartimit të legjislacionit mbi qeverisjen vendore duke përcaktuar organet vendore, mënyrën e zgjedhjes së tyre, disa nga detyrat e kompetencat kryesore të tyre.

*Ligji nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore”*

Sipas tij njësitë e qeverisjes vendore janë 61 bashki dhe 12 qarqe. Organet e njërive të qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2011 dhe me juridiksion territorial sipas ndarjes administrativo-territoriale, të përcaktuar me ligjin nr. 8653, datë 31.7.2000, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me ligjin nr. 8654, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”, vazhdojnë funksionimin e tyre deri në konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njërive të qeverisjes vendore në zgjedhjet e vitit 2015.

*Ligji Nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar)*

Sipas këtij ligji, njësitë e qeverisjes vendore janë persona juridikë dhe gëzojnë të drejta për të rregulluar dhe administruar në mënyrë të pavarur çështje brenda juridiksionit të tyre, të ushtrorjnë të drejtën e pronësisë, të drejtën e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve, të drejtën e kryerjes së veprimtarive ekonomike, të vendosin, në përputhje me ligjin, taksat dhe tarifatat vendore, të bashkëpunojnë me njësi të tjera të qeverisjes vendore për të ushtruar funksione që i'u janë dhënë atyre me ligj.

Ligji i ndan funksionet që kryejnë këto njësi në tre grupe:

1. Funksione të veta;
2. Funksione të përbashkëta;
3. Funksione të deleguara.

Funksionet e veta lidhen me kompetencat e plota administrative, kompetencat për të dhënë shërbime, realizuar investime apo kompetenca rregullatore, duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale në fushat e mëposhtme:

- Infrastruktura dhe shërbimet publike: uji i pijshëm, sistemi i ujësjellës kanalizimeve, rrugët vendore, trotuarët dhe sheshet publike, ndriçimi, transporti publik urban, gjelbërimi, mbeturinat, planifikimi urban, menaxhimi i tokës etj;
- Shërbimet me karakter social, kulturor e sportiv: vlerat kulturore dhe historike vendore, veprimtaritë sportive, çlodhëse e argëtuese, shërbimi social dhe administrimi i çerdheve, azileve, shtëpive të femijëve etj;
- Zhvillimi ekonomik vendor: programet e zhvillimit ekonomik, rrjeti i tregtisë, biznesi i vogël, shërbimi veterinar, pyjet, kullotat dhe burimet natyrore me karakter vendor;
- Rendi dhe mbrojtja civile, ku përfshihen ruajtja e rendit publik, mbrojtja civile.

Komunat dhe bashkitë kryejnë funksione të përbashkëta me institucionet e qeverisjes qendrore. Ligji përcakton në nenin 11 të tij, funksionet e përbashkëta të pushtetit vendor dhe qendror ku ndër të tjera është dhe:

- Kujdesi social;
- Sistemin e shërbimit parësor shëndetësor dhe mbrojtjen e shëndetit publik;
- Kujdesin social;
- Zbutjen e varfërisë;
- Garantimin e funksionimit të institucioneve përkatëse;
- Funksione të tjera të përbashkëta, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Ndërsa në lidhje me funksionet e deleguara, ligji shprehet që, institucionet qendrore, kur lejohet me ligj, autorizojnë komunën, bashkinë ose qarkun të kryejnë funksione të caktuara të institucioneve qendrore, duke përcaktuar procedurat e kryerjes dhe të kontrollit për zbatimin e tyre. Edhe në këto raste, institucionet qendrore u garantojnë njësitë të qeverisjes vendore mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.

Natyrisht, që njësitë me iniciativën e tyre mund të përdorin gjithashtu burimet e veta financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave. Në lidhje me këtë, ligji përcakton se njësitë vendore mund të ndërmarrin çdo lloj nisme me interes publik vendor, përsa kohë nuk e kanë të ndaluar me ligj ose, që nuk i është dhënë ekskluzivisht një organizmi tjetër.

Në lidhje me transparencën, në respekt të të drejtës për t'u informuar e për pjesëmarrje, ligji "*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*", përmeseneve 34, 35 garanton pjesëmarrjen, konsultimin, informimin dhe transparencën në vendim-marrje. Sipas tij, çdo qytetar ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit. Mbledhjet e hapura i japin mundësi qytetarëve të shohin direkt mënyrën se si ata po qeverisen.

Këshilli komunal ose bashkiak, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë. Seancat e këshillimit janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenin 32 (buxheti, tjetërsimi dhe dhënia në përdorim të pronave të tretëve, taksat e tarifatat vendore, miratim normash e rregullash për garantimin e interesit publik). Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore. Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare"<sup>24</sup> dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.

---

<sup>24</sup>Tashmë i shfuqizuar me ligjin nr. 119/2014 +Për të Drejten e Informimit.



### **ANEKS 3. PORTOFOLI I PROJEKTEVE**

**OBJEKTIVI:**Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Gjithpërfshirja e tyre në Politikat dhe Programet e Qeverisjes Vendore

**NDËRHYRJA II.** Rritja e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse, për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit për të respektuar të gjitha kërkesat e standartet në parandalimin e barrierave në projektet e reja dhe në heqjen graduale të barrierave në objektet egzistuese

**PROGRAMI**

**II.1 Trajnim:**

- a) për stafin e zyrës së urbanistikës në bashki, kontrollin e projekteve, këshillin teknik, komisionin e planifikimit të territorit pranë Këshillit Bashkiak, inspektoriatin ndërtimor e urbanistik vendor, administratorë të objekteve shëndetësore, arsimore e kulturore, arkitektë projektues, kompani ndërtuese, biznese etj, për të parandaluar shfaqjen e barrierave në objektet e reja dhe heqjen e barrierave egzistuese.
- b) për stafin e departamentit të transportit në bashki për të mos lejuar qarkullimin e mjeteve të transportit të papërshtatura, si edhe për zëvendësimin e atyre egzistuese me mjete transporti të përshtatura.
- c) Për pronarët/administratorë të bizneseve private mbi detyrimet ligjore për zbatimin e kërkesave dhe standarteve të përshtatshmërisë në objektet e reja dhe ekzistuese.
- d) Për qytetarët/komunitetin mbi detyrimin për të garantuar një mjedis të përshtatur.

**Emri i projektit**

- II.1 Trajnim: Gjithpërfshirja dhe aftësia e kufizuar: konceptet e përgjithëshme për gjithpërfshirjen dhe aftësinë e kufizuar, legjislacionin shqiptar dhe ndërkombëtar për të drejtat e aftësisë së kufizuar; mbi politikat dhe legjislacionin mbi kërkesat/standartet dhe rregullat teknike për ndërtime dhe transport të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara
- Trajnime te ndryshme
- Përgatitjae moduleve
  - Broshurë/manual/fletë palosje përmbledhëse mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për një mjedis pa barriera.
  - Përgatitja, botimi e shpërndarja e materjaleve ndërgjegjësuere dhe manualeve teknike në ndihmë të zbatimit të kuadrit ligjor për ndërtime të përshtatura/pa barriera
  - Manual praktik në mbështetje të zbatimit të rregullave teknike/standarteve të përshtatshmërisë ndërtimore.
  - Fletë palosje ndërgjegjësuere për subjektet projektuese dhe zbatuese në fushëm e ndërtimit
  - Pasqyrim periodik i problematikës dhe arritjeve nga zyra e shtypit të bashkisë në mediat lokale

**PERSHKRIMI I PROJEKTIT**

Aktualisht, niveli i njohurive të stafit të specialistëve mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, nevojat e tyre për një jetë normale dhe integrimin në shoqëri, nuk është ende në nivelin e duhur. Ndonëse tashmë ka një paketë ligjore të mjaftueshme për të zbatuar kërkesat dhe standartet e përshtatshmërisë në mjedisin e ndërtuar, niveli i zbatimit të ligjit nga specialistët e fushës, le shumë për të dëshëruar. Krijimi në vazhdimësi i barrierave edhe në ndërtimet e reja me karakter biznesi, tregon nivelin e ulët të ndërgjegjësimit të pronarëve/administratorëve të bizneseve në lidhje me detyrimet ligjore për të krijuar mjedis të përshtatur për Personat me Aftësi të Kufizuara. Ky projekt synon të rrisë nivelin e njohurive dhe vëmendjessë stafit përgjegjës, aktorëve të tjerë në këtë fushë dhe komunitetit mbi detyrimet ligjore e kërkesat dhe standartet e përshtatshmërisë së mjedisit të ndërtuar. Ndikimi do të shkojë edhe më tej, edhe tek subjektet kërkuese për leje ndërtimi, të cilët janë në komunikim të vazhdueshëm me stafin e specialistëve të Bashkisë.

<p><b>OBJEKTIVAT</b></p> <p>1. Të rritet niveli i ndërgjegjesimit të personave përgjegjës dhe specialistëve për të drejtat e PAK</p> <p>2. Të rritet niveli i ndërgjegjesimit për nevojat dhe kërkesat e personave me aftësi të kufizuara dhe të barrierave me të cilat ndeshen për plotësimin e tyre.</p> <p>3. Të rritet niveli i njohjes së detyrimeve ligjore dhe standarteve teknike për një mjedis pa barriera.</p>	<p><b>GRUPET E SYNUARA</b></p> <p>1. Specialistet e zyrës së urbanistikës në bashki, kontrollin e projekteve, këshillin teknik, zyrës së infrastrukturës, arsimit e kulturës, komisionin e planifikimit të territorit pranë Këshillit Bashkiak, Inspektoriatin ndërtimor e urbanistik vendor, administratorë të objekteve shëndetësore, arsimore e kulturore, arkitektë projektues, kompani ndërtuese, biznese, komuniteti, etj,</p> <p>2. Personat me Aftësi të Kufizuar e familjarët e tyre</p>
<p><b>AKTORE TE PERFSHIRE DIREKT</b></p> <p>1. Subjektet trajnuese</p> <p>2. Stafet e departamenteve respektive</p>	<p><b>KONTRIBUTE TE MUNDESHME</b></p> <p>1. Pushteti vendor</p> <p>2. Donatorë</p>
<p><b>BUXHETI I PLANIFIKUAR</b></p> <p>200.000 Lekë</p>	<p><b>KOHEZGJATJA E ZBATIMIT</b></p> <p>2015 -2019</p>

## Projekti 2.

<b>OBJEKTIVI</b> Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Gjithpërfshirja e tyre në Politikat dhe Programet e Qeverisjes Vendore	
<b>NDËRHJRJA VI.</b> Të parashikohen burime financiare për heqjen graduale të barrierave në objektet egzistuese.	
<b>Programi:</b> IV.1 Të vlerësohet dhe evidentohet niveli i përshtatshmërisë në objektet egzistuese, duke filluar nga objektet publike/asete të bashkisë (objekte, rrugë, sinjalistikë, vend-parkime), objektet e kulturës në administrim nga Bashkia, si edhe objektet private.	<b>Emri i projektit:</b> IV.1.1 Vlerësim, gjetje dhe rekomandime mbi nivelin aktual të përshtatshmërisë në ndërtesat egzistuese të institucioneve publike /kopshte /shkolla/qendra shëndetësore/qendra kulturore; si edhe në rrugë, sinjalistikë dhe vend-parkime/mjetet e transportit publik etj. - përgatitja e metodologjisë dhe instrumentave - mbledhja dhe vlerësimi i të dhënave - përgatitja e raportit me rezultatet e vlerësimit dhe ndërhyrjet e nevojshme - prezantimi dhe publikimi i tij
<b>PËRSHKRIMI I PROJEKTIT</b> Mjedisi ndërtimor në qytet është tejet i ngarkuar me barriera që pengojnë në çdo hap lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara në rrugë, për të shkuar në shkollë, në poliklinikë, në punë, në zyra të institucioneve, në treg, në ambjente argëtimi. Projekti synon të orientojë heqjen graduale të barrierave, duke kryer fillimisht një studim mbi gjendjen aktuale dhe me rekomandimet për ndërhyrje – duke përcaktuar mënyrat dhe elementet. Rezultati do të ndihmojë në nxjerrjen e prioriteteve dhe në eficiencën e ndërhyrjeve.	
<b>OBJEKTIVA</b> - të evidentohet gjendja aktuale - të orientohej planifikimi buxhetor -të përcaktohen hapat për fillimin e ndërhyrjeve për përshtatje	<b>GRUPET E SYNUARA</b> - specialistët e planifikimit të investimeve - investitorët
<b>AKTORËT E PËRFSHIRË DIREKT</b> - stafet e specialistëve në bashki dhe drejtoritë rajonale të arsimit e të shëndetësisë - OJF - donator - Grupe vullnetare	<b>KONTRIBUTE TË MUNDSHME</b> - pushteti vendor - komuniteti i biznesit - OJF me ekspertizë - Grupe vullnetare për të kryer matjet
<b>BUXHETI I KËRKUAR</b> Pa buxhet shtesë në se kryhet nga institucioni 500.000 Lekë, në se kryhet me ekspertë	<b>KOHA E ZBATIMIT</b> 2015 - 2016

### Projekt 3

<b>QËLLIMI:</b> Përmirësimi i cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës, përmes realizimit të së drejtës për të marrë shërbime të përshtatura me moshën, gjininë e nevojat e tyre.	
<b>OBJEKTIVI:</b> Të pilotohet e fillojë funksionimin zinxhiri i shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës	
<b>Programi:</b> Shërbimet	<b>Emri i projektit:</b> Qendër multifunkionale informimi, orientimi, këshillimi për personat me aftësi të kufizuara e familjet e tyre.
<b>PËRSHKRIMI I PROJEKTIT</b> Qendrat informuese janë zakonisht qendra jo-rezidenciale, në përbërje të të cilave punësohen persona me dhe pa aftësi të kufizuara. Pikësynimi kryesor është të ndihmojnë personat me aftësi të kufizuara të arrijnë potencialin e tyre maksimal në gjirin e familjes dhe komunitetit. Gjithashtu ato janë edhe qendra avokatie për çështje të rëndësishme në nivel lokal dhe kombëtar. Qendrat e informimit ofrojnë akses për strehim, punësim, transport, aktivitete shlodhëse, si dhe akses në shërbimet sociale e shëndetësore. Bashkia duhet të ketë rolin e institucionit lider në identifikimin e rastit, koordinimin për zgjidhje dhe menaxhimin e tij. Qendra mund të ofrojë informacion mbi operatorët publikë apo privatë që ofrojnë shërbime shoqërore apo shërbime të tjera ndihmëse në funksion të personave me aftësi të kufizuara në Rajonin e Lezhës. Qendra mund të marrë edhe rolin e ndërmjetësuesit- ndihmuesit midis ofruesve të shërbimeve shoqërore dhe personave me aftësi të kufizuar-familjarëve të tyre për sigurimin e shërbimeve shoqërore në përputhje me nevojat që ata paraqesin. Nga ana tjetër qendra do të shërbente më së miri si një pikë identifikuese dhe vlerësuese e nevojave të personave me aftësi të kufizuar në Bashkinë Lezhë. <i>Shërbimi i mbështetjes së familjes duhet të jetë pjesë e shërbimeve të ofruara në të.</i> Përmes këtij shërbimi do të synohet të ofrohet informacion, mbështetje emocionale, koordinim të burimeve/shërbimeve dhe kur është e mundur ndihmë financiare familjeve që kanë një anëtar me aftësi të kufizuara që jeton me familjen. Shërbime të tilla mbulojnë orientimin në “respite care”, shërbime profesionale, aktivitetet zbavitëse, pajisjet adaptive si edhe përshtatshmërinë e shtëpisë. Disa nga shërbimet janë për individë me aftësi të kufizuara, të tjerat janë për mbarëvajtjen e familjes. Programi zbatohet nga punonjës socialë në rolin e koordinatorit, të cilët janë në kontakt të vazhdueshëm me familjen. Sipas mundësive, programi ofron grupe terapeutike për prindër, vëllezër/motra, programe të koordinimit të kujdesit ditë etj.	
<b>OBJEKTIVAT</b> 1. Identifikim e vlerësim i nevojave të klientëve me aftësi të kufizuara. 2. Informacion, këshillim e ndërmjetësim në fusha të tjera si strehimi, arsimit, punësimi, shërbimet sociale e shëndetësore. 3. Avokati e lobim për adresimin e	<b>GRUPET E SYNUARA</b> Informim e orientim për 500-600 persona me aftësi të kufizuara e familjet e tyre.

problemeve	
<b>AKTORËT E PËRFSHIRË DIREKT</b> Bashkia Lezhë, MMSR, Shërbimi Social Shtetëror, OJF, persona me aftësi të kufizuara, prindër e familjarë.	<b>KONTRIBUTE TË MUNDSHME</b> -Bashkia Lezhë -MMSR -SHSSH
<b>BUXHETI I KËRKUAR</b> 4.690.000 Lekë/vit 18.760.000 Lekë/4 vjet	<b>KOHA E ZBATIMIT</b> Duke filluar nga viti 2016

#### Projekti 4.

<b>QËLLIMI:</b> Përmirësimi i cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës, përmes realizimit të së drejtës për të marrë shërbimë të përshtatura me moshën gjininë e nevojat e tyre.	
<b>OBJEKTIVI:</b> Të pilotohet e fillojë funksionimin zinxhiri i shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës.	
<b>Programi:</b> Shërbimet Sociale	<b>Emri i projektit:</b> Ndërhyrje në fëmijërinë e hershme
<b>PËRSHKRIMI I PROJEKTIT</b> <i>Qendrat në fushën e ndërhyrjes për fëmijërinë e hershme janë qendra, të cilat ofrojnë mundësi të ndryshme shërbimesh për fëmijët parashkollorë që janë në rrezik për të zhvilluar aftësi të kufizuara apo kanë lindur me aftësi të kufizuara fizike, mendore, shqisore etj.. Kjo do të kërkonte caktimin e një stafi koordinues që punon së pari me familjen, në bazë të një plani multidisiplinar, duke patur në qendër fëmijën. Në këtë mënyrë fëmijës i ofrohet ndërhyrje terapeutike multidisiplinare sipas nevojave të veçanta që paraqet (terapist të foluri, fizik, okupacional, etj.) në mjedisin natyral dhe jo në zyrat e terapistit apo në qendër të izoluar. Mjedis natyral quhet mjedisi ku fëmija ushtron aktivitetin e përditshëm, ndjekja e kopshtit, shkollës apo qendrës ditore. Qendra punon me 15-20 klientë në muaj.</i>	
<b>OBJEKTIVAT</b> 1. Identifikimi i aftësisë së kufizuar në fazat e saj fillestare 2. Parandalimi dhe trajtimi në ambientet ku fëmija jeton.	<b>GRUPET E SYNUARA</b> 15-20 fëmijë me aftësi të kufizuara cdo muaj
<b>AKTORËT E PËRFSHIRË DIREKT</b> Bashkia Lezhë, MMSR, Shërbimi Social Shtetëror, OJF, persona me aftësi të kufizuara, prindër e familjarë.	<b>KONTRIBUTE TË MUNDSHME</b> -Bashkia Lezhë -MMSR -SHSSH
<b>BUXHETI I KËRKUAR</b>	<b>KOHA E ZBATIMIT</b>

4.450.000Lekë/vit 13.350.000 lekë/3 vjet	Duke filluar nga viti 2016
---	----------------------------

## Projekti 5

<b>QËLLIMI:</b> Përmirësimi i cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës, përmes realizimit të së drejtës për të marrë shërbimë të përshtatura me moshën gjininë e nevojat e tyre.	
<b>OBJEKTIVI:</b> Të pilotohet e fillojë funksionimin zinxhiri i shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës.	
<b>Programi: Shërbimet</b>	<b>Emri i projektit:</b> Pilotimi i Shërbimeve të pjesëmarrjes në komunitet
<b>PËRSHKRIMI I PROJEKTIT</b> Këto shërbime, do të krijojnë mundësinë e pjesëmarrjes në jetën e komunitetit për individë me aftësi të kufizuara, që kanë nevojë për mbështetje dhe mbikqyrje të vazhdueshme. Aktivitetet do të përfshijnë programe zbatimëse dhe shlodhjeje, aktivizimin politik (si pjesëmarrje në shoqata, etj.) si edhe punë vullnetare.Shërbimet e pjesëmarrjes në komunitet i japin mundësinë individëve të ndjehen të integruar, ndërsa komunitetit të shohë të gjithë diversitetin e tij, duke kontribuar kështu në zhvillimin e frymës së mirëkuptimit dhe tolerancës. Individit me aftësi të kufizuara merr pjesë në aktivitete i shoqeruar nga një asistent personal. Në rast se individit nuk i është caktuar një asistent personal, studentë vullnetarë të degëve të shkencave sociale, mund ta kryejnë rolin e shoqëruesit të personave me aftësi të kufizuara, të koordinuar nga zyra e shërbimeve sociale në bashki.	
<b>OBJEKTIVA</b> 1. Lehtësim i shoqërizimit në komunitet të personave me aftësi të kufizuara.  2. Ndërgjegjësim i komunitete për të pranuar diversitetin.	<b>GRUPET E SYNUARA</b> -45 persona me aftësi të kufizuara  -Prindër e familjarë të tyre
<b>AKTORËT E PËRFSHIRË DIREKT</b> Bashkia Lezhë, MMSR, Shërbimi Social Shtetëror, OJF, persona me aftësi të kufizuara, prindër e familjarë.	<b>KONTRIBUTE TË MUNDSHME</b> -Bashkia Lezhë -SHSSH -Qendra shërbimesh -Universitete
<b>BUXHETI I KËRKUAR</b> Vullnetarisht (brenda burimeve ekzistuese)	<b>KOHA E ZBATIMIT</b> Duke filluar nga viti 2016

\* Ky aktivitet nuk është buxhetuar, pasi propozohet të ngrihet mbi baza vullnetare dhe brenda mundësive e kapaciteteve ekzistuese.

## Projekti 6

<b>QËLLIMI:</b> Përmirësimi i cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës, përmes realizimit të së drejtës për të marrë shërbimë të përshtatura me moshën gjininë e nevojat e tyre.	
<b>OBJEKTIVI:</b> Të pilotohet e fillojë funksionimin zinxhiri i shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës.	
<b>Programi:</b> Shërbimet	<b>Emri i projektit:</b> Shërbimi i Ndhmësit Personal për Personat me Aftësi të kufizuara.
<b>PËRSHKRIMI I PROJEKTIT</b> <p>Ligji “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” përcakton ngritjen e shërbimit të ndihmësit në familje për personat me aftësi të kufizuara si edhe trajnimin e tyre. Pilotimi i shërbimit të ndihmësit personal është një shërbim i domosdoshëm, i cili synon në lehtësimin e familjes dhe rritjen e shkallës së independencës e të pjesëmarrjes së individit me aftësi të kufizuara të rënda. Shërbimi duhet të fillojë në një numër të kufizuar personash dhe më pas eksperiencën e fituar të shtrihet më gjerë. Është një mundësi punësimi për qytetarët e Lezhës e si tillë, ndikon në rritjen ekonomike të qytetit. Ofrimi i këtij shërbimi do të ketë impakt në përmirësimin e cilësisë së kujdesit, por edhe të mënyrës së jetesës së përdoruesve dhe familjareve të tyre, pasi do të ofrohen mundësi të barabarta për një jetë më të pavarur drejt përfshirjes sociale të tyre. Zbatimi i këtij projekti, do të ecë paralelisht me krijimin e standarteve përkatëse, moduleve të trajnimit për asistentët dhe trajnimin e tyre. Avokatia e lobimi do të jenë elementë që dotë ndikojnë në përmirësimin e sistemit me qëllim njohjen, zgjerimin e numrit të përfituesve dhe shtrirjen e tij edhe në rajone të tjera.</p> <p>Projekti do të fillojë me një numër përfituesish prej 30 personash me aftësi të kufizuara të rënda. 40 ndihmës personalë, do të përzgjidhen, trajnohen e ofrojnë shërbimin në familje, në varësi të nevojave të individit.</p> <p>Shërbimi është një alternativë kundrejt institucionalizimit të personave me aftësi të kufizuara të rënda e të cilët jetojnë të vetmuar.</p>	
<b>OBJEKTIVA</b> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Prezantimi dhe ofrimi i shërbimit të asistentit personal si një hap drejt realizimit të jetesës së pavarue për 30 persona me aftësi të kufizuara.</li><li>2. Ofrimi i mundësive për punësim 40 asistentëve personal.</li><li>3. Trajnim, avokati e lobim për krijimin e standarteve të këtij shërbimi, njohjen e përgjithësimin e tyre, duke synuar në</li></ol>	<b>GRUPET E SYNUARA</b> <p>30 persona me aftësi të kufizuara</p> <p>40 të papunë nga qyteti I Lezhës</p>



zgjerimin e këtij shërbimi.	
<b>AKTORËT E PËRFSHIRË DIREKT</b> Bashkia Lezhë, MMSR, Shërbimi Social Shtetëror, OJF, persona me aftësi të kufizuara, prindër e familjarë.	<b>KONTRIBUTE TË MUNDSHME</b> -Bashkia Lezhë -MMSR -SHSSH
<b>BUXHETI I KËRKUAR</b> 2.960.000Lekë/vit 11.840.000Lekë/4vjet	<b>KOHA E ZBATIMIT</b> Duke filluar nga viti 2016

### Projekt 7

<b>QËLLIMI:</b> Përmirësimi i cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës, përmes realizimit të së drejtës për të marrë shërbime të përshtatura me moshën, gjininë e nevojat e tyre.	
<b>OBJEKTIVA:</b> Të pilotohet e fillojë funksionimin zinxhiri i shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës.	
<b>Programi:</b> Shërbimet Sociale	<b>Emri i projektit:</b> Transport i përshtatur për personat me aftësi të kufizuara.
<b>PËRSHKRIMI I PROJEKTIT</b>	
<p>Projekti do të adresojë problemin e përjashtimit të personave me aftësi të kufizuara nga pjesëmarrja në jetën e komunitetit, si rezultat i mungesës totale të transportit të përshtatur. Ky është një shërbim i domosdoshëm, i kërkuar dhe në përgjigje të nevojave të klientëve të cilët përdorin karrige me rrota apo kanë vështirësi në lëvizje. Moto e këtij shërbimi do të jetë: një shërbim i përshtatur, i besueshëm, i shpejtë në përgjigje të nevojave të individëve me aftësi të kufizuara.</p> <p>Shërbimi do të ofrojë mundësi personave me aftësi të kufizuara të shkojnë në punë, të shkojnë në shkollë, të ndjekin aktivitete apo të marrin pjesë në shërbime të tjera në komunitetin ku jetojnë. Përmes këtij projekti, ofrohet një shërbim transporti derë më derë, të gjitha ditët e javës, nga ora 7.00- 22.00. Dy furgonë të përshtatur me nga katër vende për karriget me rrota, do të mundësojnë shërbimin. Katër shoferë do të trajnohen për të mundësuar shërbimin gjatë gjithë ditës e javës. 90-120 persona me vështirësi në lëvizje dhe përdorues të karriges e rrota, do të përfitojnë nga shërbimi i transportit të përshtatur.</p>	
<b>OBJEKTIVA</b>	<b>GRUPET E SYNUARA</b>
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja e shërbimit të transportit të përshtatur për individë me aftësi të kufizuara, të cilët nuk kanë akses në transportin publik për shkak të nevojave të tyre të veçanta.</li> <li>2. Ndërtimi i një shoqërie më të mirë për të gjithë, përmes nxitjes së pjesëmarrjes aktive të personave me aftësi të</li> </ol>	90-120 persona me aftësi të kufizuara do të jenë përfitues të këtij shërbimi

kufizuara në punësim, edukim, aktivitete sociale.	
<b>AKTORËT E PËRFSHIRË DIREKT</b> Bashkia Lezhë, MMSR, Shërbimi Social Shtetëror, OJF, persona me aftësi të kufizuara, prindër e familjarë.	<b>KONTRIBUTE TË MUNDSHME</b> -Bashkia Lezhë -MMSR -SHSSH

### Projekt 8

<b>QËLLIMI:</b> Përmirësimi i cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës, përmes realizimit të së drejtës për të marrë shërbimë të përshtatura me moshën, gjininë e nevojat e tyre.	
<b>OBJEKTIVA:</b> Të pilotohet e fillojë funksionimin zinxhiri i shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës.	
<b>Programi:</b> Shërbimet	<b>Emri i projektit:</b> Pilotimi i qendrave për jetesë të pavarur
<b>PËRSHKRIMI I PROJEKTIT</b> Shtëpitë Familje janë një eksperiencë pozitive në drejtim të eliminimit të institucionalizimit dhe nxitjes së jetesës së pavarur të personave me aftësi të kufizuara në moshë madhore. Ky shërbim mund të realizohet nëpërmjet blerjes apo marrjes me qera të ambjenteve të banimit nga Bashkia Lezhë, me qëllim vendosjen në to për të banuar të 4-5 anëtarë me aftësi të kufizuara mbi moshën 18 vjeç. Gjatë orëve të pasdites në shtëpi ka staf që ndihmon banorët për kryerjen e veprimtarive të nevojshme si blerje, gatim, pastrim të shtëpisë si edhe për higjenën e tyre personale. Edhe gjatë kohës së natës ka staf për mbështetje dhe mbikqyrjen e personave me aftësi të kufizuar që banojnë në të. Personat me aftësi të kufizuara zakonisht i zgjedhin vetë shokët/shoqet me të cilët ndajnë shtëpinë dhe janë pjesëmarrës aktivë në mbajtjen e saj. Objekti i banimit mund të jetë në një lagje të komunitetit, në zona të banuara dhe stafi bën përpjekje të vazhdueshme për krijimin e marrëdhënieve të mira e bashkëpunuese në komunitet.	
<b>OBJEKTIVA</b>  1. Nxitja e realizimi i konceptit të jetesës së pavarur.  2. Zvogëlimi i mundësive për institucionalizimin e personave me aftësi të kufizuara.	<b>GRUPET E SYNUARA</b>  10 persona me aftësi të kufizuara në moshë madhore e pa familje në qytetin e Lezhës.
<b>AKTORËT E PËRFSHIRË DIREKT</b> Bashkia Lezhë, MMSR, Shërbimi Social Shtetëror, OJF, persona me aftësi të kufizuara,	<b>KONTRIBUTE TË MUNDSHME</b> -Bashkia Lezhë -MMSR

prindër e familjarë.	-SHSSH
<b>BUXHETI I KËRKUAR</b> 3.480.000Lekë/vit 10.440.000Lekë/3vjet	<b>KOHA E ZBATIMIT</b> Duke filluar nga viti 2016

### **Projekti 9**

<b>QËLLIMI:</b> Përmirësimi i cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës, përmes realizimit të së drejtës për të marrë shërbime të përshtatura me moshën, gjininë e nevojat e tyre.	
<b>OBJEKTIVA:</b> Të pilotohet e fillojë funksionimin zinxhiri i shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Lezhës.	
<b>Programi:</b> Shërbimet	<b>Emri i projektit:</b> Pilotim i Shërbimit “Respite care”
<b>PËRSHKRIMI I PROJEKTIT</b> Shërbimet Respite, janë shërbime afatshkuartra për personat me aftësi të kufizuara, të cilët vijnë të jetojnë në një rezidencë për një periudhë një ditore deri në një javore. Stafi i specializuar mban nën kontroll dhe punon me fëmijën gjatë kësaj periudhe. Ky program i jep familjes mundësi të clirohet nga përkujdesja e vazhdueshme për personin me aftësi të kufizuara dhe e ndihmon atë që të realizojë funksionet e saj. Studimet kanë treguar se kjo është mbështetja më e mirë, e cila ndihmon në realizimin e “normalizimit” për familjet që kanë anëtare me aftësi të kufizuara. Shërbimet “Respite” reduktojnë stresin e familjes, ndihmojnë në mirëfunksionimin e saj dhe mbështesin stabilitetin e saj. Qendra mund t’i shërbejë një numri prej 40 personash me aftësi të kufizuara në muaj. Ajo duhet të jetë e përshtatur për të siguruar nevojat e të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuara.	
<b>OBJEKTIVA</b>  1.Ofrimi i shërbimit të përkohshëm jashtë familjes në persona me aftësi të kufizuara.  2. Ofrimi i mundësive për funksionim normal të familjes.	<b>GRUPET E SYNUARA</b>  40 persona me aftësi të kufizuar në muaj.
<b>AKTORËT E PËRFSHIRË DIREKT</b> BashkiaLezhë, MMSR, Shërbimi Social Shtetëror, OJF, persona me aftësi të kufizuara, prindër e familjarë.	<b>KONTRIBUTE TË MUNDSHME</b> -Bashkia Lezhë -MMSR -SHSSH
<b>BUXHETI I KËRKUAR</b> 2.322.000 Lekë/vit 4.644.000 Lekë/2 vjet	<b>KOHA E ZBATIMIT</b> Duke filluar nga viti 2016

## Projekti 10.

### Një shkollë gjithëpërfshirëse për fëmijët me aftësi të kufizuara

**QELLIMI :** Realizimi i të drejtës për arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara, nëpërmjet krijimit të një mjedisi gjithëpërfshirës në shkollë

**OBJEKTIVA:**

1. krijimi i kulturave dhe praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë për të mirëpritur fëmijët me AK
2. mobilizimi dhe fuqizimi i burimeve njerëzore dhe materiale në shkollë në shërbim të edukimit të fëmijëve më AK
3. ndërgjegjësimi dhe fuqizimi i komunitetit shkollor për të mbështetur dhe kontribuar në edukimin e fëmijëve më AK brenda mjediseve të shkollës

**Programi:** Arsimi

**Emri i projektit:**

Krijimi i një shkolle gjithëpërfshirëse

#### **PERSHKRIMI I PROJEKTIT**

##### **Hyrje**

Në zbatim të SKPAK, dhe Ligjit për arsimin parauniversitar nr.92, 2012, dhe dispozitave normative, MASA projektuar hapa konkretë në zbatim të përgjegjësive që rrjedhin prej tyre si në nivel qendror edhe në nivel lokal. Në nivel qendror, plani i MAS parashikon krijimin e aksesit në shkollim për grupet e marxhinalizuara përfshirë fëmijët me AK. Janë udhëzuar strukturat vartëse të saj, IZHA dhe DAR të detajojnë plane konkrete për të siguruar arsimimin e fëmijëve me AK nëpër rajone..

##### **Situata dhe justifikimi**

Me gjithë këto iniciativa pozitive, koncepti i arsimit gjithëpërfshirës akoma mbetet i paqartë për punonjësit e arsimit të të gjitha niveleve dhe modelet konkrete mbeten në nivel pilotimesh të zbatuara nga shoqëria civile. MAS ka nevojë të marrë më shumë përgjegjësi për të ruajtur dhe përhapur ato. Rajoni i Lezhës është ekspozuar pak ndaj eksperiencave pozitive dhe modeleve të arsimit gjithëpërfshirës. Kapacitetet në DAR për të identifikuar fëmijët me AK dhe për të mbështetur cilësisht edukimin dhe zhvillimin e potencialit të tyre janë tepër të brishta. Lëvizjet e vazhdueshme të personelit arsimor nga shkollat e DAR-et e vështirësojnë fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe qëndrueshmërinë e tyre.

Mungesa e autonomisë së shkollave si financiarisht edhe në drejtim të hartimit të minipolitikave për të përmirësuar cilësinë e arsimit brenda shkollës, monopolizon vendimmarrjen në DAR dhe MAS. Kjo i krijon kufizime serioze shkollës në përpjekjet e saj për gjetur, mobilizuar, shpërndarë e rishpërndarë burimet në favor të krijimit të arsimit gjithëpërfshirës.

Ndër problematikat më të theksuara mund të përmenden mungesa e njohurive dhe aftësive të mësuesve për të njohur dhe punuar me fëmijët me AK në klasë, mungesa e ekspertizës në DAR për të shpërndarë trainime për arsimin gjithëpërfshirës, tipet dhe karakteristikat e aftësisë së kufizuar.

Shkollat, sidomos ato në zona urbane janë akoma të mbipopulluara me nxënës dhe kjo është një pengesë tjetër që u del mësuesve për tu dhënë mbështetjen e nevojshme fëmijëve me AK. Është e nevojshme të prezantohet në sistem mësuesi ndihmës dhe dhe idealisht edhe specialistë të trajtimit të AK-vë të ndryshme, në shkollat ku ka një numër të caktuar të fëmijëve me AK.

Prania e psikologut shkollor, është e pamjaftueshme duke konsideruar raportin psikolog-nxenes, shtuar këtu edhe faktin se jo gjithnjë psikologët kanë përgatitjen akademike relevante. Mungesa e punonjësit social është pengesë serioze për të vendosur urat lidhëse mes rasteve të fëmijëve që kanë nevojë për mbështetje dhe familjeve të tyre.

Çështja e diskriminimit ndaj fëmijëve me AK dhe familjeve të tyre, bëhet e dukshme kur shkollat e zakonshme refuzojnë pranimin e tyre në mjediset e tyre duke i referuar tek shkollat speciale duke mos zbatuar në këtë mënyrë detyrimin e tyre përcaktuar në kuadrin ligjor arsimor ekzistues. Në qytetet ku arsimi gjithpërfshirës është pilotuar, haset edhe fenomeni tjetër, ai i një konkurrence të pazëshme mes shkollave speciale dhe atyre të zakonshme, në rastet kur shkollat e zakonshme thithin në gjirin e tyre fëmijë me AK duke rrezikuar ndjeshëm reduktimin e regjistrimeve në shkollat speciale.

Këto problematika e të tjera të identifikuar në analizën SËOT kryer në funksion të hartimit të strategjisë lokale të rajonit të Lezhës kërkojnë ndërhyrje të mirëmenduar për të krijuar praktika dhe modele gjithpërfshirëse të cilat nuk duhet të lokalizohen vetëm në një shkollë, por DAR duhet të konsiderojë mundësinë e përhapjes së tyre më gjerë në rajon.

#### **Ndërhyrja e propozuar:**

DAR dhe shkollat ku janë të përfshirë nxënës me aftësi të kufizuara zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e normative. Nderhyrja në shkollë presupozon krijimin e mjedisit gjithpërfshirës në këto shkollë e arritur kjo përmes

1. trainimit të komisionit të vlerësimit pranë shkolles, trainimi i mësuesve, prindërve, psikologut shkollor dhe drejtuesve të shkollës;
2. organizimit të fushatave ndërgjegjësuese me pjesëmarrjen dhe kontributin e stafit mësues, prindërve dhe strukturave të tyre përfaqësuese (Bordi i Prindërve, Këshillat e prindërve), nxënësve dhe strukturës së tyre përfaqësuese (Qeverisë së Nxënësve);
3. identifikimit dhe ndihmesës në edukim të fëmijëve me AK si në klasat respektive edhe brenda shkollës;
4. krijimit të klasës/mjedisit burimor dhe prezantimit të mësuesit ndihmës
5. prezantimit të punonjësit social në shkollë për të krijuar komunikim profesional me familjet e fëmijëve me AK, me qëllim thyerjen e mentaliteteve stigmatizuese dhe diskriminuese në mjedisin shkollor
6. ngritjes dhe fuqizimit të ekipit që harton dhe zbaton PEI në shkollë, me pjesëmarrjen e mësuesit, drejtuesit të shkollës, psikologut shkollor, punonjësit social dhe prindit (idealisht edhe të specialistëve të aftësive të kufizuara, që mund të jenë personel i qenrave të zhvillimit/shërbimit apo shkollës speciale)
7. stabilizimit dhe fuqizimit të bashkëpunimit mes personelit të shkollës së zakonshme dhe speciale në ndihmë të arsimit të fëmijëve me AK

Për të siguruar një ndërhyrje arsimore të efektshme do të ishte e nevojshme që hapa të ngjashme të realizohen edhe në kopësht.

Ndërhyrja komplementohet me ngritjen dhe fuqizimin e strukturës në DAR e cila të

<p>vlerësojë nevojat arsimore të fëmijëve me AK dhe ti rekomandojë shkollës axhustimet e nevojshme për të akomoduar dhe për tju përgjigjur nevojave të fëmijëve me AK që do të rregjistrohen dhe edukohen në këtë shkollë. Trajnime të stafit të DAR dhe Komisionit të Vlerësimit pranë DAR, do të jetë pjesë e rëndësishme e ndërhyrjes.</p> <p>Nga krijimi i një shkolle gjithëpërfshirëse, do të kenë mundësi të përfitojnë jo vetëm fëmijët me AK por të gjithë fëmijët e shkollës të cilët do të përfitojnë mësimdhënie më cilësore prej mësuesve të tyre të aftësuar për tju përgjigjur nevojave dhe stileve individuale të të nxënësve për të gjithë fëmijët. Përveç kësaj, nxënësit e shkollës do të ndërjegjësohen për rolin që kanë për të mbështetur moshatarët e tyre në nevojë. Komuniteti i prindërve do të jetë më i ndjeshëm ndaj nevojave të shkollës dhe do të marrë role dhe përgjegjësi për të dhënë mbështetjen e vet në plotësimin e këtyre nevojave.</p>	
<p><b>OBJEKTIVAT</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. rritja e numrit të fëmijëve me AK që ndjekin shkollën e zakonshme</li> <li>2. përmirësimi i aftësive të punonjësve të arsimit (brenda shkollës dhe në DAR) për të shërbyer edukimit të fëmijëve me AK</li> <li>3. rritja e pjesëmarrjes së strukturave ndihmëse në shkollë, Bordit të Prindërve dhe Qeverisë së Nxënësve për të krijuar mjedis gjithëpërfshirës në shkollë</li> </ol>	<p><b>GRUPET E SYNUARA</b></p> <p>Të gjithë fëmijët përfshirë ata me AK          Personeli i shkollës/kopshtit          Prindrit/komunitetit i shkollës          Specialistët e edukimit në DAR,          komisionet e vlerësimit në DAR dhe në shkollë/kopsht</p>
<p><b>AKTORËT E PËRFSHIRË DIREKT</b></p> <p>Mësuesit e shkollës/kopshtit          Prindërit          Nxënësit          Punonjësit e DAR, Bashkisë, Drejtorisë së Shëndetit Parësor          Personel i shkollës speciale          Personel i qendrave të zhvillimit          OJF kontribuese          Shoqata prindërishe ose të personave me AK</p>	<p><b>KONTRIBUTE TË MUNDSHME</b></p> <p>OJF kontribuese në terma financiarë ose me ekspertizë          Komuniteti shkollor/Bordi i Prindërve          Pushteti vendor          DAR</p>
<p><b>BUXHETI I KËRKUAR</b></p> <p>11.979.225.(në 5 vite projekt)</p>	<p><b>KOHA E ZBATIMIT</b></p> <p>Fillon në 2016</p>

## Projekti 11

Ngritja e njësisë për ofrtimin e shërbimit të specializuar të punësimit për personat me aftësi të kufizuar, pranë DRSHKP, Lezhë.

**QËLLIMI :** Garantimi i të drejtës për punësim të personave me aftësi të kufizuar, punëkërkuar, në qytetin e Lezhës, përmes krijimit të mekanizmave rregullatorë në nivel lokal.

**OBJEKTIVI II:** Të fuqizohen kapacitetet /përmirësimet strukturore e riplanifikim i

burimeve njerëzore.	
<b>Programi:</b> Punësimi dhe formimi profesional	<b>Emri i projektit:</b> Ngritja e njësisë për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuar, pranë DRSHKP, Lezhë.
<p><b>PËRSHKRIMI I PROJEKTIT</b></p> <p>Projekti i propozuar synon krijimin e një njësie pranë DRSHKP Lezhë me qëllim nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuar në këtë rajon. Detyra kryesore të njësisë mbështetëse bazuar dhe në funksionet që legjislacioni u njeh DRSHKP, do të jenë; identifikimi i saktë i punëkërkuësve persona me aftësi të kufizuar, këshillim –orientimi dhe ndërmjetësimi në subjekte private dhe publike për punësimin e tyre; vendosja dhe zhvillimi i partneriteteve me aktorë lokalë përgjegjës për punësimin e personave me aftësi të kufizuar si dhe me OJF; ndërgjegjësimi i punëdhënësve për detyrimet që ata kanë për punësimin e personave me aftësi të kufizuar; mundësimi dhe supervizimi i programeve për nxitjen e punësimit për personat me aftësi të kufizuara.</p> <p>Zbatimi i këtij projekti në qytetin e Lezhës është në përputhje gjithashtu edhe me prioritetet e vendosura për vitin 2010 e në vazhdim nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit të tilla si; aplikimi i programeve të nxitjes së punësimit dhe formimit profesional për grupet e veçanta të punëkërkuësve të papunë, që kanë vështirësi në punësim, si dhe propozimi i programeve të reja për të ndikuar sa më shumë në zbutjen e papunësisë.</p>	
<b>OBJEKTIVAT</b>	<b>GRUPET E SYNUARA</b>
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Krijimi i një njësie pranë DRSHKP Lezhë me fokus nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në këtë rajon.</li> <li>2. Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e aktivitetit të njësisë</li> <li>3. Vendosja dhe zhvillimi i partneriteteve me aktorë lokalë përgjegjës për punësimin e personave me aftësi të kufizuar si dhe me OJF</li> <li>4. Ndërgjegjësimi i punëdhënësve për detyrimet që ata kanë për punësimin e personave me aftësi të kufizuar</li> <li>5. Subvencionimi i subjekteve private përmes programeve të nxitjes së punësimit me qëllim punësimin në to të personave me aftësi të kufizuar</li> </ol>	<p>Personat me aftësi të kufizuara, grupmosha moshë punënë rajonin e Lezhës, cdo vit 50 persona të ndërmjetësuar për punësim dhe mesatarisht 10 persona të punësuar.</p>
<b>AKTORËT E PËRFSHIRË DIREKT</b> Projekti do të zbatohet me përfshirjen dhe në partneritetet mes aktorëve: -MMSR, SHKP, Bashkia Lezhë, OJF të	<b>KONTRIBUTE TË MUNDSHME</b> -Institucione ndërkombëtare -SHKP -DRSHKP

aftësisë së kufizuar dhe subjektet private	
<p><b>BUXHETI I KËRKUAR</b>  Buxheti i nevojshëm do të përfshijë fonde për:  -Ekspertizë teknike dhe konsulence për trajnimin e stafit të njësisë, krijimin e sistemit të vlerësimit, hartimin dhe publikimin e buletineve dhe raporteve vjetore  - Fonde për pajisjet dhe infrastrukturën e nevojshme materiale për njësinë si dhe fonde operacionale për funksionimin e saj (paga, kosto indirekte etj) për një periudhë 4 vjecare.  -Fonde për subvencionim të bizneseve për punësimin e 50 PAK  11.980.000leke (në 5 vite projekt)</p>	<p><b>KOHA E ZBATIMIT</b>   Fillon në 2016</p>



## **ANEKS 4. INSTITUCIONET QË U PËRFSHINË NË HARTIMIN E PLANIT LOKALI**

### **Përshtatshmëria e ambienteve**

1. Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Infrastrukturës/ Bashkia Lezhë
2. Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik
3. Kompani ndërtuese dhe projektues nga sektori privat
4. Drejtori të investimeve në DAR, DRSHKP, dhe DRSH

### **Shërbimet Sociale dhe Shëndetësore**

1. Drejtoria e Projekteve të Zhvillimit dhe Qeverisjes Elektronike
2. Drejtoria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë
4. Drejtoria e Financë-Buxhetit
6. Drejtoria Rajonale Shëndetësore

### **Arsimi**

1. Drejtoria Rajonale Arsimor
2. Njësia e Shërbimit Psiko-social
3. Stafe pedagogike të shkollave të zakonshme

### **Punësimi dhe Formimi Profesional**

1. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Lezhë
2. Drejtoria Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror të Punës
3. Shkolla e Mesme Profesionale